VENDIM
Nr. 480, datë 31.7.2018

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ENERGJISË PËR PERIUDHËN 2018–2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030 rishikohet çdo 3 (tre) vjet.

3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të hartojë planin e veprimit të strategjisë, pjesa II dhe, brenda muajit dhjetor 2018, ta paraqesë për miratim.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Fondi për Eficiencën e Energjisë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ndërmarrja publike në aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror "ALBGAZ", ndërmarrja publike në aktivitetet e eksplorimit dhe prodhimit të naftës bruto "Albpetrol", Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHQIPËRIA 2030
STRATEGJIA KOMBËTARE E ENERGJISË
2018–2030
Mars 2018

PARATHËNIE

Të nderuar lexues dhe ekspertë të fushës së energjisë,

Strategjia Kombëtare e Energjisë – Shqipëria 2030, është një moment shumë i veçantë për sektorin energjetik në Shqipëri. Pas një pune intensive, kemi të përfunduar dokumentin më të rëndësishëm për sektorin e energjisë, një udhërrëfyes ky i cili vendos piketat kryesore për modelet e zhvillimit të një prej promotorëve kryesorë të ekonomisë.

Ky dokument vjen sot si rrjedhojë e reformave të guximshme dhe të vështira që ndërmori qeveria shqiptare në sektorin e energjisë elektrike, një reformë të thellë, produktet e së cilës tanimë janë të dukshme.

Rikthimi i ligjshmërisë në konsumin e energjisë elektrike solli rikthimin e besimit të humbur të partnerëve dhe donatorëve të cilët gjithnjë e më shumë po mbështesin projekte investimi. Gjithashtu, investitorët privatë panë një treg energjetik gjithnjë e më likuid që u garanton kthimin e investimit dhe perspektivën e biznesit.

Humbjet e energjisë elektrike janë reduktuar nga 45.04% që ishin më 2013-n në 26.41% në fund të vitit 2017. Rritëm ndjeshëm nivelin e arkëtimeve nga 38.6 miliardë lekë më 2013-n në 64.1 miliardë lekë në fund të vitit 2017.

Hoqëm barrën e rëndë të sektorit energjetik nga buxheti i shtetit duke i kthyer tri kompanitë publike në kontributore të stabilitetit fiskal. Në këto vite, OSHEE-ja, KESH-i dhe OST-ja kanë derdhur në tatim-taksa një shumë prej 45.5 miliardë lekësh.

Gjatë këtyre viteve, vetëm në sektorin e shpërndarjes është arritur të investohen 160 milionë euro në gjithë Shqipërinë. Në transmetim arritëm të përfundojmë linjën e interkonjeksionit elektroenergjetik 400 kV të Shqipërisë me Kosovën, duke vendosur edhe themelet e bashkë-punimit dhe krijimit të një burse të përbashkët për sektorin elektroenergjetik. Përfunduam edhe linjën 110 kV të Unazës së Jugut, ndërsa po fillojmë ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV mes Shqipërisë dhe Maqedonisë.

U ndërtuan rreth 400 megavat kapacitete të reja gjeneruese të energjisë elektrike në fushën e HEC-eve të vogla dhe kaskadës shumë të rëndësishme të Devollit me HEC-in e Banjës, tashmë të vendosur në operim që prej më shumë se një viti dhe HEC-in e Moglicës që është në fazën finale të ndërtimit.

U nxit dhe mbështet ndërtimi i projektit TAP - si një projekt shumë i rëndësishëm për Shqipërinë dhe të gjithë rajonin që do të lidhë Azerbajxhanin me Evropën Perëndimore.

Ashpërsuam kontrollin ndaj marrëveshjeve hidrokarbure e në shumë raste rimorëm nën kontroll blloqet e naftës e gazit që kishin përfunduar në duar të kompanive të papërgjegjshme që jo vetëm nuk investuan, por degraduan për vite me radhë këtë sektor.

Miratuam aktet ligjore dhe nënligjore në përputhje me direktivat evropiane. Bazuar në mbështetjen e gjithanshme të Sekretariatit të Energjisë është bërë i mundur miratimi i ligjit të energjisë elektrike, ligjit të gazit natyror, ligjit të eficiencës së energjisë, ligjit të burimeve të rinovueshme të energjisë, modelit të tregut të energjisë elektrike dhe krijimin e bursës shqiptare së energjisë elektrike dhe shumë dokumente të tjera të rëndësishme.

Bazuar në arritjet e mësipërme, **sfidat e ardhme me të cilat ballafaqohet aktualisht sektori** shqiptar i energjisë përfshijnë:

- **Mbështetjen e zhvillimeve ekonomike** në sektorë të ndryshëm ekonomikë-shoqërorë;
- **Rritja e sigurisë së furnizimit me energji në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti** duke marrë pjesë aktive në tregun rajonal energjetik, përmirësuar eficiencën e energjisë, rritur pjesën e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe burimeve të tjera konvencionale të energjisë dhe në të njëjtën kohë duke marrë masa të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit;
- **Gazifikimin e sektorin energjetik** duke shfrytëzuar në maksimum projektin TAP, IAP dhe lidhjen e mundshme të Shqipërisë me Kosovën edhe me linjën e gazit natyror;

Strategjia e energjisë ka përcaktuar shumë mirë targetat energjetike të vendit për të bërë të mundur integrimin evropian të Shqipërisë në të gjithë infrastrukturën energjetike evropiane. Arritja e objektivave të mëposhtëm do të jetë një domosdoshmëri për qeverinë, agjencitë e specializuara dhe kompanitë energjetike:

- **Vazhdimin e reduktimit të humbjeve** në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nga 26.4% në vitin 2017 në 10% në vitin 2030 – nivel ky i krahasuar me të gjitha vendet evropiane;
- **Vazhdimin e rritjes së arketimeve të energjisë** elektrike nga 90% në vitin 2018 në 98% në vitin 2030 – nivel ky i krahasuar me të gjitha vendet evropiane;
- **Rritjen e kontributit të burimeve primare të energjisë** kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë në nivelin 52.5% në vitin 2030;
- **Shkalla e hapjes së tregut të energjisë elektrike** të arrijë 100% në vitin 2025 duke ndërtuar njëkohësisht një skemë të thjeshtë dhe të zbatueshme në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve familjarë me të ardhura të ulëta. Në këtë kuadër qeveria e Shqipërisë në bashkëpunim me qeverinë Kosovës, me mbështetjen shumë të madhe të USAID-it dhe Sekretariatit të Energjisë po punojnë për integrimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, krijimin e Bursës Shqiptare të energjisë elektrike me objektiv afatgjatë integrimin e tregjeve tona në tregun evropian;
- Ekonomia dhe shoqëria shqiptare të arrijë një **nivel kursimi të energjisë kundrejt konsumit total me 15% në vitin 2030;**
- **Targeti i energjive të rinovueshme** kundrejt konsumit total të arrijë në nivelin 42% në vitin 2030;
- **Reduktim i emetimeve GHG** kundrejt totalit të arrijë 11.5% në vitin 2030;
- **Penetrimi i gazit natyror kundrejt furnizimit total** me burime primare të energjisë të arrijë në nivelin 20% në vitin 2030.

Sigurisht që kjo të bëhet e mundur do të duhet të shoqërohet me investime të rëndësishme në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së gazit në vend. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi i shoqërisë Albgaz, e ngritur vetëm rreth një vit më parë, si dhe bashkëpunimi i saj me partnerë strategjikë dhe me eksperiencë në sektorin e gazit përbën një premisë të mirë për gazifikimin e ekonomisë shqiptare në të ardhmen e afërt.

Strategjia Kombëtare e Energjisë është hartuar në mënyrë të tillë që të ketë një ndikim minimal në shpenzimet publike, meqenëse investimet e kërkuara janë projektuar drejt që të sigurohen nga burime private, donatorët, bankat e zhvillimit, si dhe bankat lokale, asistencë teknike e huaj dhe së fundmi nga buxheti i shtetit.

Për këtë qëllim, qeveria shqiptare do të përgatisë të gjitha instrumentet ligjore, organizative, financiare të propozuara në kushtet e tregut konkurrues në kontekstin e qasjes së lirë në treg dhe zhvillimit të çmimeve të qëndrueshme të tregut, pa ndërsubvencionim dhe në pajtim me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore, për të bërë mbrojtjen e familjeve me të ardhura të ulëta.

Modeli i ri i Tregut duhet të lehtësojë konkurrencën e përmirësuar, së pari në tregun me shumicë, dhe më pas në tregun me pakicë. OSHEE-ja do të mbajë biznesin e saj të furnizimit, dhe do të ekspozohet ndaj konkurrencës nga furnizues të rinj që mund të hyjnë në treg për të furnizuar konsumatorët fundorë.

Investimet potenciale për përmbushjen dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve të strategjisë janë gjithsej 2.7 miliardë euro për tërë periudhën 2018–2030. Skenarët e zhvillimit të sektorit energjetik tregojnë qartë se zhvillimi i sektorit energjetik shqiptar sipas skenarit të kombinuar të energjisë tregon që pjesa e buxhetit të shtetit të planifikuar për sektorin e energjisë, përfshirë kapitalin e kompanive publike lidhur me kërkesat e investimit kundrejt buxhetit të përgjithshëm vjetor të shtetit do të jetë vetëm 0.5% dhe kjo do të sjellë një reduktim të ndjeshëm në deficitin tregtar import-eksport për të gjithë periudhën 2018–2030.

Sigurisht, që hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Energjisë është një arritje e rëndësishme, por zbatimi i saj vendos për qeverinë dhe institucionet shqiptare sfida akoma dhe më të mëdha.

Gjej rastin të shpreh këtu një falënderim të madh për të gjithë ekspertët më të mirë, vendës e të huaj, që u angazhuan për një periudhë të gjatë në hartimin e këtij dokumenti strategjik.

Një falënderim i posaçëm për USAID-in, i cili ka qenë një konsulent perfekt prej të cilit kemi marrë njohuritë dhe eksperiencat më të mira për të mbërri-tur në këtë produkt të cilin paraqesim sot para jush.

Në mbyllje një ftesë për të gjitha institucionet publike dhe jo vetëm, për mbështetje në procesin e zbatimit të kësaj Strategjie, për një Shqipëri më të mirë dhe të begatë.

DAMIAN GJIKNURI
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Tiranë, më 26 korrik 2018

STRATEGJIA KOMBËTARE E ENERGJISË (2018–2030)

VIZIONI 2030

Zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale.

Mirënjohje

Ky punim është zhvilluar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mbështetjen e ministrit Damian Gjiknuri në kuadër të angazhimit të qeverisë shqiptare për mbështetjen e ekonomisë me karbon të ulët. Qeveria është angazhuar më tej të integrojë këtë Strategji me veprimet për ndryshimet klimatike në kuadër të Marrëveshjes së Parisit dhe konventës në UNFCCC. Dokumenti është komentuar dhe relatuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë.

Ky punim është mbështetur nga USAID-i nëpërmjet projektit të përgatitur nga kompania IRG, pjesë e grupit RTI, pjesë e projektit "Strategjitë me emisione të ulëta dhe zhvillimi i energjisë të pastër në Evropën Juglindore". Grupi i ekspertëve të IRG/RTI janë: Pat DeLaquil, Besim Islami, Stephen Nash, Thomas O'Conner, David Parish, David Lockhart, Zija Kamberi, Redjan Basha, Bart Tsala dhe Fred Widicus.

Grupi i punës në MIE është udhëhequr nga Ilir Bejtja (2014–2017) dhe Dorina Çinari (2017–2018); Të dhënat janë ofruar nga AKBN-ja. Në finalizimin e këtij dokumenti kanë marrë pjesë ekspertë të MIE-t, Gjergji Simaku (për politikat energjetike, eficiencën, burimet e rinovueshme dhe objektivat kombëtarë), Agim Bregasi (elektro dhe hidroenergjinë), Stavri Dhima (për naftën dhe gazin) dhe Entela Çipa (këshilltare e ministrit).

Shkurtimet – akronimet

AEE	Agjencia për Eficiencën e Energjisë
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
ALBGAZ	Ndërmarrja publike në aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror

ALKOGAP	Gazsjellësi Shqipëri–Kosovë
BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
BD	Brenda Ditës në një Bursë Shqiptare e Energjisë Elektrike
COP21	(Conference of Parties) Njihet si Marrëveshja e Parisit për Klimën (e 21-ta)
CESEC	Lidhshmëria e Evropës Qendrore dhe Juglindore
DEE	Direktiva për Eficiencën e Energjisë (2012/27/BE)
DSHP	Detyrimi i Shërbimit Publik
DP	Dita në Avancë në një Bursë e Shqiptare e Energjisë Elektrike
EE	Eficienca e Energjisë
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
Fondi EE	Fondi për Eficiencën e Energjisë
FZF	Furnizuesi me Zgjidhjen e Fundit
GHG	Green Houses Gases – Njihen si Gazet me Efekt Serre
GWh	Gigavat-orë
HEC	Hidro Elektro Central
IAP	Tubacioni Adriatik Jonit
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
KE	Këshilli i Evropës
KESH	Korporata Elektro Energjetike Shqiptare;
KFBE	Konsumi Final Bruto i Energjisë
KKP (NDC)	Kontributi Kombëtar i Pikësynuar (National Determined Contribution)
KpD	Kontrate për Diferencë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike
ktoe	Kilo Ton Oil Equivalent (njësi e matjes së energjisë)
LEAP	Programi Kompjuterik i Planifikimit Energjetik Afatgjatë me Alternativa
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MV	Voltazh i mesëm
MW	Mega Watt të instaluara
MWh	Mega Watt energji e prodhuar
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PEN	Performanca e Energjisë së Ndërtesave
PEEAMR	Protokolli mbi Eficiencën e Energjisë dhe Aspektet e Lidhura Mjedisore
PKVBRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
PPE	Prodhuesi i Pavarur i Energjisë
PPP	Partneritet publik privat
PV	Foto Voltaik (Photo Voltaic)
REOST-e	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike
REOST-g	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të gazit natyror
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
SKZHI-II	Strategjia e Dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TAP	Gazsjellësi Trans-Adriatik
TEC	Termo Elektro Central
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WPP	Impiantet e Energjisë nga Era (Wind Power Plant)
WACC	Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit

Furnizimi dhe konsumi aktual i energjisë

Prodhimi total i energjisë primare në Shqipëri në vitet 2014, 2015, 2016 ishte respektivisht 2,021 ktoe, 2,117 ktoe, 2,013 ktoe[1], ndërsa konsumi final i burimeve të energjisë (KFBE) ishte respektivisht 2,157 ktoe, 2,065 ktoe, 2,056 ktoe, ndërsa importet neto ishin 1,898 ktoe, 1,507 ktoe dhe 1,358 ktoe. Burimet e rinovueshme të energjisë (BRE-të) kanë pësuar rritje duke zënë 32–35% dhe objektivi i tyre është 38% më 2020-n.

Furnizimi primar i energjisë në Shqipëri dominohet nga nafta, hidrocentralet dhe energjia elektrike e

[1] 1 ktoe (kilo ton Oil Equivalent) = 11,630.56 MWh = 11.63 GWh (është njësi që ekuivalenton sasinë e energjisë të çfarëdo lloji të shprehur në njësi të tjera).

importuar siç tregohet në figurën 1, gjë që tregon se importet e nënprodukteve të naftës, energjia elektrike dhe një sasi e vogël e qymyrit përbëjnë mbi 56% të të vegjë konsumit të energjisë primare. Figura 2 tregon se sektori i transportit konsumon sasinë më të madhe të energjisë, pasuar nga sektori rezidencial dhe sektori i industrisë, dhe tri lëndët djegëse më të rëndësishme të energjisë janë produktet e naftës, energjia elektrike dhe drutë e zjarrit. Shifrat ilustrojnë karakteristikat e mëposhtme të sektorëve të energjisë shqiptare:

- Varësia e madhe nga importi i nënproduktëve të naftës;
- Rëndësia e hidroenergjisë në bilancin energjetik të vendit;
- Pjesa më e madhe në konsumin e energjisë nga sektori i transportit;

Furnizim minimal me gaz natyror si prodhim vendës.



Figura 1:
Burimet primare të energjisë dhe importet - 2014



Figura 2:
Konsumi përfundimtar i energjisë sipas sektorëve - 2014

Historikisht, gjenerimi i energjisë elektrike është përmbushur pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet, me një kapacitet total të instaluar prej 2,011 mw në fund të vitit 2016. Vendi ka shfrytëzuar afro 50% të potencialit të vet hidroenergjetik dhe zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik është i mundur kryesisht përgjatë lumenjve Drin, Mat, Devolli dhe Bistrica. Kapacitetet hidrike janë burimet natyrore të rinovueshme më të rëndësishme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë.

I vetmi termocentral, TEC-i i Vlorës, nuk është ende funksional dhe transformimi i tij me gaz natyror është parashikuar të ndodhë pas ndërtimit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP).

Shqipëria importon energji elektrike nga vendet fqinje, megjithëse importet kanë rënë në mënyrë progresive në dhjetë vitet e fundit pas rritjes së prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike dhe zvogëlimit të humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe joteknike) në sistemin e shpërndarjes, të cilat janë zvogëluar nga 45.04% më 2013-n në 25.04% deri në fund të vitit 2016[2] me një plan të qartë investimesh dhe menaxhimi për t'i ulur ato më tej në 17% deri në fund të 2020-s.

Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri është në tranzicion nga një sistem i planifikuar drejt një sistemi me bazë tregu. Tregu i energjisë me shumicë dominohet nga kompania shtetërore e prodhimit KESH, e cila furnizon OSHEE-në me energjinë elektrike të nevojshme për konsumatorët finalë nën kushte të rregulluara të "furnizimit universal". Mjedisi konkurrues me shumicë përbëhet nga prodhuesit e pavarur dhe një numër i vogël klientësh të mëdhenj të furnizuar nëpërmjet kontratave dypalëshe.

Reforma ligjore dhe institucionale në sektorin e energjisë elektrike

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkë me të gjithë aktorët e tjerë të energjisë, po punojnë për përmbushjen e angazhimeve të tyre për të zbatuar paketën e tretë të energjisë.

Ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike u miratua në prill të vitit 2015 dhe është në përputhje me paketën e tretë të energjisë pasi transpozon direktivën 2009/72/KE dhe rregulloren (KE) 714/2009. Megjithatë, legjisla-cioni dytësor mbetet për t'u zbatuar plotësisht, duke mbështetur kështu implementimin e paketës së tretë të energjisë.

[2] Zbatimi i projektit "Rimëkëmbja e sektorit të energjisë elektrike" dhe puna riorganizuese e fundit e kryer në rrjetet e transmetimit-shpërndarjes gjatë viteve 2014–2016.

Në korrik 2016, Këshilli i Ministrave miratoi një model të ri tregu për rregullimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, si edhe planin për derregullimin e çmimeve duke mundësuar hapjen e tregut. Një plan veprimi për krijimin e Bursës së Energjisë, i cili parashikon një treg të organizuar të ditës në avancë (day-ahead) është, gjithashtu, pjesë e kësaj pakete. Modeli i tregut parashikon integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike me atë të Kosovës dhe rajonit.

Në shkurt 2018, me ndryshimet e ligjit të sektorit të energjisë elektrike, është vendosur baza ligjore për krijimin e Bursës së Energjisë Elektrike në Shqipëri dhe krijimin e mundësive për krijimin e tregut të përbashkët me Kosovën, rajonin dhe me gjere. Në vijim të detyrimeve të përcaktuara, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është në përfundim të procesit të harmonizimit të legjislacionit dytësor që nevojitet për reformat dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike. Në mars 2017, ERE miratoi certifikimin përfundimtar të ndarjes së pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST sh.a.

Reformat e tregut të energjisë do të shkojnë përtej zbatimit të paketës së tretë të energjisë brenda vendit. Shqipëria është anëtare e procesit të Berlinit ose e nismës së Ballkanit Perëndimor 6 (WB6) dhe është e angazhuar në integrimin rajonal të tregut të energjisë elektrike si një hap ndërmjetës drejt modelit të synuar evropian të energjisë elektrike. Për më tepër, si pjesë e iniciativës së BP6, Shqipëria është e angazhuar të ndërmarrë masa ndaj ndryshimeve klimatike duke integruar Strategjinë e saj të Energjisë në kuadër të angazhimeve në Marrëveshjen e Parisit (COP21) dhe ratifikimit të NDC-së në UNFCCC, në pranverën e 2016-s.

Duke komisionuar linjën e re të interkonjeksionit 400 kV me Kosovën në qershor 2016 dhe ndërtimin e nënctacionit në kufi, Shqipëria bëri një hap të mëtejshëm drejt integrimit të saj në tregun rajonal të energjisë elektrike. Të dy operatorët e sistemit tashmë kanë zhvilluar dhe testuar një mekanizëm për prokurimin e kapacitetit për rezervë dytësore.

Gjatë viteve, Albpetrol-i është transformuar nga një kompani nafte plotësisht operacionale drejt rolit të një kompanie ku përveç aktivitetit të kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe të gazit, i cili në vite ka ardhur duke u reduktuar, ka luajtur edhe rolin e përfaqësimit të palës shqiptare në Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhur për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese, pa u përfshirë në operacionet e kërkimit dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit.

Për këtë arsye, gjatë kësaj periudhe, Albpetrol-i ka siguruar një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga shitja e naftës që i transferohet nga kompanitë kontraktore për llogari të prodhimit paraekzistues (PPE) dhe për llogari të përqindjes së ndarjes së prodhimit (PPA). Në kuadrin e programit të qeverisë, sipas të cilit Albpetrol sh.a. duhet të privatizojë asetet duke ruajtur vetëm një njësi teknike, nafta e përfituar nga PPE dhe PPA ose të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj nafte, si dhe administrimi i marrëveshjeve hidrokarbure, duhet t'i kalojnë një agjencie qeveritare në varësi të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet. Aktorët e tjerë në tregun e kërkimit dhe nxjerrjes në Shqipëri janë kompani private, që kanë fituar të drejta për kryerjen e operacioneve hidrokarbure në vendburimet ekzistuese të naftës dhe gazit, si dhe eksplorimin dhe prodhimin në blloqet e kërkimit, mbi bazën e përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kërkimin dhe prodhimin. Ndryshimet e bëra gjatë viteve të fundit në legjislacionin që rregullon aktivitetin e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve e kanë përshtatur atë me direktivën përkatëse të BE 94/22/EC të 30 Maj 1994, veçanërisht sa ka të bëjë me procedurat e lidhjes së Marrëveshjeve Hidrokarbure, duke i bërë ato më transparente dhe konkurruese. Është momenti i duhur që Shqipëria të shikojë mundësinë e ndryshimit të sistemit fiskal në sektorin e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve, si dhe të modelit të marrëveshjeve hidrokarbure.

Përveç kësaj, Shqipëria ka themeluar operatorin e parë të sistemit të transmetimit të gazit, TAP AG, i certifikuar sipas procedurave të paketës së tretë të energjisë, i cili ka hedhur bazat për zhvillimin e një tregu të gazit nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik, TAP. ERE ka certifikuar, gjithashtu, operatorin e dytë të sistemit të transmetimit të gazit, ALBGAZ sh.a., më 8 nëntor 2017.

Statusi i përafrimit të legjislacionit të sektorit të energjisë me *acquis*-in e BE-së

Në përputhje me detyrimet e saj, sipas komunitetit të energjisë dhe si pjesë e objektivit strategjik të Shqipërisë për të hyrë në BE, qeveria ka punuar për të harmonizuar legjislacionin e saj me kuadrin ligjor të BE-së dhe për të krijuar përgjegjësi të qarta dhe transparente për zbatimin e acquis-ve të BE-së. Legjislacioni primar përkatës përfshin ligjin nr. 43/2015, datë 30.4.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; ligjin nr. 102/2015, datë 23.9.2015 "Për sektorin e gazit natyror"; ligjin nr. 124/2015, datë 12.11.2015 "Për eficiencën e energjisë"; ligji nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; ligjin nr. 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim

në energji" dhe ligjin nr. 116/2016, datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave".

Në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë, qeveria shqiptare, si edhe Enti Rregullator i Energjisë (ERE) kanë miratuar tashmë një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore. Megjithatë, ende duhet të plotësohet më tej kuadri nënligjor dhe rregullator, për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, për kërkesat financiare dhe implikimet buxhetore të sektorit të energjisë, për objektivat e reduktimit të humbjeve dhe arkëtimeve, për ndarjen e OSHEE-së, krijimin dhe funksionimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, dhe lidhjen e tregut të energjisë elektrike me Kosovën dhe vendet e tjera fqinje, si dhe transpozimin e Rregullores së BE-së nr. 347/2013 dhe zbatimin e acquis-ve të tjera në fushën e energjisë. Këto hapa synojnë lehtësimin e investimeve të nevojshme dhe funksionimin e tregut të brendshëm të energjisë, drejt objektivave të qëndrueshëm.

Gjithashtu, prioritetet afatshkurtra për të ardhmen përfshijnë zhvillimin e legjislacionit sekondar dhe rregulloreve për zbatimin e ligjit të performancës së energjisë në ndërtesa dhe ligjin për eficiencën e energjisë.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në direktivën e Këshillit 2009/119/KE, datë 14.9.2009 për mbajtjen e rezervave minimale të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj, pasi aktualisht bazuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për rafinimin, transportimin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj", të ndryshuar, mbajtja dhe menaxhimi i rezervave të sigurisë nuk bëhet sipas përcaktimeve të kësaj direktive.

Duke marrë parasysh se sektori i energjisë është një nga sektorët kyç me një ndikim të madh në ndryshimin e klimës, qeveria shqiptare po planifikon të finalizojë së shpejti një projektligj të ri mbi ndryshimet klimatike, i cili do të shërbejë si bazë ligjore për vendosjen e një kuadri më të detajuar për ndryshimet klimatike, kompetencat dhe përgjegjësitë e qarta për ministrinë dhe agjencitë e tjera të varësisë, përgjegjëse për sektorin e energjisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Projektligji mbi ndryshimet klimatike, i cili përcakton kuadrin për veprimet klimatike, është në proces hartimi dhe pritet të miratohet brenda vitit 2018.

Gjendja aktuale e sektorit të naftës dhe gazit

Sektori i naftës në Shqipëri është i vogël sipas standardeve ndërkombëtare, por është i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë dhe ka ende rezerva të mëdha nafte dhe gazi natyror të pazbuluara. Shqipëria është një nga vendet e tranzitit për Gazsjellësin Trans Adriatik, i cili do të transportojë gazin azer nga Greqia, nëpërmjet Shqipërisë, deri në Itali. Deri në fund të vitit 2020, gazsjellësi duhet t'i japë Shqipërisë mundësinë e përdorimit të gazit natyror për përdorim në të gjithë sektorët e ekonomisë. Tubacioni i ri, gjithashtu, do të lidhë Shqipërinë me ekonomitë shumë më të mëdha të Greqisë dhe Italisë, të cilët janë partnerë të rëndësishëm tregtarë dhe burime investimi në ekonominë shqiptare.

Kompania shtetërore e naftës, ALBPETROL, vlerëson rezerva gjeologjike të naftës bruto janë rreth 437 milionë tonë dhe rezervat e nxjerrshim të naftës buto në totale janë rreth 46.9 milionë tonë dhe rezerva të gazit natyror në rreth 5,7 miliardë m^3_N. Aktualisht, gjashte kompani kanë Marrëveshje për Ndarjen e Prodhimit (MNP) me kompaninë shtetërore të naftës ALBPETROL për zhvillimin dhe prodhimin në fushat ekzistuese të naftës. Patos Marinza - Bankers Petroleum (2004); Ballsh Hekal-Anio Oil and Gas; Delvina – Delvina Gas Company (2016); Kuçova – Sherwood International Petroleum (2007); Visoka – Transoil Group (2009), Pekisht–Murriz–Fin–Pek, Finiq–Krane–Fin Pek.

Si rezultat, prodhimi i naftës bruto në Shqipëri është trefishuar gjatë dekadës së fundit në 1,369 milionë tonë në vitin 2014, me Bankers Petroleum që udhëheq pothuajse gjithë rritjen e prodhimit. Aktualisht, kemi pak prodhim të gazit natyror vendës. Megjithatë, rënia e vazhdueshme e çmimeve të naftës në tregun ndërkombëtar ka shkaktuar një rënie korresponduese në prodhimin e naftës dhe investimet në sektor gjatë dy viteve të fundit. Korporata Geo Jade Petroleum me bazë në Kinë, kohët e fundit ka blerë Bankers Petroleum për rreth 440 milionë dollarë.

Elementet e menaxhimit qeveritar mbi sektorin e naftës dhe gazit janë të shpërndara nëpër shumë ministri, agjenci dhe ente të sektorit publik, duke rezultuar në një qasje ad hoc ndaj politikës, e cila duhet të fokusohet në përmbushjen e nevojave të specializuara të sektorit të naftës dhe gazit. Reformat institucionale janë kritike për të përmirësuar menaxhimin e nevojshëm për të drejtuar në mënyrë efektive zhvillimin racional të sektorit aktual të naftës dhe gazit në vend.

Vendimi i Shqipërisë për të aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian po shoqërohet edhe me ndryshimet e nevojshme që menaxhimi i sektorit të naftës dhe gazit në Shqipëri të jetë në përputhje me direktivat e BE-së. Ky proces, i cili është, gjithashtu, i nxitur nga ardhja e gazit natyror nëpërmjet Gazsjellësit të Trans Adriatikut që kalon nëpër Shqipëri për në Itali, do të kërkojë një ristrukturim të

madh të aftësive të qeverisë shqiptare për të menaxhuar proceset e blerjes, shpërndarjes dhe shitjes së gazit në tregun e brendshëm. Albgaz sh.a. është një shoqëri aksionere e themeluar, me aksione në pronësi të plotë të shtetit shqiptar, me funksionet e një operatori të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Republikën e Shqipërisë.

Si pjesë e tranzicionit që kërkohet për t'u bashkuar me BE-në, Shqipëria u bë anëtare në kuadër të nismës për transparencën e industrive nxjerrëse (EITI) në maj 2013. Qeveria planifikon ta përdorë këtë si një platformë për përmirësimin e qeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies brenda sektorit të energjisë. Ajo, gjithashtu, planifikon ta përdorë atë si një mjet për të forcuar kuadrin ligjor dhe institucional në industritë nxjerrëse dhe si një mjet për heqjen e barrierave të mëdha rregullatore ndaj ndërmarrjeve që pengojnë rritjen dhe krijimin e vendeve të punës, duke forcuar kuadrin ligjor dhe institucional në këto nënsektorë.

Sfidat e sektorit të energjisë

Që prej vitit 1992, ekonomia shqiptare ka përjetuar një transformim nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu. Vlera e PBB-së për frymë, gjatë dy dekadave të fundit, është rritur për shkak të një numri faktorësh, duke përfshirë një program ambicioz për zhvillimin ekonomik, mbështetjen e zhvillimit të ofruar nga donatorët dhe një pozicion të favorshëm gjeografik si një urë që lidh Ballkanin me Evropën Perëndimore. Sfidat me të cilat ballafaqohet aktualisht sektori shqiptar i energjisë janë:

- Përmbushja e kërkesës për energji sipas zhvillimeve ekonomike në sektorë të ndryshëm dhe kërkesës në rritje të konsumit të energjisë për frymë;
- Përmirësimi i treguesit të intensitetit të energjisë;
- Rritja e sigurisë së furnizimit të energjisë duke përmirësuar eficiencën e energjisë, rritjen e kontributit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe burimeve të tjera konvencionale të energjisë, si edhe rritjen e bashkëpunimit dhe integrimit rajonal.

Historikisht, në Shqipëri konsumi i energjisë për frymë është shumë i ulët, që tregon nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik, si dhe nivele modeste të komfortit në sektorët e ekonomisë familjare dhe të shërbimeve. Nga ana tjetër, intensiteti i energjisë, që është raporti i furnizimit primar të energjisë në një vit të caktuar dhe PBB-së së prodhuar në të njëjtin vit, ka qenë shumë i lartë. Arsyet janë të njëjta, si për vendet e tjera të Evropës Qendrore, ashtu dhe Evropës Lindore: industria shqiptare ka qenë e orientuar drejt industrive me intensitet të lartë energjetik, si minierat dhe metalurgjia, dhe çmimet e energjisë janë mbajtur në nivele relativisht të ulëta.

Kështu, një nga sfidat më të rëndësishme të Shqipërisë është rritja e konsumit të energjisë për frymë, duke reduktuar nivelin e lartë të intensitetit të energjisë në mënyrë që të ketë një ekonomi efikase që do të konkurrojë në tregjet e brendshme dhe të jashtme.

Sfidat lidhur me sigurinë e energjisë përfshijnë, gjithashtu, përmbushjen e kërkesës së vendit për naftë bruto me prodhim vendës. Vetëmjaftueshmëria e burimeve primare të energjisë është ulur nga 97% në vitin 1990 në rreth 41,2% në vitin 2016. Pra, është e qartë që plotësimi i kërkesës energjetike për nënprodukte të naftës ka të bëjë me rritjen e sasisë së naftës bruto që do të përpunohet dhe tregtohet në vend, si dhe integrimin në tregun rajonal dhe liberalizimin e mëtejshëm.

Përveç sfidave të mësipërme, sistemi energjetik shqiptar duhet të përmbushë objektivin e BRE-së në vitin 2020 dhe më tej, objektivin e EE-së për reduktimin e përdorimit final të energjisë dhe objektivin KKP (NDC[3]) për reduktimin e emetimeve të GHG-së[4]. Këto sfida të sektorit të energjisë janë llogaritur bazuar në vlerësimet e treguesve të ardhshëm ekonomikë dhe energjetikë me një nivel të përcaktuar pasigurie, mungesa e një infrastrukture të përshtatshme dhe efektive për mbledhjen e të dhënave dhe mungesa e strategjive zhvillimore në disa sektorë.

Një sfidë e rëndësishme është menaxhimi i tranzicionit për zbatimin e modelit të ri të tregut, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorëve (familjarë) me nivel të ulët të të ardhurave.

VIZIONI STRATEGJIK, POLITIKAT DHE OBJEKTIVAT

Vizionin për vitin 2030:

Zhvillimi i burimeve të brendshme të energjisë që çon në një sistem energjetik rajonal të integruar dhe të diversifikuar bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për

[3] NDC (KKP) – National Determined Contribution (Kontributi Kombëtar i Pikësynuar) është objektivi kombëtar për të reduktuar gazet me efekt serre (CO_2) me 11.5% në skenarin e konsumit të energjisë për vitin 2030.

[4] GHG – Green House Gases (Gazet me Efekt Serre).

zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, garantimin e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe veprimeve klimatike, si edhe rritjen e mirëqenies.

Konteksti strategjik

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030 është dokumenti kryesor strategjik për sektorin energjetik të vendit. Ajo është në përputhje me përpjekjet kombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përmbushur angazhimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, procesin e integrimit në BE dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë.

Strategjia e Sektorit të Energjisë është zhvilluar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II (SKZHI - II) dhe është strategjia sektoriale që do të udhëheqë hartimin e politikave në nivele të larta të institucioneve publike, si dhe sektorin privat për sa lidhet me sektorin energjetik.

Strategjia e Sektorit të Energjisë është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) dhe synon të jetë një dokument referimi i rëndësishëm që do t'u mundësojë partnerëve të zhvillimit që të harmonizojnë strategjitë dhe programet e tyre të zhvillimit dhe bashkëpunimit me prioritetet dhe kuadrin e Shqipërisë për zhvillimin dhe integrimin në BE.

Strategjia e Sektorit të Energjisë është përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 2, të ligjit për sektorin e energjisë (ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015) dhe me mbështetjen e programit të USAID-it "Për strategjitë e zhvillimit me emetime të ulëta (EC -LEDS)", që është pjesë e përpjekjeve në mbarë botën për të adresuar ndryshimet klimatike dhe për të promovuar tranzicionin drejt një ekonomie me nivele më të ulëta të emetimeve të gazeve me efekt serë (GHG). Strategjia Kombëtare e Energjisë është projektuar për të përmbushur nevojat zhvillimore të vendit dhe për t'u ofruar qytetarëve/konsumatorëve të saj një furnizim të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të përballueshëm me energji bazuar në integrimin rajonal dhe diversifikimin e sektorit të energjisë.

Parimet udhëzuese strategjike

Parimet që udhëheqin zhvillimin e kësaj strategjie të energjisë janë në përputhje me objektivat e SKZHI - II, në mënyrë specifike, për:

- Rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, ndërsa sigurohet rritje në mirëqenie;
- Zhvillimi i burimeve të kombëtare të energjisë, diversifikimin e burimeve të furnizimit dhe ndërlidhja me rrjetet evropiane të energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me *acquis* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
- Krijimi i një tregu konkurrues që ofron sinjale korrekte për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit natyror;
- Ofrimin e incentivave për zbatimin e politikave të nevojshme të ndryshimeve klimatike, të tilla si arritjen e objektivave të BRE-së dhe të eficiencës së energjisë dhe për uljen e shkarkimeve të CO_2 dhe zbatimin e objektivave të KKE (NDC) në kuadër të UNFCCC-së.

Objektivat strategjikë afatgjatë në vijim janë identifikuar për të realizuar parimet udhëzuese dhe angazhimet aktuale që janë ndërmarrë nga qeveria shqiptare.

- Përmirësimi i besueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji;
- Zhvillimi i burimeve të brendshme të energjisë primare në një mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese;
- Përmirësimi i efektivitetit të kostove të sistemeve të furnizimit me energji;
- Arritja e objektivave për burimet e rinovueshme të energjisë dhe eficiencën e energjisë të përcaktuara në Planet Kombëtare të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe për Burimet e Rinovueshme të Energjisë;
- Zhvillimi i politikave dhe strategjive me kosto efektive për rritjen e performancës së energjisë në ndërtesat publike dhe ato rezidenciale;
- Integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe të gazit natyror me Kosovën, rajonin dhe tregjet evropiane; dhe
- Arritjen e objektivave të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (NDC) për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serë (GHG).

Skenarët energjetike bazuar në politikat energjetike

Politikat kryesore që ndikojnë në sektorin e energjisë dhe veprimet e ndërlidhura klimatike në Shqipëri përfshijnë politikat e nevojshme, për:

- Përmbushjen e angazhimeve aktuale për Traktatin e Komunitetit të Energjisë për zbatimin e objektivave të eficiencës së energjisë (EE) dhe të burimeve të energjisë së rinovueshme (BRE), si edhe

angazhimin e zvogëlimit të GHG-ve në vend sipas Marrëveshjeve të Parisit (NDC), duke përfshirë politikat e tjera të ndryshimeve klimatike si pjesë e angazhimeve të WB6-s,

- Politikat e nevojshme për t'u përgatitur për një treg të mundshëm të energjisë elektrike dhe të gazit natyror brenda Shqipërisë; dhe

- Politikat e nevojshme për t'u integruar më mirë në BE dhe në tregjet rajonale, me një fokus të veçantë në përpjekjet për lidhjen e tregjeve të energjisë elektrike shqiptare dhe kosovare, si një hap i parë drejt integrimit rajonal të tregut.

Për të kuptuar kostot dhe përfitimet e këtyre politikave të mundshme, u zhvilluan dhe u analizuan gjashtë skenarët e mëposhtëm duke përdorur modelin Shqipëria-LEAP[5]:

- **Skenari bazë**: Ky paraqet zhvillimin më të mundshëm të sektorit shqiptar të energjisë pa aplikuar asnje nga politikat energjetike. Ky skenar "pasiv" është baza për krahasimin me skenarët e tjerë.

- **Eficienca e energjisë (EE)**: Ky skenar garanton se Shqipëria përmbush detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë duke zbatuar planet e veprimit për eficiencën e energjisë deri më 2020-n dhe me tej, zbaton ligjin për eficiencën e energjisë deri në transpozimin e kërkesave të direktivës evropiane të eficiencës së energjisë (EED) dhe ligjin nr. 116/2016 për performancën e energjisë në ndërtesa.

- **Burimet e rinovueshme të energjisë (BRE):** Ky skenar garanton që Shqipëria i përmbush angazhimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë duke arritur objektivin e 38% të kontributit të energjive të përtëritshme përkundrejt totalit në vitin 2020, duke zbatuar Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë i cili përditësohet në çdo 2 vjet.

- **Promovimi i gazit natyror:** Ky skenar supozon penetrimin maksimal të mundshëm të gazit natyror në përputhje me masterplanin e gazit natyror dhe respektimin e Marrëveshjes së Parisit për GHG-të.

- **Integrimi elektroenergjetik Shqipëri–Kosovë**: Ky skenar supozon integrimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, duke krijuar një zonë të vetme ofertuese me platformën e përbashkët PX dhe algoritmin për zgjidhjen e transaksioneve të tregut.

- **I kombinuar**: Ky skenar kombinon skenarët EE, BRE dhe të promovimit të gazit natyror.

POLITIKAT DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Politikat energjetike të rekomanduara

Strategjia Kombëtare e Energjisë adreson ligjet, rregulloret dhe reformat e reja institucionale që po zhvillohen aktualisht në Shqipëri, duke përfshirë incentivat për EE dhe BRE, reformën e tarifave të energjisë elektrike, zhvillimin e tregut dhe integrimin me BE-në dhe tregjet rajonale. Me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, Shqipëria synon të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- Reduktimin e importeve të energjisë dhe rritjen e prodhimit vendës të energjisë nëpërmjet plotësimit të kërkesës së ardhshme për energji në një mënyrë të qëndrueshme duke rritur ndërkohë mirëqenien sociale;

- Përmirësimin e EE-së në sektorët rezidencialë, shërbime, transport, bujqësi dhe industri;

- Rritjen e përdorimit të teknologjive të BRE-së, bazuar në planifikimin me kosto minimale, diversifikimin e burimeve, ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit;

- Penetrimin e gazit natyror në sektorin energjetik shqiptar përmes investimeve në infrastrukturë;

- Zhvillimin e mekanizmave për nxitjen e investimeve të huaja direkte në sektorin energjetik të Shqipërisë nëpërmjet rritjes së konkurrencës në tregun e energjisë, duke ruajtur interesat e konsumatorëve dhe investitorëve;

- Përmirësimin e harmonizimit dhe integrimit të politikës dhe rregullimit të sektorit shqiptar të energjisë me *acquis*-të e komunitetit të energjisë dhe tregjet rajonale dhe të BE-së;

- Zhvillimin e një kuadri politikash për energjinë (duke përfshirë eficiencën energjetike për transportin e qëndrueshëm) në transport bazuar në Strategjinë e Sektorit të Transportit në Shqipëri, dhe futja e teknologjive të reja në të gjithë sektorët e tij;

- Zhvillimin e një tregu konkurrues që ofron sinjale korrekte për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit;

- Aktivitete të fokusuara në lidhje me përdorimin, rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese energjetike joeficiente që ndikon negativisht në mjedis dhe në zonat potencialisht me vlerë të lartë për sektorë të tjerë të zhvillimit, si p.sh. turizëm, bujqësi etj.

Objektivat strategjikë të rekomanduar

[5] Programi Kompjuterik i Planifikimit Energjetik Afatgjatë me Alternativa (LEAP).

Rezultatet e analizës së detajuar tregojnë se skenari më i dobishëm për sektorin energjetik shqiptar, bazuar në matricat strategjike, do të ishte zbatimi i të gjitha masave nga skenarët e EE-së, BRE-së dhe integrimi i tregut elektro-energjetik Shqipëri–Kosovë, së bashku me komponentët e skenarit të promovimit të gazit natyror në sektorët e energjisë elektrike dhe industrisë.

Skenari i rekomanduar i zhvillimit të sektorit të energjisë **është skenari i kombinuar** i cili ka potencialin për të arritur rezultatet e mëposhtme, të cilat në shumë raste tejkalojnë angazhimet e parashikuara në nivel vendi deri më 2030-n;

- Reduktimin e importeve të energjisë me 32% krahasuar me skenarin bazë;
- Rritjen e pjesës së BRE-së më 2030 me 42%;
- Reduktimin e kërkesës finale të energjisë me 15,5%, afër objektivit të PKVEE-së;
- Reduktimin e emetimeve të GHG me 11,5 % krahasuar me skenarin bazë;
- Reduktimin e intensitetit të energjisë së PBB-së me 18%;
- Rritjen e penetrimit të gazit natyror nëpërmjet projektit TAP në furnizimin me burime primare të energjisë nga 0,36% në vitin 2015, në 19.81% në vitin 2030, duke e fokusuar investimin e infrastrukturës së gazit natyror për t'i shërbyer sektorëve të energjisë elektrike dhe industrisë në periudhën afatshkurtër dhe konsumatorëve rezidencialë dhe komercialë në periudhën kohore afatgjatë.

Objektivat në kuadër të ndryshimeve klimatike

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë mbështet synimet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit dhe bazohet në një skenar optimal të energjisë që balancon interesat kombëtare me ato të nënsektorëve të ndryshëm të energjisë. Përveç kësaj, strategjia është hartuar për të mbështetur synimet e zhvillimit social, duke rritur punësimin, nëpërmjet promovimit të sektorit të energjisë në harmoni me mjedisin, duke stimuluar konkurrencën në tregun shqiptar të energjisë, duke siguruar stabilitetin e furnizimit duke u zhvendosur drejt tregjeve rajonale, duke rritur mirëqenien për konsumatorët e energjisë dhe duke minimizuar ndikimet negative në mjedis.

Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Parisit më 22 Prill 2016, duke hyrë në epokën e re të procesit të politikës ndërkombëtare të klimës. Në fakt, Shqipëria iu bashkua Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në vitin 1995 dhe Protokollit të Kiotos në vitin 2005. Shqipëria ka filluar procesin e ndryshimit të statusit nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar, në kontekstin e UNFCCC-it. Ky proces është pjesë integrale e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të gazeve me efekt serë (GHG), formulimin dhe zbatimin e politikave për të reduktuar GHG-në dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, transpozimin dhe zbatimin e acquis të Bashkimit Evropian për ndryshimet klimatike.

Në përputhje me objektivat e BE-së 20–20–20, Shqipëria ka paraqitur Kontributin Kombëtar të Pikësynuar brenda procesit të Marrëveshjes së Parisit në shtator 2015, duke u angazhuar për të reduktuar emetimet e CO_2, krahasuar me skenarin bazë në periudhën 2016 dhe duke synuar një reduktim me 11,5 % në vitin 2030.

Niveli i Kontributit të Pikësynuar Kombëtar (NDC) do të rishikohet dhe përpunohet më tej në Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës që do të zhvillohet dhe miratohet në vitin 2019.

Analiza e politikave energjetike

Qasja në analizën e skenarëve të sektorit shqiptar të energjisë

Analiza e rrugëve të zhvillimit të ardhshëm për sektorin e energjisë në Shqipëri u krye duke përdorur modelin LEAP, një model-energjetik i provuar, i përdorur më parë nga qeveria shqiptare, dhe që përdoret zakonisht nga vende të tjera në rajon dhe në nivel global. Modeli LEAP u kalibrua me bilancin zyrtar të energjisë më 2014-n, u përditësua me të dhëna të energjisë për vitet 2015 dhe 2016, ku ishte e zbatueshme, dhe u realizuan një sërë skenarësh deri më 2030-n për këtë analizë, siç është dokumentuar në Raportin e Analizës Teknike të Skenarëve[6].

Skenari bazë, i cili paraqet projeksionin e zhvillimeve në sektorin e energjisë deri më 2030-n, është bazuar në tendencat aktuale, pa ndërhyrje të rëndësishme, ndërtuar mbi të dhënat dhe supozimet e mëposhtme:

i. Viti bazë është marrë viti 2014, duke u nisur nga bilanci kombëtar i energjisë të këtij viti dhe të dhënat e bilanceve energjetike të viteve 2015, 2016 janë shfrytëzuar për kalibrimin e modelit.

[6] Analiza e skenarëve të zhvillimit të energjisë në mbështetje të Strategjisë Kombëtare të Energjisë së Shqipërisë, Raport për USAID-in dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, dhjetor 2016.

ii. Projeksionet e ardhshme të kërkesës për energji janë në përputhje me linjat bazë të përdorura në analizat e PKVBRE-së dhe PKVEE-së.

iii. Objektivat e zhvillimit ekonomik të Strategjisë së Dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II).

iv. Struktura aktuale e furnizimit dhe kërkesës së energjisë në të gjithë sektorët ekonomikë mbetet e njëjtë me vitin bazë.

v. Rritje e vazhduar e përdorimit të energjisë elektrike si burimin kryesor për ngrohje/ftohje dhe ujë të ngrohtë në sektorin e banimit dhe shërbimit.

vi. Një pjesë e konsiderueshme e kërkesës së ardhshme për energji elektrike do të plotësohet përmes hidrocentraleve të reja dhe gjenerimit të ri termik, bazuar në TEC-e me gaz natyror të importuar.

vii. Masat afatshkurtra nga planet kombëtare të veprimit për BRE-në dhe EE-në nuk do të zbatohen në mënyrë strikte.

viii. Intensiteti kombëtar i energjisë do të ulet në mënyrë të ngadaltë nga 2014–2030.

Skenari bazë shërben si referencë për krahasimin e secilit skenar të strategjisë së energjisë që do të kërkojë të arrijë qëllime specifike të politikave energjetike.

Skenari i **eficiencës së energjisë** bazohet në angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, në ligjin për eficiencën e energjisë (nr. 124/2015) dhe në ligjin e ri për performancën e energjisë së ndërtesave. Skenari i EE-së supozon, gjithashtu, se Shqipëria do të zbatojë PKVEE-në e dytë dhe të tretë. Skenari përfshin 14 masa specifike të nevojshme për të rritur eficiencën e energjisë si në anën e kërkesës, ashtu edhe në anën e furnizimit me burime energjetike.

Skenari i **burimeve të energjisë së rinovueshme** bazohet në detyrimet e Shqipërisë si një Palë Kontraktuese në Traktatin e Komunitetit të Energjisë për të qenë në përputhje me direktivat e BE-së për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Një nga ligjit 7/2017 është zbatimi i Planit Kombëtar Burimeve të Energjisë së Rinovueshme të përditësuar (2018–2020) (PKVBRE). Skenari i BRE-së përfshin rritjen e pjesës së burimeve të rinovueshme deri në 38 % të totalit të konsumit final të energjisë deri në vitin 2020, e cila duhet të zhvillohet më tej deri në vitin 2030.

Skenari i **promovimit të gazit natyror** llogarit se sa gaz natyror mund të depërtojë në sektorët e ndryshëm të kërkesës (rezidencialë, shërbime, industri, transport dhe bujqësi), si dhe për gjenerimin e energjisë elektrike. Ky skenar vlerëson kostot dhe përfitimet e qasjes në gaz natyror nga Gazsjellësi i Trans Adriatikut.

Skenari i **integrimit elektroenergjetik Shqipëri–Kosovë** vlerëson ndikimet e integrimit të funksionimit të tregjeve të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë si një hap i parë drejt tregut të përbashkët rajonal të energjisë. Ky projekt, i cili është Projekt i Interesit të Përbashkët, do të kishte përfitimet e mëposhtme:

- Reduktimi i shpenzimeve të sistemit të energjisë elektrike përmes përdorimit më efikas të kapacitetit ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës.
- Shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve ekzistuese gjeneruese dhe diversitet të përmirësuar i gjenerimit.
- Përmirësimi i sistemit të kontrollit të energjisë elektrike dhe sistemit të rezervës duke kombinuar gjenerimin termik (për ngarkesën bazë) në Kosovë dhe kapacitetet hidroenergjetike (për ngarkesën mesatare dhe të pikut) në Shqipëri.
- Përmirësimi i integrimit rajonal të tregut shqiptar të energjisë dhe që mund të çojë në lidhjen e mëtejshme të tregut në përputhje me angazhimet e (WB6) BP6.
- Përmirësimi i konkurrencës të tregut për shkak të rritjes së madhësisë së tregut.

Matricat e mëposhtme të analizës strategjike janë përzgjedhur për shkak të lidhjes së tyre me objektivat strategjikë afatgjatë. Çdo matricë është ndërtuar në mënyrë të tillë që të japë ndryshimin nga skenari bazë për rezultatet e mëposhtme të modelit:

- Përqindja e shfrytëzimit të burimeve energjetike të rinovueshme;
- Reduktimi i emetimeve të CO_2 të lidhura me energjinë;
- Niveli i konsumit final të energjisë;
- Niveli i gjenerimit të energjisë elektrike;
- Niveli i shfrytëzimit të kapacitetit ndërkufitar;
- Pjesa e importeve të energjisë në totalin e furnizimit me energji; dhe
- Niveli i penetrimit të gazit natyror në furnizimin total me burime primare energjetike.

Rezultatet e analizës së skenarëve të energjisë

Për të identifikuar që një strategji kombëtare mbështet interesat më të mira të vendit dhe qytetarëve/konsumatorëve të saj, secili prej skenarëve të energjisë është vlerësuar kundrejt objektivave strategjikë të përmendur më lart duke përdorur matricën strategjike të nxjerrë nga rezultatet e llogaritura bazuar në modelin LEAP. Secili prej këtyre skenarëve tregon se çfarë është e mundur në sistemin energjetik shqiptar nën politika të ndryshme. Ato përfaqësojnë ndryshimet e mundshme që mund të rezultojnë nga ndryshimet specifike të politikave duke përdorur skenarin bazë si një pikë krahasimi dhe nuk synojnë të jenë një parashikim i përpiktë për të ardhmen. Seksioni në vijim përmbledh rezultatet e skenarëve ndaj secilës prej matricave strategjike.

Trendi i konsumit të energjisë

Nga 2009–2016, konsumi përfundimtar i energjisë në Shqipëri u rrit nga 1.871 ktoe në 2.060 ktoe, një rritje prej rreth 10,13 për qind, por rritja nuk ishte e qëndrueshme ndër vite. Siç shihet në figurën 3, konsumi përfundimtar i energjisë në Shqipëri u rrit gradualisht midis 2009-s dhe 2011-s, përpara se të zbriste në vitin 2012, duke përkuar me një ngadalësim të ekonomisë shqiptare. Kjo ishte kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës për banim. Konsumi i energjisë u rrit ndjeshëm në vitin 2014, nxitur kryesisht nga sektorët e industrisë së hekurit dhe çelikut.



Figura 3. Të dhënat përfundimtare të konsumit të energjisë (Burimi: Bilanci i energjisë së Shqipërisë 2009–2014, AKBN; INSTAT)

Parashikimet për rritjen e konsumit të energjisë në Shqipëri për periudhën 2014–2030, për secilin skenar janë paraqitur në figurën 4, së bashku me rritjen e parashikuar të PBB-së.



ktoe, Billion Euro	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Baseline	2160	2230	2325	2424	2524	2632	2744	2832	2922	3018	3117	3221	3333	3458	3589	3725	3869
Combined	2160	2193	2287	2326	2366	2408	2451	2481	2511	2557	2607	2669	2732	2808	2898	3001	3118
EE	2160	2191	2295	2337	2379	2423	2467	2497	2527	2557	2587	2618	2648	2680	2711	2742	2773
Gas Baseline	2160	2231	2326	2424	2525	2632	2744	2831	2922	3028	3139	3263	3388	3538	3707	3897	4110
RES	2160	2252	2341	2432	2525	2624	2726	2808	2892	2980	3073	3169	3274	3388	3507	3632	3762
GDP	9.86	10.16	10.46	10.78	11.10	11.43	11.78	12.13	12.49	12.87	13.26	13.65	14.06	14.48	14.92	15.37	15.83

Figura 4. Konsumi final i energjisë dhe parashikimet e PBB-së 2014–2030

Skenari bazë tregon se konsumi final i energjisë do të rritet në 3.868 ktoe. Të gjithë skenarët e tjerë, me përjashtim të promovimit të gazit natyror, tregojnë zvogëlim të konsumit final të energjisë në krahasim me skenarin bazë, duke mbështetur rritjen e PBB-së për Shqipërinë.

Importet e energjisë

Figura 5 tregon përqindjen e importeve totale të energjisë për 2020-n, 2025-n dhe 2030-n për secilin nga skenarët. **Skenari për eficiencën e energjisë (EE)** tregon se ekziston një potencial për të reduktuar importet e energjisë me 19%, konsumin final të energjisë me 28% dhe emetimet e GHG me 27% krahasuar me skenarin bazë. **Skenari i promovimit të gazit** tregon importet e energjisë që rriten me 22% dhe skenari **i integrimit elektroenergjetik Shqipëri–Kosovë** tregon se ekziston potencial për të ulur importet në Shqipëri me 24% krahasuar me bazën. **Skenari i kombinuar** tregon potencialin për të zvogëluar importet me 32% për shkak të kombinimit të masave të EE-së dhe BRE-së dhe duke zëvendësuar energjinë elektrike të përdorur për ngrohjen e ambienteve me gaz natyror.



Viti	2020	2025	2030
Skenarët		Përqindje (ktoe)	
Bazë	53,40 (2,744)	53,68 (3,221)	58,92 (3,869)
EE	49,63 (2,451)	47,69 (2,669)	47,69 (3,118)
Promovimi i gazit	58,64 (2,467)	65,82 (2,618)	71,60 (2,773)
BRE	50,64 (2,744)	52,26 (3,263)	56,55 (4,110)
Shqipëri–Kosovë	41,49 (2,726)	43,55 (3,169)	44,80 (3,762)

Figura 5. Importet në funksion të Furnizimit Total të Burimeve Primare të Energjisë

Pjesa e energjisë së rinovueshme

Figura 6 tregon pjesën e burimeve të rinovueshme të energjisë në furnizimin primar me energji. Vetëm **skenari i burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE)** arrin dhe ruan synimin e PKVBRE-së deri në vitin 2020. Ai ka ndikim në reduktimin e energjisë elektrike dhe importeve të nënprodukteve të naftës dhe ka potencial për të arritur 33% reduktim të emetimit CO_2. **Skenari i promovimit të gazit** zvogëlon shfrytëzimin e BRE-së duke zëvendësuar një pjesë të energjisë së prodhuar nga termocentralet me gaz natyror që mund të përdoret për ngrohjen. **Skenari i kombinuar**, gjithashtu, tregon shfrytëzimin e reduktuar të BRE-së për të njëjtën arsye, por pjesa e BRE-së është më e madhe për shkak të kërkesës së

reduktuar të energjisë elektrike të prodhuar nga masat e EE-së. Si rezultat, Shqipëria nuk do të arrinte objektivin e saj kombëtar për BRE-në pas vitit 2026.



Viti	2020	2025	2030
Skenarët		Përqindje (ktoe)	
Bazë	37,98 (2,744)	39,09 (3,221)	36,33 (3,869)
EE	38,65 (2,451)	39,16 (2,669)	38,00 (3,118)
Promovimi i gazit	34,20 (2,467)	28,54 (2,618)	24,04 (2,773)
BRE	42,95 (2,744)	43,64 (3,263)	42,38 (4,110)
Shqipëri–Kosovë	26,35 (2,726)	28,97 (3,169)	26,87 (3,762)

Shqipëri–Kosovë	**26,35 (2,726)**	**28,97 (3,169)**	**26,87 (3,762)**

Figura 6. Përqindja e BRE në TBPE.

Gjenerimi i energjisë elektrike

Figura 7 tregon prodhimin vjetor të energjisë elektrike në Shqipëri në vitin 2020, 2025 dhe 2030. **Skenari EE** tregon potencialin për të reduktuar kërkesat e reja të gjenerimit apo importit të energjisë elektrike me 31% dhe skenari i **promovimit të gazit** tregon potencialin për të reduktuar kërkesat e reja të gjenerimit me 16% krahasuar me skenarin bazë, sepse zëvendëson hidroenergjinë e përdorur për ngrohjen e ambienteve me gaz natyror. **Skenari i BRE-së** ka ndikim minimal në kërkesën për energji elektrike dhe skenari **i kombinuar** tregon potencialin për të reduktuar gjenerimin e ri apo importin me 41% nën skenarin bazë për shkak të kombinimit të masave EE dhe BRE dhe duke zëvendësuar hidroenergjinë e përdorur për ngrohjen e ambienteve me gaz natyror.



Vitet Skenarët	2020	2025	2030
		GWh	

Bazë	8,798	9,831	11,051
EE	7,554	7,578	7,616
Promovimi i gazit	8,869	9,627	9,278
BRE	8,717	9,640	10,733
Shqipëri–Kosovë	14,507	16,606	18,402

Figura 7. Gjenerimi i energjisë elektrike

Intensiteti i energjisë në PBB

Figura 8 tregon intensitetin e energjisë së PBB-së (ktoe për M euro) për çdo skenar. **Skenari EE** tregon potencialin për të ulur intensitetin e energjisë me 28%, ndërsa skenari i **promovimit të gazit** rrit intensitetin e energjisë me 11%. **Skenari i kombinuar** tregon potencialin për zvogëlimin e intensitetit të energjisë me 18%.



Viti / Skenarët	2020	2025	2030
	ktoe/M euro		
Bazë	0.27	0.27	0.28
EE	0.25	0.22	0.20
Promovimi i Gazit	0.28	0.31	0.31
BRE	0.28	0.28	0.29
Shqipëri–Kosovë	0.25	0.23	0.23

Figura 8. Intensiteti i energjisë së PBB-së (MJ/euro)

Emetimi i gazeve me efekt serë (GHG)

Figura 9 tregon emetimet totale të GHG më 2020-n, 2025-n dhe 2030-n për çdo skenar. **Skenari i EE-së** tregon potencialin për të reduktuar emetimet e GHG-së me 27%, ndërsa skenari i **promovimit të gazit** rrit emetimet e GHG-së me 34%. **Skenari BRE** tregon se potenciali zvogëlon emetimet e GHG-së me 9%, dhe **skenari i kombinuar** zvogëlon emetimet e GHG nga 28% krahasuar me bazën. Të dy skenarët, **EE-ja dhe i kombinuari,** tejkalojnë objektivin e KKP-së të Shqipërisë.



Viti Skenarët	2020	2025	2030
	000 Ton CO_2		
Bazë	5,262	6,159	7,411
EE	4,837	5,131	5,415
Promovimi i gazit	5,841	7,344	9,944
BRE	5,011	5,728	6,721
Shqipëri–Kosovë	530	6,207	7,434
I kombinuar	4,792	5,038	5,276
I kombinuar (reduktim në % kundrejt bazës)	8,9%	18,2%	28,8%

Figura 9. Emetimet e GHG-së të Shqipërisë, në mijë tonë CO_2 eq (Gg)

Në nivel evropian, një qasje proaktive përfshin të gjitha shtetet anëtare në promovimin e një përgjigjeje të përbashkët ndërkombëtare ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përfshin përpjekjet zbutëse për të kontrolluar emetimet e gazeve serë, si dhe promovimin e masave të përshtatjes për të luftuar ndikimet negative të ndryshimeve klimatike që janë tashmë të pashmangshme.

Strategjia Kombëtare e Energjisë është plotësisht në përputhje dhe në harmoni me "Udhërrëfyesin për një ekonomi me pak karbon" të BE-së dhe promovon EE-në, BRE-në dhe karburantet miqësore me mjedisin, por edhe politikat e gazit natyror që nxisin një klimë të qëndrueshme biznesi, e cila do të inkurajojë investime në mbështetje të teknologjive me nivele të ulëta të emetimeve të GHG-së për të gjithë periudhën 2017–2030.

Siç tregon analiza në mbështetje të kësaj strategjie, ka më tepër potencial të reduktimit të GHG-së në sistemin energjetik shqiptar sesa angazhimi fillestar i Shqipërisë sipas Kontributit Kombëtar të Pikësynuar (NDC)-së. Prandaj, Strategjia Kombëtare e Energjisë dhe objektivat e politikave që ajo parashikon janë në përputhje me synimet gjithnjë në rritje të UNFCCC-së, Bashkimit Evropian dhe Komunitetit të Energjisë. Duke pasur parasysh statusin aktual të Shqipërisë si një vend kandidat për t'u pranuar në BE, ka gjasa që, gjatë periudhës që mbulon kjo strategji, Shqipëria të aderojë në BE. Për këtë arsye, ashtu si kërkohet nga anëtarësia e saj në komunitetin e energjisë, është me rëndësi të madhe që Strategjia Kombëtare e Energjisë të përafrohet edhe me politikën e BE-së për ndryshimet klimatike, duke siguruar që objektivat e politikës energjetike dhe planet përkatëse të veprimit të energjisë, të identifikuara në këtë dokument të mbështesin nivelet e ambicies të shprehura në objektivat e BE-së për zvogëlimin e CO_2 dhe qëllimet politike të ndryshimeve klimatike. Plani i Integruar i Energjisë dhe Klimës që do të miratohet gjatë vitit 2019 do të jetë dokumenti kryesor për këtë qëllim.

Skenari i integrimi elektroenergjetik Shqipëri–Kosovë

Rezultatet e skenarit të integrimit të tregut të energjisë Shqipëri–Kosovë tregojnë se ekziston një potencial i rëndësishëm për një shfrytëzim më të mirë të kapacitetit transmetues ndërkufitar, rritjen e mirëqenies përmes optimizimit të tregut të operimit të burimeve të energjisë termike në Kosovë dhe burimeve hidrike në Shqipëri (specifikisht, kaskada e lumit Drin), si edhe duke shkëmbyer kërkesat e

rezervës balancuese. Figura 10 tregon një ndarje të ndryshimeve të projektuara në kursimet dhe kostot për prodhimin dhe importet e energjisë elektrike për këtë skenar.



Viti	*2017*	*2018*	*2019*	*2020*	*2021*	*2022*	*2023*	*2024*	*2025*	*2026*	*2027*	*2028*	*2029*	*2030*
	Milionë Eur													
Kursimet nga Importi në të dyja vendet	*60.5*	*69.8*	*82.1*	*86.1*	*100*	*127*	*135*	*126*	*115*	*128*	*133*	*147*	*162*	*127*
Kosto O&M për TEC Kosova A, B dhe të ri	*2.73*	*1.74*	*0.65*	*0.12*	*0.70*	*-8.24*	*-8.42*	*-6.65*	*-3.85*	*-4.71*	*-5.26*	*-6.32*	*-7.44*	*-1.31*
Kosto O&M për kaskadën e Drinit	*-19.7*	*-22.7*	*-25.9*	*-28.1*	*-29.9*	*-33.4*	*-35.6*	*-36.1*	*-36.5*	*-39.8*	*-42.4*	*-45.9*	*-49.6*	*-47.3*
Kursimet neto të sistemeve të integruara vs të paintegruara	*43.5*	*48.9*	*56.8*	*58.1*	*71.6*	*85.0*	*90.5*	*83.9*	*72.2*	*73.9*	*85.3*	*94.7*	*104.6*	*78.6*
Kursimet kumulative të sistemeve vs të paintegruara	*43.5*	*92*	*149*	*207*	*279*	*364*	*454*	*538*	*614*	*697*	*783*	*878*	*982*	*1061*

Figura 10. Përllogaritja e kursimeve neto vjetore nga integrimi i sistemeve elektroenergjetike shqiptaro-kosovare.

Deri në vitin 2030, të dyja sistemet e kombinuara do të gjeneronin kursime vjetore financiare nga shpenzimet e reduktuara të importit prej më shumë se 1 miliard euro. Rezultatet tregojnë, gjithashtu, se nën një treg të përbashkët të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë, kostot e prodhimit do të ulen në të dyja vendet. Efekte të mëtejshme sinergjike mund të priten nga lidhja e tregut në një shkallë edhe më të madhe, pra në nivel rajonal duke përfshirë Palët Kontraktuese të komunitetit të energjisë dhe vendet fqinje anëtare të BE-së në Evropën Juglindore.

Skenari i rekomanduar i zhvillimit të sektorit energjetik

Bazuar në rezultatet metrike strategjike, analiza e detajuar tregon se skenari më i dobishëm i zhvillimit për sektorin energjetik shqiptar është **skenari i kombinuar.** Kjo do të thotë zbatimi i të gjitha masave nga skenarët EE, RES dhe integrimit të tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë, së bashku me komponentët e promovimit të gazit natyror dhe shfrytëzimit të tij në sektorët e prodhimit të energjisë elektrike dhe industrisë, duke shtyrë për një periudhë afatgjatë investimet e infrastrukturës së gazit që kërkohen për t'i shërbyer klientëve rezidencialë dhe komercialë.

Skenari i rekomanduar i zhvillimit konsiderohet më i dobishëm, sepse ka potencial për të arritur rezultatet e mëposhtme:

- Reduktim të importeve të energjisë me 32% krahasuar me skenarin bazë;
- Arritjen e objektivit të BRE-së deri ne vitin 2030 me 42%;
- Reduktim të kërkesës përfundimtare të energjisë për 15,5%, në krahasim me skenarin bazë;
- Reduktim të emetimeve të GHG-së me 11.5% në krahasim me skenarin bazë;
- Penetrimin e gazit natyror deri në masën 19,81% deri në vitin 2030; dhe
- Reduktimin e intensitetit të energjisë së PBB-së me 18%.

Zbatimi i kësaj Strategjie do të rrisë sigurinë e furnizimit të energjisë në Shqipëri dhe do të fillojë të integrojë tregun shqiptar të energjisë në tregjet rajonale dhe evropiane. **Kjo strategji bazohet në një skenar të kombinuar**, i cili balancon interesat kombëtare me ato të nënsektorëve të energjisë. Strategjia krijon, gjithashtu, kushte për të investuar në burimet energjetike që kanë ndikim minimal në mjedis.

REFORMAT PËR SEKTORIN E ENERGJISË

Shqipëria është në proces të zhvillimit dhe zbatimit të një numri ligjesh, aktesh nënligjore, rregulloresh kyçe që do të ndikojnë në rolin e aktorëve kryesorë në sektorin e energjisë dhe në fushën e eficiencës së energjisë, si edhe në veprimet klimatike. Ky kapitull përmbledh fushat kyçe të reformës, përcakton implikimet për rolin e institucioneve ekzistuese dhe të reja të sektorit të energjisë dhe identifikon boshllëqet ndërmjet situatës aktuale dhe asaj që pritet të arrihet pas zbatimit të suksesshëm të reformave.

Programet e reformës institucionale të sektorit të energjisë elektrike

Programet kryesore në reformat e sektorit të energjisë përfshijnë:

- Traktati i Komunitetit të Energjisë ("TKE"), ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, i cili siguron një kornizë ligjore për konvergjencën me *acquis* e energjisë në Bashkimin Evropian ("BE")[7];
- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, i cili u miratua nga Parlamenti Shqiptar në prill 2015;
- Modeli i ri i Tregut për sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri, i cili u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016;
- Vendimi i ERE-s nr. 214, datë 28.12.2017, "Për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë";
- Ligji nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", i cili është miratuar në nëntor 2015;
- Ligji nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme ", i cili u miratua nga Parlamenti Shqiptar në shkurt 2017.

Modeli i ri i tregut të energjisë elektrike

Një model i ri i tregut të energjisë elektrike ("Modeli i Tregut") për Shqipërinë u miratua nga Këshilli i Ministrave në korrik 2016 dhe përcakton ndryshime në sektorin e energjisë elektrike që do të shihte një largim nga marrëveshjet e rregulluara të tregut, në fuqi deri më tani, drejt marrëveshjeve tregtare më të liberalizuara. Zbatimi i Modelit të Tregut do të përmirësonte, gjithashtu, pajtueshmërinë me shumë komponentë të *acquis* të BE-së për energjinë, të përcaktuara në TKE. Me qëllim lehtësimin e krijimit të Bursës të Energjisë në Shqipëri dhe lejimin e Operatorëve të Transmetimit ose Operatorëve të Tregut nga vendet e tjera për t'u bashkuar me këtë Bursë, u propozua dhe u miratua një amendim i ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

OST-ja ka hartuar një dokument të plotë të rregullave të tregut për zbatimin e Modelit të Tregut, të cilat u miratuan nga ERE në dhjetor të vitit 2017. Këto rregulla parashikojnë që zbatimi i Modelit të ri të Tregut të bëhet në faza gjatë periudhës 2018–2020. Karakteristikat kryesore të modelit të ri të Tregut mund të përmblidhen si më poshtë:

- Tregtia fizike nga pjesëmarrësit e tregut ekskluzivisht do të bëhet përmes platformave të mëposhtme:
- Dita në avancë ("DP") dhe brenda-ditës ("BD") të tregut, që do të ngrihet nga një Bursë e re Shqiptare e Energjisë Elektrike.
- Tregtimi i energjisë fizike afatgjatë lejohet në bazë të kapacitetit ndërkufitar të blerë përmes ankandeve të kapacitetit ndërkufitar.
- Të gjitha format e tjera të tregtimit do të jenë financiare, për shembull nëpërmjet Kontratës për Diferencat (KpD) ose krijimit të tregjeve të ardhshme të decentralizuara.

[7] "Acquis communautaire mbi energjinë", i BE-së, është përcaktuar në aneksin I të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe përfshin një numër të direktivave dhe rregulloreve të BE-së që janë thelbësore për rregullimin e sektorëve të energjisë të shteteve anëtare të BE-së.

- Do të zhvillohen Rregullat specifike të ofertimit dhe do të zbatohet një regjim monitorues rregullator dhe eficient për të parandaluar abuzimin e ndonjë tregu nga pjesëmarrës të veçantë.

- Një treg balancues do të integron zgjidhjen e mosbalancimit do të krijohet dhe operohet nga OST-ja, i cili do të balancojë ofertën dhe kërkesën, duke filluar nga pozicionet e nominuara nga pjesëmarrësit e tregut nëpërmjet tregtimit fizik dhe nëpërmjet kontraktimit direkt për shërbimet e balancimit.

Reforma e tarifave të energjisë elektrike

Strategjia afatgjatë

Strategjia afatgjatë e tarifave për sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri duhet të marrë parasysh karakteristikat e mëposhtme të ndërlidhura:

Zhvillimi i tregut të energjisë në Shqipëri, veçanërisht prezantimi i një modeli të ri tregu për kalimin e plote nga një sektor i energjisë elektrike të integruar vertikalisht drejt një strukture me ente/subjekte gjeneruese/prodhuese, transme-tuese dhe shpërndarëse të ndara nga pikëpamja ligjore, funksionale dhe financiare;

- Derregullimi i çmimeve në tregun e shitjes me shumicë (duke përfshirë PSO), sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike;

- Rritja e aftësisë paguese e të gjithë sektorit shqiptar të energjisë elektrike dhe rëndësia e saj në të ardhmen, për të shmangur nevojën për subvencione qeveritare;

- Prioritetet për zhvillimin e sektorit dhe në veçanti rritja e rolit të energjisë së rinovueshme nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të hidrocentraleve të vogla, centraleve të erës dhe centraleve fotovoltaike për të përmbushur prioritetet kombëtare dhe ato të BE-së;

- Prioritetet për zhvillimin e sektorit dhe në veçanti rritjen e përfitimeve të konsumatorit në lidhje me sigurimin e furnizimit të energjisë elektrike dhe cilësisë së shërbimit;

- Zhvillimi i reformave tarifore të qëndrueshme për të mbrojtur konsumatorët familjarë vulnerabël, si dhe për të rritur eficiencën e sistemit elektroenergjetik të Shqipërisë;

- Integrimi i tregut shqiptar të energjisë elektrike me tregun rajonal dhe më vonë me të BE-së, në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Evoluimi i tregut të energjisë

Ndryshime të rëndësishme në tregun e energjisë do të krijojnë një treg rajonal për prodhuesit e energjisë, me të gjithë prodhimin rajonal lehtësisht të gjetshëm në treg. Shqipëria, kështu, do të arrijë të përmirësojë sigurinë e furnizimit me energji në vitet e thata, kur prodhimi hidrik të bjerë nën nivelet normale, duke garantuar qëndrueshmëri më të lartë në kostot midis viteve të lagështa dhe të thata, pasi tregu rajonal përmirëson stabilitetin e çmimeve për gjenerimin/prodhimin e energjisë elektrike. KESH mund të bëhet shumë më fitimprurës, veçanërisht në vitet e lagështa, duke shitur në një treg rajonal kundrejt gjeneruesve termikë me kosto më të lartë. Shkalla në të cilën KESH mund të bëhet fitimprurës, varet pjesërisht nga sasia e energjisë elektrike që mund të shesë në treg dhe sasia (nëse ka) që është e detyruar të shesë nën detyrimin e shërbimit publik. Ndikimi i përgjithshëm mbi Shqipërinë dhe shtrirja e importeve dhe eksporteve do të varen nga evoluimi i tregut dhe i vendimeve të investimeve të sektorit të energjisë në Shqipëri dhe në vendet me të cilat tregton energji.

Aftësia paguese e sektorit

Aftësia paguese e sektorit shqiptar të energjisë elektrike është një problem shumë i rëndësishëm i sektorit. Ajo, në pjesën më të madhe, është pasojë e performancës së shoqërisë së shpërndarjes OSHEE, pasi ka humbje të mëdha teknike dhe joteknike në sektorin e shpërndarjes dhe mbledhje të pamjaftueshme të parave nga faturat e klientëve. Në parim, ky problem mund të trajtohet nga injektime të rëndësishme financiare nga qeveria, nga politika dhe reforma të tjera për të përmirësuar performancën financiare të njësive të sektorit ose, në rastin më të mirë, nga një kombinim i këtyre dy qasjeve. Duke pasur parasysh se financat e qeverisë janë tejet të kufizuara dhe do të nevojiten reforma të politikave për të mundësuar çdo injektim financiar, në mënyrë që injektime të tilla të mos kërkohen rregullisht, fokusi duhet të jetë në iniciativat që mund të përmirësojnë performancën financiare nëpërmjet iniciativave në sektor që nuk kërkojnë fonde nga qeveria apo pritshmëri të ndonjë financimi tjetër të jashtëm.

Reformat e zbatuara nga qeveria shqiptare në vitin 2014 përmirësuan aftësinë e OSHEE-së për të mbledhur borxhet e vonuara të grumbulluara gjatë viteve. Për më tepër, ajo zvogëloi humbjet joteknike të energjisë në rrjetin fundor për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të palëve të treta. Në mënyrë të veçantë, ndryshimet e Kodit Penal Shqiptar, në fuqi të plotë që nga shtatori i vitit 2014, kanë rritur përgjegjësitë ligjore të çdo individi dhe/ose personave juridikë që, në mënyrë të paligjshme, konsumojnë energjinë elektrike. Qeveria duhet të vazhdojë të mbështesë përmirësimin e aftësive paguese të OSHEE-

së dhe KESH-it që do të ndihmojnë për nxitjen e investimeve të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike.

BRE-të në tregun e energjisë elektrike

Qeveria është zotuar për një politikë të rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme, kryesisht të energjisë hidrike, diellore dhe të erës, krahasuar me hidrocentralet e vogla që aktualisht, kanë prioritet më të lartë. Metodologjitë për ofrimin e skemave të mbështetjes janë hartuar si pjesë e kësaj strategjie. Megjithatë, detajet do të duhet të shqyrtohen, ndërsa zhvillohet tregu shqiptar i energjisë. Në veçanti, qeveria:

- Do të garantojë që nivelet e burimeve të rinovueshme të energjisë të ofruara në treg të jenë të menaxhueshme në kuadrin e burimeve të tjera të energjisë elektrike dhe të tregut në zhvillim;

- Ka tashmë përvojë të gjerë në vënien në funksionim të projekteve të hidrocentraleve të vogla nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit. Prandaj, projekte të tilla hidrike do të vazhdojnë të jenë burimi kryesor i projekteve të energjisë së rinovueshme, duke u mbështetur në këtë përvojë. Megjithatë, për projektet e centraleve diellore dhe të erës ka pak përvojë të mëparshme. Qeveria ka përcaktuar tarifa nxitëse (Feed-in Tariff) për energjinë diellore, të erës dhe të biomasës në mënyrë që të promovojë zonat më të mira dhe në të njëjtën kohë të ndihmojë në arritjen e objektivave përkatës për përdorimin e burimeve të rinovueshme;

- Zhvillimi i një tregu rajonal mund të çojë në një ndryshim më të madh të çmimeve gjatë ditës, sezonit (dimër-verë) dhe duke optimizuar shfrytëzimin e HEC-eve me impiantet e vogla diellore fotovoltaike dhe të erës për të ndihmuar në diversifikimin e burimeve të rinovueshme të energjisë diellore dhe të erës, Shqipëria do të rrisë ndjeshëm përfitimet në nivel vendi.

Tarifat e shitjes me pakicë dhe transmetimit

Zhvillimet në sektorin e energjisë të shpjeguara më lart, nuk do të ndikojnë metodologjinë për tarifat e shitjes me pakicë të zbatuara për furnizimin me energji elektrike sipas shërbimit publik dhe rolin e Furnizuesit të Shërbimit Universal. Megjithëse ekzistojnë implikime potenciale të rëndësishme gjatë zhvillimit të tregut, tarifat e gjenerimit po decentralizohen dhe rritja e prodhimit të burimeve të rinovueshme, të cilat shkaktojnë pasiguri më të madhe në vlerësimin e nivelit të prodhimit. Ekzistojnë dy fusha të gjera në të cilat ndryshimet mund të jenë të nevojshme:

-Ndryshimet në strukturën e tarifave të Shërbimit Universal të shitjes me pakicë për t'iu përgjigjur ndryshimeve në tarifat e prodhimit dhe për të bërë që tarifat të kenë më shumë kosto reflektuese për atë kategori të caktuar të konsumatorëve;

-Masat nga operatori i sistemit për të nxitur masat që lehtësojnë menaxhimin afatshkurtër të balancës ndërmjet ofertës dhe kërkesës përmes një tregu balancues konkurrues.

Për operatorin e sistemit, OST, marrëveshjet e reja të tregut për balancimin e kërkesës dhe ofertës bëhen më komplekse. Operatorët e sistemit kanë përgatitur skenarë të ndryshëm për të përballuar sfidat që lindin nga ky kompleksitet. Marrëveshjet do të varen nga karakteristikat e kërkesës së konsumatorit shqiptar. Përgjegjësia për krijimin e mekanizmave të reja për balancimin e kërkesës do të përfshijnë përgjegjësinë e balancimit dhe tregun balancues konkurrues, që do të zbatohet nga OST-ja. Megjithatë, qeveria do të duhet të sigurojë që shërbimet publike të planifikojnë krijimin e mekanizmave të reja dhe të garantojnë që cilësia dhe qëndrueshmëria e sistemit energjetik do të rriten.

Ristrukturimi financiar i sektorit elektro-energjetik shqiptar

Sektori i energjisë elektrike në Shqipëri ka bërë përparim financiar dhe operacional gjatë viteve të fundit. Rezultatet për periudhën 2015–2016, tregojnë se të tria kompanitë publike kryesore ishin fitimprurëse dhe treguan përmirësime në performancën financiare në krahasim me vitin 2014. Furnizimi me energji elektrike është i garantuar, edhe pse ka luhatje të niveleve të tensionit në linjat e shpërndarjes. Megjithatë, sektori i energjisë përballet me tri çështje të ndërlidhura dhe kryesore të cilat janë pjesërisht brenda kapacitetit të ERE-s në rolin e tij si rregullator. Në veçanti, si pronare e shoqërive kryesore të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, qeveria duhet të ushtrojë përgjegjësitë e saj në lidhje me pronësinë në mënyrë më efektive, me qëllim që të zgjidhë këto çështje dhe të krijojë një sektor më të qëndrueshëm të energjisë.

Tri çështjet thelbësore janë: ***së pari***, paaftësia paguese e sektorit, në veçanti nga shoqëria e shpërndarjes OSHEE, ***së dyti***, humbjet e larta teknike dhe joteknike në sektorin e shpërndarjes dhe ***së treti*** mbledhja e pamjaftueshme e parave nga faturat e klientëve. Reforma e zbatuar kohët e fundit nga qeveria shqiptare në sektorin e energjisë elektrike për grumbullimin e borxheve dhe zbatimin e parandalimit të mospagimit të energjisë nga ana e konsumatorëve ka pasur ndikim, por pozicioni financiar

i kompanisë mbetet i vështirë. Shkalla e paaftësisë paguese të sektorit mund të ilustrohet nga pozicioni financiar i OSHEE-së, i cili kishte kapital negativ prej mbi 55 miliardë lekë në fund të vitit 2015 (figura 14). Ky është një përmirësim pasi ka pasur kapital negativ mbi 71 miliardë lekë në fund të vitit 2014, por është e paqartë nëse ky përmirësim i performancës mund të jetë i qëndrueshëm. Gjithashtu, të dhënat financiare të bilancit të OSHEE-së për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, të vëna në dispozicion, tregojnë një përmirësim të mëtejshëm të pozicionit financiar të shoqërisë në krahasim me vitin 2015.

Pozicioni i KESH-it është më i favorshëm për faktin se bilanci i tij është pozitiv, por shoqëria ka kredi dhe hua afatshkurtra të rëndësishme, shumica e të cilave në formën e një overdrafti, në shumën mbi 44 miliardë lekë në fund të vitit 2015. Ky është, gjithashtu, një përmirësim në pozicionin e vitit 2014 kur kreditë dhe huat afatshkurtra arritën mbi 49 miliardë lekë, por KESH-i nuk do të ishte i aftë për të shlyer overdraftin dhe borxhet e tjera afatshkurtra në të ardhmen e afërt. Në parim, një overdraft mund të shlyhet sipas kërkesës nga banka dhe si i tillë, bilanci mbi overdraftin duhet të reduktohet në zero të paktën një herë gjatë çdo viti. Overdrafti siguron financim afatgjatë për operacionet e shoqërisë.

Në mënyrë të ngjashme, shoqëria e transmetimit OST-ja kishte të arkëtueshme një vlerë prej 9,5 miliardë lekë në vitin 2015 dhe 9,7 miliardë lekë më 2014-n, duke treguar sërish një përmirësim të lehtë. Këto vlera janë kryesisht të arkëtueshme nga OSHEE-ja dhe janë ekuivalente me të ardhurat e transmetimit të një viti. Mosarkëtimi i këtyre pagesave dëmton pozitën e OST-së, në terma afatgjatë.

Zgjidhja e këtyre çështjeve duhet të arrihet brenda një periudhe të caktuar kohore. Ekzistojnë sfida të shumta në hartimin e një pakete masash, të cilat do të sjellin performancë të përmirësuar, të cilat duhet të arrijnë besueshmëri politike dhe sociale. Masat përkatëse kërkohen nga ERE dhe qeveria. Këto janë kushte të nevojshme për përmirësimin e performancës sektoriale.

Efektiviteti i këtyre masave mund të përmirësohet nga një numër reformash të mëtejshme financiare për të rritur performancën e sektorit dhe nga ndryshimet në mënyrën sesi ERE do të ushtrojë rolin e saj, sidomos në lidhje me shqyrtimin e planeve të investimeve të operatorëve të energjisë. Qeveria do të duhet të punojë me ERE-n për të hartuar një plan të përbashkët për të kryer reformat e nevojshme.



Figura 14. Marrëveshjet institucionale në sektorin shqiptar të energjisë elektrike

Menaxhimi më i mirë i humbjeve dhe grumbullimit të të ardhurave mund të çojë në përmirësime të mëdha në performancën financiare të sektorit. Përmirësime të tilla mund të plotësohen nga shumë iniciativa të tjera financiare që do të ndihmojnë për rritjen e mëtejshme të performancës. Aktivitetet e mëposhtme do të ishin qartazi plotësuese të iniciativave për reduktimin e humbjeve:

- Hartimi i një modeli financiar sektorial;
- Riformulimi i përgjegjësive të Furnizuesit Universal të Shërbimit;
- Lejimi i shoqërive për të fituar një normë më të lartë të kthimit në kapital;
- Kryerja e ristrukturimit financiar të secilit prej shërbimeve për t'i vendosur në një pozitë më të mirë për aftësitë paguese.

Nevoja për modelin financiar të sistemit të energjisë elektrike

Aktualisht, qeveria dhe ERE nuk kanë një model financiar gjithëpërfshirës për të ndihmuar për marrjen e vendimeve në lidhje me të gjithë sektorin elektroenergjetik. Qeveria dhe ERE duhet të krijojnë një model të ndërlidhur që lidh strukturat kontabël të tri ndërmarrjeve publike, në mënyrë që implikimet e përgjithshme financiare të vendimeve tarifore dhe implikimet e tjera rregullatore dhe financiare të mund të vlerësohen shpejt dhe lehtësisht.

Modeli duhet të mbulojë të gjitha ndërveprimet midis bizneseve të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, në mënyrë që, për shembull, të vlerësohet ndikimi i rritjes së tarifës së prodhimit në tarifat e shpërndarjes dhe impaktit përkatës të financimit.

Ai, gjithashtu, duhet të ketë kapacitetin për të kryer parashikime për të ardhmen, në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i programeve të investimeve dhe evoluimi i tregut rajonal të energjisë.

Modeli duhet të mundësojë llogaritjen e raporteve financiare si raporti i kapitalit të borxhit, raporti i vetëfinancimit dhe raporti i mbulimit të shërbimit të borxhit. Modeli duhet t'i mundësojë qeverisë dhe ERE-s që të kryejnë vlerësime të financave të sektorit të elektroenergjisë.

Përgjegjësitë e furnizuesit të shërbimit universal

Aktualisht, përgjegjësitë e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) janë një mekanizëm që u mundëson kategorive të caktuara të konsumatorëve të përfitojnë çmime të energjisë elektrike relativisht më të lirë nga prodhimi hidro i rregulluar, në pronësi të shtetit. Aktualisht të gjithë konsumatorët janë përfitues, por FSHU-ja po tërhiqet progresivisht nga konsumatorët e tensionit të lartë dhe të mesëm, ndërsa zhvillohet tregu i energjisë. Konsumatorët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes në 35 kV, 20 kV, 10 kV dhe 6 kV, nuk do të jenë më pjesë e detyrimit për furnizim nga FSHU-ja. Pas kësaj, vetëm konsumatorët familjarë me tension të ulët (0,4 kV), dhe përfundimisht ndërmarrjet e vogla kualifikohen për të marrë shërbim furnizimi nga FSHU-ja. Pavarësisht kësaj, konsumatorët e tensionit të lartë, do të jenë në gjendje të kalojnë në tregun konkurrues të shitjes me pakicë sipas marrëveshjeve specifike të tyre.

Qeveria, në bashkëpunim me ERE, do të duhet të ndërmarrë hapa të mëtejshëm dhe të zëvendësojë përgjegjësinë e FSHU-së me një angazhim të qartë të qeverisë për të mbështetur zbutjen e impaktit për konsumatorët më të varfër, në vend të përkrahjes së njëtrajtshme për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në tension të ulët. Pas një identifikimi të kujdesshëm të klientëve të tillë, në bazë të kushteve dhe kritereve transparente dhe të përcaktuara mirë, mund të zbatohet një tarifë mbështetëse për konsumatorët që do të përfitojnë, duke aplikuar fondet jashtë tregut të energjisë elektrike, ndërkohë që konsumatorët e tjerë paguajnë tarifat reflektuese të kostos. Ndikimi financiar i kësaj procedure mbi furnizuesit përgjegjës (d.m.th. OSHEE-ja), nuk është përcaktuar ende dhe këta furnizues do të kompensohen pa ndikuar në tregun e energjisë elektrike ose koston e furnizimit për konsumatorët e tjerë.

Norma e kthimit dhe aftësimi financiar për KESH-in

Modeli aktual tarifor i lejon KESH-it të arrijë një kthim në asetet e tij ekuivalente me normën e obligacioneve qeveritare njëvjeçare. Kjo normë mund të jetë shumë e ulët për një ndërmarrje të energjisë, e cila kërkon financim afatgjatë deri në tridhjetë vjet. Në përgjithësi, borxhi më afatgjatë kërkon një normë më të lartë interesi sesa paratë afatshkurtra si obligacione njëvjeçare. Normat e kapitalit të kthimit janë më të larta. KESH nuk mund të jetë e aftë të arrijë vetëfinancim të mjaftueshëm për programin e saj të investimeve, përveç nëse lejohet të fitojë një normë kapitali të kthimit në të paktën disa nga investimet e saj. Kjo do të vazhdojë të jetë problematike për aq kohë sa KESH vazhdon të shesë energji për OSHEE sipas rregullimeve të veçanta dhe jashtë tregut. Pasi e gjithë energjia të tregtohet në treg të hapur, ky problem nuk do të ekzistojë më.

Ristrukturimi financiar

Në një pikë të caktuar, një ristrukturim i konsiderueshëm i sektorit financiar mund të kërkohet për të vendosur të gjitha shoqëritë e energjisë mbi një bazë të qëndrueshme. Kjo, për shembull, mund të kërkojë ristrukturimin e një pjese të borxhit që OSHEE i detyrohet KESH. Qëllimi duhet të jetë vendosja e borxhit brenda sektorit mbi baza të qëndrueshme dhe tregtare. Ky lloj ristrukturimi është i vlefshëm vetëm nëse palët e ndryshme duhet të veprojnë mbi baza tregtare në të ardhmen.

Përmirësimi i rolit të rregullatorit

Një nga elementët e punës së ERE, që mund të përmirësohet lehtësisht, duke siguruar rezultate pozitive për rritjen e rolit të Rregullatorit, është afati kohor për shqyrtimin e aplikimeve të operatorëve për tarifat. Aktualisht ERE shqyrton aplikimet e tarifave kundrejt afateve kohore shumë të kufizuara. Ky shqyrtim mund të përmirësohet ndjeshëm, nëse dorëzimi i aplikimeve të tarifave bëhet i ndarë nga dorëzimi i planeve të investimit për transmetimin dhe shpërndarjen. Planet e investimit mund të paraqiten

në një kohë të ndryshme të vitit dhe të hartohen në mënyrë më të plotë, duke i mundësuar ERE-s të rishikojë planet në mënyrë më efektive dhe të miratojë investimet në bazë të më shumë analizave të detajuara kosto-përfitim. Ekzistojnë tashmë kërkesa për shoqëritë e transmetimit dhe shpërndarjes për të përgatitur përkatësisht planet investuese pesë dhe dhjetëvjeçare dhe kjo kërkesë duhet të zbatohet brenda vitit të ardhshëm.

ERE duhet të hartojë formatet dhe planet kohore për dorëzimin e veçantë të planeve të investimeve nga shërbimet e transmetimit dhe shpërndarjes. Gjithashtu, qeveria do të përfitojë nga kjo iniciativë, pasi ajo t'i mundësojë qeverisë, si pronare e shoqërive, që të shqyrtojë më afër planet e tyre. Planet duhet të përcaktojnë se shoqëritë kanë kapacitetin financiar dhe operacional për të realizuar planet e investimeve të propozuara dhe të jenë realiste, duke pasur parasysh performancën në vitet e mëparshme.

Hapat e nevojshëm për të zbatuar programin e përshkruar më sipër dhe afatet e mundshme përshkruhen në tabelën 10. Supozohet se nuk do të ketë ndonjë suport qeveritar të parave për mbështetjen e sektorit elektroenergjetik.

Tabela 10. Hapat e nevojshëm për përmirësimin e paaftësisë paguese financiare të sektorit të energjisë

Zëri	Afati	Përgjegjësia
Kërkesa nga ERE dhe qeveria për OSHEE-në për të hartuar planin e përmirësimit të performancës për të zvogëluar humbjet dhe rritur mbledhjen e parave.	Para fundit të vitit 2018.	Qeveria dhe ERE së bashku të udhëzojnë OSHEE-në.
OSHEE të hartojë planin e përmirësimit të performancës, për shqyrtim nga qeveria dhe ERE.	Plani i parë në qershor 2018, më pas përditësohet çdo vit.	OSHEE
Hartimi i modelit financiar të sektorit.	Deri në fund të vitit 2018.	ERE, me asistencë të jashtme.
Lejimi i normës më të lartë për kthimin e kapitalit për KESH.	Në miratimin e tarifave për vitin 2018.	Qeveria të miratojë, ERE të zbatojë.
Zbatimi i ristrukturimit financiar.	Përfundon në vitin 2018. Afati përfundimtar varet nga përmirësimi i performancës.	Qeveria të autorizojë, ERE të mbikëqyrë zbatimin.
Rishikimi dhe përcaktimi i afateve të reja për dorëzimin e aplikimeve pranë ERE-s.	Nga viti 2018.	Qeveria dhe ERE së bashku.

Përvoja me tarifat e promovuese për teknologjitë e burimeve të rinovueshme

Tarifat e energjisë elektrike për kualifikimin e gjeneruesve të BRE-ve duhet të pasqyrojnë koston e shërbimit, si dhe strategjinë e rekomanduar për skemat mbështetëse në përputhje me ligjin për BRE-në dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave për miratimin e metodologjisë për hidrocentralet e vogla (HECV), Impiantet e Energjisë Fotovoltaike (PvPP) dhe Impiantet e Energjisë nga Era (WPP). Procesi i tarifimit bazohet në disa dokumente të rëndësishme: a) Struktura ekzistuese e tarifave të energjisë elektrike; b) Objektivat e BRE-së për periudhën 2014–2020 dhe ndikimi i skemave mbështetëse BRE për tarifat mesatare të energjisë elektrike; dhe c) Analiza cilësore e vitit 2015 mbi shpenzimet dhe tarifat mesatare. Tabela 11 paraqet një përmbledhje të karakteristikave kryesore të skemave mbështetëse të përdorura në disa vende në rajon. Nga të nëntë vendet evropiane të studiuara, të gjitha përdorin tarifat e energjisë së rinovueshme si mekanizma mbështetës, përveç njërit ku janë duke u përdorur certifikatat e tregtueshme të gjelbra. Regjimi i certifikatave të tregtueshme ofron njohuri të vlefshme për ngritjen e mekanizmave alternativë mbështetës. Të gjitha regjimet janë sisteme skemash mbështetëse të bazuara në treg. Përveç detyrimit të lidhjes së gjeneratorëve të BRE-ve, shumica e sistemeve mbështetëse, gjithashtu, kërkojnë nga furnizuesit ose operatorët e rrjetit që të blejnë energji elektrike të gjeneruar nga BRE-ja, bazuar në skemën e detyrimeve mbështetëse të blerjes së gjenerimit nga BRE-ja.

Metodologjia e propozuar e mbështetjes për impiantet e BRE-së

Ligji i ri i BRE-së përcakton që do të prezantohet një sistem skemash mbështetëse që merr parasysh llojin e teknologjisë dhe efikasitetin e pajisjeve gjeneruese. Ligji i ri për BRE-në ofron edhe stimuj të tjerë si:

- Vendosjen e një objektivi kombëtar për kontributin e BRE-së në konsumin total të energjisë;
- Lidhjen e detyrueshme me rrjetet e transmetimit ose shpërndarjes;
- Pagesën vetëm të kostove të drejtpërdrejta të lidhjes me rrjetet e transmetimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike;
- Marrëveshjet afatgjata (15-vjeçare) për blerjen e energjisë elektrike për energjinë e prodhuar nga centralet BRE deri në kapacitetin e instaluar 15 mw do të mbeten të njëjta. ERE do të përgatisë legjislacionin përkatës

dytësor për zbatimin e tyre;

- Blerja e detyrueshme e energjisë elektrike të prodhuar nga centralet e BRE-së.

Përveç kësaj, të gjitha impiantet BRE me kapacitet të instaluar më të lartë se 2 mw do të kenë përgjegjësi balancuese në momentin e krijimit të tregut balancues. Si rezultat i këtyre masave, interesi për centralet BRE është rritur ndjeshëm dhe kanë filluar të ndërtohen impiante të reja - fillimisht hidrocentralet e vogla dhe ato fotovoltaike, të cilat janë teknologjitë më të njohura dhe të disponueshme. Përveç kësaj, disa investitorë kanë filluar të kërkojnë autorizime për centralet e erës, si dhe centralet e biomasës.

Një komponent kyç i ligjit të ri për BRE-në është një metodologji e re e tarifave, e cila është rezultat i një studimi që ERE kishte ndërmarrë në vitin 2017 për të përcaktuar metodologjinë më të përshtatshme. Për shkak se sektori privat është identifikuar si aktor kryesor në zhvillimin e sektorit BRE, fokusi i metodologjisë ishte që të merrte në konsideratë shkallën e kthimit të normës së investimit në projekt nga pikëpamja e investitorit privat. Si rrjedhojë, studimi arriti në përfundimin se rezultati i një analize afatgjatë të kostos për njësi (LRMC,) duhet të jetë baza mbi të cilën bazohet tarifa e energjisë së rinovueshme për secilin lloj të një centrali të kualifikuar BRE. Studimi arriti në përfundimin se:

- Objektivat e BE-së për pjesën e energjisë së rinovueshme mund të përmbushen vetëm nga një kontribut i rëndësishëm nga HEC-e të reja, përdorim i energjisë diellore për prodhim energjie elektrike, burimet tradicionale dhe të reja industriale të biomasës, si dhe impiantet e erës, të cilat kërkojnë mobilizimin e sektorit privat;
- Niveli i investimeve të nevojshme do të kërkojë përfshirje të konsiderueshme nga investitorët privatë, të cilët kërkojnë një normë tërheqëse të kthimit në investimin e tyre;
- Kushtet aktuale të tregut: maturimi i kredisë 7–10-vjeçare, 2 vjet pa penalitete për mospagimin e kredisë, norma e kthimit të kapitalit 15–16%, vlerësohet se janë kushte që mund të konsiderohen tërheqëse nga sektori privat.

Ligji i ri për BRE-në kërkon që Këshilli i Ministrave të miratojë, metodologjinë për vendosjen e skemave mbështetëse për Prodhuesit me Përparësi të HEC-eve, PvPP-ve, WPP-ve, PP-ve të BioGazit. Është e rëndësishme që metodologjia: i) të mundësojë rimëkëmbjen e investimeve në instalim, duke përdorur teknologjinë e energjisë së rinovueshme aktualisht me fitim të arsyeshëm; ii) përcaktimin e madhësisë maksimale të instalimit për secilin lloj të teknologjisë së kualifikuar BRE; iii) kapaciteti total i instaluar për çdo lloj teknologjie BRE që do të përfitojë nga skemat mbështetëse; iv) duhet të marrë parasysh ndikimet sociale dhe ekonomike të skemës së mbështetjes për konsumatorët; v) të përfshijë një formulë indeksimi për të mbuluar inflacionin për çdo vit; vi) të krijojë një formulë për llogaritjen e çdo shtese plotësuese të BRE-së për çmimin e energjisë elektrike të përdoruesit fundor për të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike në Shqipëri.

Ligji i ri mbi BRE-në përcakton, gjithashtu, se mbështetja do të jepet edhe në bazë të një kontrate për diferencat (KpD) që siguron një prim të ndryshueshëm të llogaritur si pagesa e diferencës midis një çmimi administrativ të vendosur paraprakisht (çmimi fiks) dhe një mase të çmimit të tregut për energji elektrike (çmimi i referencës).

- Çmimi fiks (niveli i skemave të mbështetjes) duhet të llogaritet në mënyrë që të arrijë një volum të rëndësishëm të një teknologjie të veçantë të burimeve të energjisë së rinovueshme ekonomikisht të qëndrueshme dhe në këtë mënyrë të nxisë investimet. Çmimi i referencës është një çmim që bazohet në çmimin APEX ose më parë në çmimin e krahasueshëm të tregut të shitjeve me shumicë në një periudhë të caktuar. Për të siguruar që prodhuesit e energjisë së rinovueshme nuk janë duke u mbikompensuar, ofruesit janë të detyruar të paguajnë diferencën midis çmimit të referencës dhe çmimit fiks në KpD.
- Në parim, mbështetja financiare në bazë të një kontrate për diferenca (KpD) dhe niveli i një mbështetjeje të tillë duhet të përcaktohen nëpërmjet një procesi konkurrues dhe jodiskriminues (ankand) për t'u bërë prodhues i kualifikuar i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë.
- KpD-ja do të kenë një kohëzgjatje prej 15 vjetësh.

Marrëdhëniet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut në funksionimin e Modelit të Tregut, përcaktohen nga marrëveshjet midis pjesëmarrësve individualë dhe Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe OST-së, ose rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe standarde të zbatueshme. Të gjitha impiantet e energjisë BRE janë të ndara në dy grupe: të gjitha BRE me kapacitet të instaluar më të ulët se 2 mw nuk do të kenë përgjegjësi balancuese dhe të gjitha BRE me kapacitet të instaluar më të lartë se 2 mw do të kenë përgjegjësi balancuese. Çdo tarifë balancuese/penalitet do të aplikohet për mospërmbushjen e përgjegjësisë balancuese dhe do të vendoset me vendim të Këshillit të Ministrave, që duhet të hartohen dhe miratohen për zbatimin praktik të kërkesave ligjore të Bursës Shqiptare të Energjisë dhe BRE-së. Tabela 11 paraqet rekomandime strategjike që

duhen marrë në konsideratë gjatë llogaritjes së skemave të mbështetjes, bazuar në ligjin e ri të BRE-së.

Tabela 11. Parametrat kryesorë teknikë dhe financiarë që do të merren parasysh për skemat mbështetëse të teknologjive të BRE-së

	Centrale të vogla fotovoltaike (PV)	Centrale të vogla hidrike (SHPP)	Centrale nga era (WPP)
1.	Kapacitetet duhet të propozohen siç parashikohet të jenë i nevojshëm për arritjen e objektivave kombëtarë në Planet e Veprimit të BRE për vitin 2030 (çdo 2 vjet rishikohen) dhe sipas skenarit të BRE-së në bazë të kësaj Strategjie.		
2.	Metodologjia e skemave mbështetëse duhet të marrë në konsideratë madhësinë/kapacitetin e impiantit të BRE-së		
3.	Skemat mbështetëse për panelet fotovoltaike të propozuara për Shqipërinë duhet të jenë të krahasueshme me vendet kufitare.	Skemat mbështetëse për SHPP-në të caktuar për Shqipërinë, duhet të jenë të krahasueshme me vendet kufitare.	Skemat mbështetëse për WPP të caktuar për Shqipërinë duhet tëe jenë të krahasueshme me vendet kufitare.
4.	Rrezatimi mesatar vjetor diellor i matur të përdoret për përcaktimin e skemave mbështetëse.	Prurjet mesatare vjetor të ujit për lumin përkatës të përdoret për përcaktimin e skemave mbështetëse.	Shpejtësia mesatare vjetore e erës për vendin përkatës të përdoret për përcaktimin e skemave mbështetëse.
5.	Vlerat mesatare të investimeve janë maksimalisht 900 euro/kw për kapacitet mesatar.	Vlerat mesatare të investimeve janë 1000-1550 euro/kw për kapacitet mesatar.	Vlerat mesatare të investimeve janë 1250-1650 euro/kw për kapacitet mesatar.
6.	Operimi dhe mirëmbajtja janë 1,2–1,5% të investimit fillestar.	Operimi dhe mirëmbajtja të SHPP-së, janë 1,7–2% të investimit fillestar.	Operimi dhe mirëmbajtja të WPP-ve, janë 1,5-1,7% të investimit fillestar.
7.	Gjenerimi varet nga eficienca e njësisë, rrezatimi diellor dhe numri mesatar vjetor i orëve me diell.	Gjenerimi i SHPP-së varet nga eficienca e njësisë, kurba e kohëzgjatjes së rrjedhës së ujit dhe faktori mesatar i ngarkesës vjetore.	Gjenerimi i WPP-së varet nga eficienca e njësisë, shpejtësia mesatare e erës, regjimi i erës dhe faktori mesatar i ngarkesës vjetore.
8.	Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC), e konsideruar në llogaritjen e KpD për BRE duhet të jetë të paktën 8–10%. Kjo vlerë konsiderohet minimale për të gjithë skemën e BRE-së në përgjithësi. Panelet fotovoltaike, në veçanti, do të financohen nga kapitali i vetë investitorëve 40–50% të totalit të investimeve bazuar në konceptin e financimit të projektit.		
9.	Kohëzgjatja e stimujve: Furnizuesi Publik (OSHEE) lidh një marrëveshje blerjeje 15- (pesëmbëdhjetë-) vjeçare me të gjitha centralet prioritare BRE të pranuara në skemën mbështetëse, sipas së cilës OSHEE-ja blen energji elektrike me tarifat e energjisë së rinovueshme bazuar në konceptin e KpD.		
10.	Indeksimi i KpD: KpD rregullohen çdo vit sipas inflacionit për centralet e reja. Pasi KpD iu dha një strukture të caktuar, KpD nuk është indeksuar deri më tani. ERE ka vendosur të indeksojë KpD vjetor me indeksin e inflacionit sipas NACE Rev2 dhe të publikuar nga EUROSTAT-i.		
11.	Alokimi i kostove të investimeve në rrjet: Kodi i rrjetit lejon që kostoja e lidhjeve në rrjet t'i faturohet zhvilluesit, prodhuesit prioritarë të BRE duhet të paguajnë vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta të lidhjes me rrjetet e transmetimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike, ndërsa përmirësimi i rrjetit është përgjegjësi e të dy operatorëve të sistemit. ERE duhet të përmirësojë kodet e transmetimit dhe shpërndarjes, për zbatimin e kësaj mase.	Alokimi i kostove të investimeve në rrjet: Kodi i rrjetit të Shqipërisë aktualisht lejon që kostoja e lidhjeve në rrjet t'i faturohet ndërtuesit. Kjo qasje rrit kostot veçanërisht për SHPP më pak se 2 mw dhe ka ndikim negativ në normat e kthimit të investimeve.	Alokimi i kostove të investimeve në rrjet: Kodi i rrjetit të Shqipërisë aktualisht lejon që kostoja e lidhjeve në rrjet t'i faturohet ndërtuesit. Kjo qasje rrit kostot për zhvilluesit e WPP-së dhe ka ndikim negativ në normat e kthimit të investimeve.
12.	Procedurat e licencimit: Procedurat e licencimit janë pothuajse të njëjta për BRE mesatare (> 2 mw) dhe shumë të vogla si sistemet diellore PV, HECV, WPP (20–2000 kw). Kjo do të kërkojë shumë punë përgatitore (dhe investimet përkatëse do të rriten) dhe KpD duhet të ndikohet. Me qëllim reduktimin e investimeve të kërkuara në fazën përgatitore, procedurat e licencimit duhet të thjeshtohen, veçanërisht për panelet fotovoltaike të vogla diellore, HECV dhe WPP më pak se 3000 kw.		

Marrëveshjet ndërkombëtare dhe statusi i zbatimit

Në vitin 1997, Shqipëria ratifikoi Traktatin e Kartës së Energjisë dhe Protokollin mbi Eficiencën e Energjisë dhe Aspektet e lidhura Mjedisore (PEEAMR), i cili angazhoi qeverinë për hartimin dhe zbatimin e politikave për përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis të sistemit energjetik. Qëllimi i PEEAMR-së është që palët kontraktuese, duke përfshirë Shqipërinë, do të bashkëpunojnë, duke ndihmuar njëritjetrin për hartimin dhe zbatimin e politikave, ligjeve dhe rregulloreve për eficiencën e energjisë. Në përmbushjen e angazhimeve të saj sipas PEEAMR-s, Shqipëria paraqiti një rishikim të rregullt të politikave të saj të eficiencës së energjisë në vitin 2007.

Traktati i Komunitetit të Energjisë ("TKE") u miratua nga Parlamenti shqiptar në prill 2006 (ligji nr. 9501, datë 3.4.2006). Ai siguron një kuadër ligjor për harmonizimin me legjislacionin e BE-së për energjinë. Duke qenë palë kontraktuese në TKE, Shqipëria ka ndërmarrë angazhime të detyrueshme për zbatimin e legjislacionit përkatës të BE-së për energjinë, mjedisin, BRE dhe konkurrencën, si edhe për nxitjen e investimeve, statistikave dhe politikave sociale.

Autoritetet shqiptare kanë pranuar se investimet në eficiencën e energjisë dhe burimet e energjisë së

rinovueshme kanë potencial për të sjellë përfitime për konsumatorët vendës, për të zvogëluar emetimet dhe kontribuar në sigurinë e furnizimit.

Siguria e energjisë, zhvillimi i qëndrueshëm dhe detyrimet ndërkombëtare janë identifikuar si stimujt kryesorë të politikave të eficiencës së energjisë, së bashku me konkurrencën, punësimin, komfortin dhe ndryshimin e klimës, duke siguruar stimuj të mëtejshëm për sektorin e energjisë në nivel kombëtar.

Modeli i ri i Tregut do të ketë implikime për marrëveshjet tregtare ekzistuese në treg:

- Në rastet kur gjeneruesit e burimeve të rinovueshme të energjisë, të cilët aktualisht kanë marrëveshje paraprake për blerjen e energjisë elektrike me furnizuesin publik OSHEE, qëllimi është që këto vëllime të tregtohen përmes tregut të organizuar, por me një kontratë për diferencat ("KpD") të vendosura për të mbajtur gjeneruesit e BRE-së në tërësi në lidhje me Marrëveshjen paraprake për Blerjen e Energjisë. Gjeneruesit e prekur do të duhet të jenë në gjendje të kenë një çmim reference likuid, i cili do të jetë indeksi për diferencën ndaj çmimit (fiks) në KpD.

- Aktualisht ekziston një marrëveshje dypalëshe ndërmjet KESH-it dhe OSHEE-së që rregullon furnizimin e energjisë tek OSHEE-ja. Për të qenë në përputhje me Modelin e Tregut, këto vëllime, gjithashtu, do të kërkohet që të kalojnë përmes shkëmbimit të ri të energjisë. Modeli i Tregut i referohet kësaj si një "Detyrim i Operatorit të Tregut" mbi KESH-in dhe OSHEE-në. Ashtu si me IPP[8]-të, mund të krijohet një KpD midis KESH-it dhe OSHEE-së për të siguruar një mbrojtje financiare ndaj luhatshmërisë në tregun e organizuar fizik të energjisë.

Pasi të zbatohet me sukses dhe të shoqërohet me sistemin reflektues të kostos dhe tarifat e aksesit në treg, Modeli i ri i Tregut duhet të lehtësojë konkurrencën, së pari në tregun me shumicë, dhe më pas në tregun me pakicë. OSHEE-ja do të mbajë aktivitetin e saj të furnizimit, dhe do të ekspozohet ndaj konkurrencës nga furnizues të rinj që mund të hyjnë në treg për të furnizuar konsumatorët fundorë. Një vështrim i përgjithshëm i marrëdhënieve tregtare në vend me zbatimin e Modelit të Tregut është paraqitur në skemën në figurën 11.



Figura 11. Skema e rekomanduar e marrëdhënieve kryesore tregtare sipas Modelit të Tregut

Implikimet e Modelit të Tregut merren parasysh në përcaktimin e roleve të qarta të institucioneve kyçe të sektorit të energjisë elektrike. Veprimet dhe reformat më të rëndësishme që kërkohen për zbatimin e Modelit të Tregut mund të përmblidhen si më poshtë:

- OST-ja, në konsultim me pjesëmarrësit e tjerë të tregut përfshirë ERE-n do të vazhdojë punën **për të finalizuar rregullat e tregut** për zbatimin e modelit të ri të tregut. Në veçanti, duhet të përcaktohen rregullat për tregun balancues, prokurimin e shërbimeve të balancimit dhe llogaritjen e detyrimeve të disbalancave.

- Modeli i Tregut kërkon **ngritjen e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike** si një subjekt i veçantë ligjor me pjesëmarrjen e OST-së dhe subjekteve të tjera sipas përcaktimeve ligjore, dhe forcimin e aftësisë së njësisë së tregut brenda OST-së me aftësitë e kërkuara duke u aftësuar përmes rekrutimit dhe/ose trajnimit të burimeve njerëzore.

- Pjesëmarrësit e tjerë të tregut (ata që aktualisht janë në një PPA[9] në fuqi), në konsultim me ERE-n, duhet të hartojnë kontrata të reja financiare si KpD, ku këto kërkohen si masa kalimtare për të siguruar që qëllimi i marrëveshjeve tregtare të mëparshme të respektohen sipas Modelit të ri të Tregut.

[8] IPP – Indipendet Power Producer (Prodhuesit e Pavarur të Energjisë).
[9] PPA - Power Purchase Agreement (marrëveshje paraprake të blerjes së energjisë).

- Të gjithë pjesëmarrësit e tregut do të duhet të ndërtojnë funksione të reja për të bashkëvepruar në mënyrë efektive me marrëdhënien e re të tregut, për shembull krijimin e departamenteve tregtare ose ekipet tregtare për të menaxhuar kontratat financiare bilaterale.

Reforma institucionale për eficiencën e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë

Ligji për eficiencën e energjisë

Objektivi kryesor i ligjit të ri nr. 124/2015 të EE-së është që të përafrohet me direktivën e BE-së për eficiencën e energjisë (2012/27/KE). Objektivat kryesorë të ligjit mund të përmblidhen si më poshtë:

- Vendosja e një objektivi indikativ (targetave - vlerave të synuara) për kursimin e energjisë kombëtare dhe përgatitja e një Plani Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë ("PKVEE") që duhet të përditësohet çdo tre vjet.

- Krijimin e institucionit të agjencisë për eficiencën e energjisë ("Agjencia për EE-në") për të mbikëqyrur zbatimin e shumë dispozitave të ligjit dhe krijimin e një Fondi për Eficiencën e Energjisë ("Fondi EE") për të mbështetur dhe financuar masat e eficiencës së energjisë.

- Krijimin e audituesve energjetike si eksperte të pavarur dhe ndërmarrjeve të shërbimeve energjetike (ESCO) për shërbimet energjetike.

- Vendosja e skemave detyruese për konsumatorët e mëdhenj të energjisë (mbi 3 milionë kwh ekuivalentë) për të përmirësuar eficiencën e tyre të energjisë, duke kërkuar me ligj që ata të punësojnë një menaxher të energjisë dhe të kryejnë auditime të rregullta të energjisë për të adresuar kërkesat për EE-në.

- Vendosja e kritereve dhe standardeve për licencimin e audituesve të energjisë dhe ofruesit e shërbimeve energjetike (ESCO-t).

Praktikat më të mira e stimujve për investim në eficiencën e energjisë

Duke pasur parasysh rëndësinë e masave të eficiencës së energjisë (EE) që përfshijnë edhe shfrytëzimin e BRE-së, më poshtë janë shqyrtuar masat specifike të financimit dhe stimujt fiskalë bazuar në praktikat më të mira të identifikuara nga vendet anëtare të BE-së, sidomos nga anëtarët e rinj.

Tabela 5. Mekanizmat dhe stimujt financiarë

Mekanizmat financiarë	Fondet qarkulluese	**Mekanizmat fiskalë**	Zbritjet nga detyrimet e taksave
	Huat preferenciale		Ulja e taksave
	Subvencionet		Ulja e TVSH-së
	Grantet		Taksat e karbonit
	Garancitë e huave		
	Asistencë teknike për përgatitjen e huave	**Tarifat e energjisë**	Fondi publik EE
	Financimi i palëve të treta		Programi DSM në financë i drejtuar nga shërbimet
	Kontrata e performancës së energjisë		Investimet e përbashkëta për konsumatorët nga ana e kompanive të shërbimeve furnizimit të energjisë për të ulur nivelin e kërkesës
	Tregtimi (certifikata energjetike).		

Tabela 5 tregon llojet e stimujve që janë zbatuar nga shtetet anëtare të BE-së për të ndihmuar arritjen e synimeve të vendosura në PKVEE të ndryshme.

Rekomandime të stimujve për investim në eficiencën e energjisë

Për të mbështetur zbatimin e qëndrueshëm të PKVEE-së të 2-të dhe të 3-të (VKM-ja nr. 719/2016) propozohen rekomandime për mekanizmat e financimit dhe stimujt fiskalë në Shqipëri, me qëllim për të zbatuar të gjitha masat e parashikuara në skenarin për EE të kësaj strategjie.

Asnjë masë e vetme nuk do të shmangë sfidat me të cilat ballafaqohet Shqipëria. Vetëm një paketë gjithëpërfshirëse e ndërgjegjësimit dhe informimit mbi masat ligjore, financiare, fiskale dhe institucionale do të përmirësojë gradualisht situatën dhe do ta afrojë Shqipërinë drejt standardeve moderne në fushën e eficiencës së energjisë. Një paketë e tillë duhet të përfshijë:

- Vazhdimin e transpozimit të plotë të dy ligjeve (nr. 124/2015 dhe nr. 116/2016) për EE-në dhe miratimin e rregulloreve teknike dhe legjislacionit dytësor, të cilat duhet të përgatiten në periudhën afatshkurtër brenda 2019-s;

- Plotësimin e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë me staf dhe vënien e saj në funksion të plotë, si struktura kryesore për zbatimin e EE-së;

- Ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet;
- Fushatat e vazhdueshme të ndërgjegjësimit;
- Konsulencën e përhershme dhe informacione teknike mbi EE-në për të gjithë konsumatorët e energjisë;
- Krijimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë, si person juridik, me statusin e një organizate jofitimprurëse që synon të sigurojë mbështetje financiare dhe menaxhim projektesh për zhvillimin e një tregu të përmirësimit të eficiencës së energjisë dhe programeve mbështetëse për konsumatorët fundorë me investime me kosto dhe risk relativisht të lartë;
- Fondi do të përdoret, për: i) financimin e drejtpërdrejtë dhe promovimin e programeve për përmirësimin e eficiencës së energjisë, ii) për fuqizimin e kompanive të shërbimeve energjetike; iii) për të licencuar dhe aftësuar ekspertët e pavarur të energjisë dhe audituesit energjetikë; iv) për të kryer auditimin e energjisë te kompanitë publike të shpërndarjes së energjisë, operatorët e sistemit të shpërndarjes, kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë; dhe v) aftësimin bashkëkohor dhe instaluesit e pajisjeve me eficiencë të lartë duke kërkuar klasa energjie të përparuara.
- FEE-ja dhe AEE-ja do të mbështesë: i) Grantet për investime me kosto të ulët të EE-së për grupet në nevojë; ii) Auditimet e energjisë për ndërtesat publike; iii) Grantet për auditime energjetike të ndërtesave rezidenciale shumëkatëshe, shërbimeve komerciale dhe të industrisë; iv) Kreditë me norma interesi më të ulëta nga institucione financiare ndërkombetare për investimin e EE-së në ndërtesat publike; v) Studime të hollësishme mbi mekanizmat e përshtatshëm fiskalë për të mbështetur investimet e EE-së, veçanërisht në lidhje me uljen e TVSH-së për investimet e zgjedhura të EE-së; vi) Skemat specifike të financimit për grupet e familjeve në nevojë (me të ardhura të vogla) (p.sh. një mekanizëm "Paguani investimin duke kursyer"); vii) Studime të hollësishme mbi varfërinë energjetike dhe përballueshmërinë financiare të shërbimit të energjisë; si edhe viii) Nxitjet tarifore rregullatore për eficiencën e energjisë.

Modele të fondit të eficiencës së energjisë

Në bazë të ligjit të ri të eficiencës së energjisë, qeveria planifikon të krijojë së shpejti një fond për eficiencën e energjisë, i cili do të funksionojë si person juridik, me statusin e një organizate jofitimprurëse. Fondi për eficiencën e energjisë do të rregullohet nga një Bord i Administratorëve, me anëtarë që përfaqësojnë MIE-n dhe ministritë e tjera të angazhuara në përmirësimin e eficiencës së energjisë në fushat që janë nën përgjegjësinë e tyre.

Fondi për EE-në ka, gjithashtu, të drejtën ligjore të aplikojë njërin nga tri opsionet e financimit: 1) garancitë e huas; 2) zbritjet e normës së interesit ose zbritjet e investimeve; dhe 3) huat e drejtpërdrejta. Fondi EE nuk do të luajë rolin e bankës klasike. Secili nga modelet e Fondit të paraqitura më sipër mund të stimulojë potencialisht investimet e EE-së. Megjithatë, këto modele kanë ndikime të ndryshme në aspektin e aftësisë së tyre për të mobilizuar investime të reja, për të siguruar përdorimin efikas të kapitalit të Fondit dhe qëndrueshmërinë e funksionimit të Fondit. Disa avantazhe dhe disavantazhe të modeleve të Fondit janë renditur në tabelën 6:

Tabela 6. Avantazhet dhe disavantazhet e modeleve të fondit të eficiencës së energjisë

Modeli i Fondit	Avantazhet	Disavantazhet
Garancia e Huas	- Sigurimi i fondeve për investimet e EE-së që nuk janë financiarisht të zbatueshme në kushtet e kredisë aktuale; - Rreziku i reduktuar i mosshlyerjes ndihmon projektet për të siguruar kushte më të mira kredie nga bankat tregtare; - Garanci e lartë ndaj raportit të kredisë dhe mobilizimi i investimeve të larta të jashtme për projektet; - Mbështetje e mundshme për zhvillimin e skemave të financimit të EPC/ESCO; - Garancia mund të përdoret përsëri për kredi të reja, pasi kreditë aktuale të paguhen.	- Nëse pamundësia për të shlyer kreditë nga huamarrësit është më e lartë sesa pritej, burimet e Fondit mund të përdoreshin më shpejt sesa ishte planifikuar dhe aftësia e tij për të mbështetur huat e reja do të reduktohej; - Disa huamarrës nuk mund të përmbushin standardet e huas të Fondit dhe kështu nuk kualifikohen për financim; - Nëse Fondi paguan një tarifë për garancinë e tij, këto kosto mund t'i kalojnë huamarrësit, duke rritur kështu kostot totale të kredisë.
Norma e interesit/ Pagesa e zbritjes së investimit	- Kostoja e reduktuar e huamarrjes do të rrisë mundësinë e realizimit të projekteve; - Fondi përfiton nga portofoli dhe ekspertiza e klientëve të bankave tregtare; - Kufizimi ose mosekspozimi i Fondit ndaj rrezikut të kredisë së huamarrësit.	- Normat e interesit/zbritjet e investimeve do të reduktojnë kapitalin e Fondit derisa të shpenzohet; Nëse aplikohet zbritja e investimeve, burimet e Fondit do të shpenzohen më shpejt, duke mos lënë burime për projekte të tjera; - Nuk trajton rreziqet thelbësore që bankat mund të perceptojnë në marrjen e kredive; - Dobi shumë e kufizuar për investime të vogla.

Modeli i Fondit	Avantazhet	Disavantazhet
Huat e drejtpërdrejta	- Fondi ofron kredi me kushte më të favorshme dhe më fleksibël sesa ato të ofruara nga bankat tregtare; - Fondi është alternativa e fundit për disa projekte që nuk mund të marrin financim nga bankat tregtare; - Fondi mund të japë kredi për projektet që zbatohen në bazë të EPC / ESCO-s, duke mbështetur zhvillimin e këtij modeli të ri të biznesit; - Pasi të shlyhen kreditë, fondet mund të përdoren për të financuar projekte të reja (d.m.th., të veprojë si një fond riqarkullues).	- Shpenzime të rëndësishme që lidhen me trajnimin e personelit dhe funksionimin e Fondit (pasi Fondi vepron si bankë); - Pengesa të mundshme ligjore për krijimin dhe drejtimin e një fondi të tillë; - Fondi mbart të gjitha rreziqet e kredisë; - Nëse kapitali i Fondit është shpërndarë plotësisht, atëherë nuk do të ketë burime për të siguruar hua të reja për projekte të tjera derisa të jenë marrë pagesat e para.

Megjithatë, *<u>nëse të ardhurat vjetore të Fondit të EE-së sigurohen nga taksat e energjisë dhe mjedisit, atëherë mund të arrihet qëndrueshmëria e operacioneve të Fondit.</u>* Bazuar në avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve të fondeve të paraqitura më sipër, sugjerohen rekomandimet për zhvillimin e Fondit të EE-së:

- Të fillohet duke siguruar garanci huash;
- Të përcaktohen modelet e Fondit për projekte të ndryshme investimi;
- Të shfrytëzohet ulja e normave të interesit, sepse përfitimet për investime më të vogla janë të ulëta;
- Ngritja e kapaciteteve brenda FEE-së për të ofruar hua të drejtpërdrejta në planin afatmesëm, duke bashkëpunuar, aty ku është e mundur, me institucione të ngjashme ekzistuese shtetërore si Fondi i Garancisë ose Fondi i Zhvillimit;
- Vlerësimi tek alternativat e bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare dhe identifikimi për mënyrën sesi Fondi, institucionet partnere dhe klientët mund të përfitojnë nga ky bashkëpunim.

Institucionet financiare ndërkombëtare, zakonisht japin kredi për bankat pjesëmarrëse vendëse, që më pas, japin hua për shoqëritë e sektorit privat për projektet e eficiencës së energjisë në sektorët e shërbimeve, në ndërtesa dhe në industri. Në Shqipëri, ligji i ri për EE-në përcakton një rol të rëndësishëm të ESCO-ve dhe mbështetjen e qeverisë për ESCO-t, bazuar në legjislacionin e ri dytësor që do të përgatitet gjatë vitit 2018–2019 dhe do të delegojë zhvillimin e tyre vetëm te sektori privat.

Mekanizmat mbështetës të eficiencës së energjisë në sektorin e transportit

Në draftin e "Planit për transportin e qëndrueshëm 2017–2030", gjysma e masave në sektorin e transportit synohen drejtpërsëdrejti për autovetura dhe kjo përqindje rritet në 60%, nëse përfshihen edhe masat për zëvendësimin e karburantit (p.sh. në promovimin e biokarburanteve). Vetëm një numër i kufizuar masash trajtojnë transportin e mallrave, pavarësisht se është modaliteti i transportit me rritjen më të shpejtë të konsumit të energjisë në dekadën e fundit.

Dy të tretat e masave kombëtare synojnë përmirësimin e eficiencës ose reduktimin e emetimeve të CO_2 nga makina të reja, me stimuj financiarë për blerjen e makinave të reja më të efektshme/me emetime më të ulëta, duke qenë masa më e zakonshme. Bazuar në përvojën e shteteve të reja dhe të vjetra anëtare të BE-së, që mund të përdorin mekanizmat e ndryshëm financiarë dhe fiskalë, rekomandimet e mëposhtme mund të zbatohen në Shqipëri me qëllim që të sjellin përmirësime të rëndësishme të EE-së në sektorin e transportit:

- Qendrave teknike të automjeteve (QTA) t'u kërkohet të sigurojnë testime teknike rigoroze dhe të rregullta, duke përfshirë matjen e ndotësve të ajrit dhe emetimet e CO_2 për të gjitha kategoritë e makinave dhe transportin e mallrave;
- Hartimi i masave për një taksë të reduktuar blerjeje dhe i taksës vjetore për makinat me moshë të ulët dhe automjete të tjera duhet të lidhet me ecurinë e eficiencës energjetike. Shembulli i qeverisë franceze, ka treguar se veprime novatore në këtë fushë, kanë krijuar një skemë të kombinuar të subvencioneve dhe tatimeve, me një subvencion për makina me emetime të ulëta (p.sh. <130g CO_2 /km) dhe një taksë mbi makina me emetime të larta (d.m.th. mbi 161g CO_2 / km);
- Vendosja dhe zbatimi i kritereve të EE-së në prokurimin e automjeteve shtetërore dhe bashkiake dhe shërbimeve publike të transportit. Promovimi i makinave elektrike.

Ligji për energjinë e rinovueshme

Qëllimi i ligjit për BRE-në është të promovojë shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të Shqipërisë, veçanërisht në fushën e hidrocentraleve, burimeve të biomasës, energjisë diellore (PV), energjisë së erës dhe biokarburantëve. Përmes komunitetit të energjisë, Shqipëria ka vendosur një objektiv të detyrueshëm prej 38% të konsumit të saj bruto final të energjisë që do të plotësohet nga burimet e energjive të

rinovueshme deri më 2020-n, i cili është një objektiv ambicioz krahasuar me 33,1% në vitin 2014. Në mënyrë të veçantë, ligji për promovimin e BRE-së autorizon Këshillin e Ministrave për të miratuar masat mbështetëse për energjinë e rinovueshme, në përputhje me objektivat e vendosur në PKVBRE (2018–2020), si dhe duke marrë parasysh krijimin e një tregu konkurrues "të ditës në avancë" të energjisë elektrike nga BRE-ja. Një mekanizëm efektiv i KpD-ve, do të vendoset në momentin kur gjeneruesit e energjisë elektrike nga BRE-të, të kenë akses në një treg likuid me shumicë mbi bazën e të cilit do të dalë një çmim referimi. Kjo duhet të jetë e zbatueshme pasi Modeli i Tregut të jetë zbatuar plotësisht. Ligji nr. 7/2017 do të krijojë është agjencinë përgjegjëse të BRE-së për statistikat dhe menaxhimin e burimeve të rinovueshme. Gjithashtu, për promovimin e investimeve të burimeve të rinovueshme me qëllim transferimin e tyre në një treg tjetër në rajon është vendosur "certifikata e origjinës" që bën njohjen nga ERE të origjinës së rinovueshme të tregtimeve energjetike.

Reformat institucionale për sektorin e naftës dhe gazit

Përgjegjësitë dhe politikat aktuale të sektorit

Për të mbikëqyrur dhe për të ndarë përgjegjësitë funksionale në mënyrë efektive, qeveria ka parashikuar që:

1. MIE të vazhdojë të zhvillojnë mekanizma për politika dhe strategji të përshtatshme të sektorit hidrokarbur.
2. AKBN-ja, Albpetroli dhe ALBGAZ, deri tashmë, janë përgjegjës për të organizuar strukturat me qëllim mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtyre politikave në një mënyrë të pranueshme dhe për të siguruar përputhjen e tyre me ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet kontraktuale ekzistuese.
3. Ligji i hidrokarbureve është ndryshuar në shkurt të vitit 2017 dhe dokumentet ligjore përkatëse pasqyrojnë politika dhe praktika në përputhje me kushtet ndërkombëtare të zhvillimit të sektorit të naftës në përputhje me standardet e BE-së.
4. Të rriten e kapacitetet inspektuese të strukturave përkatëse që do të monitorojmë zbatimin e kuadrit rregullator në fushën e kërkimit dhe prodhimit.
5. Përcaktimi dhe strukturimi i dispozitave përkatëse për të siguruar zëvendësimin e rezervave të prodhuara të naftës bruto nëpërmjet, zbulimit të vendburimeve të reja dhe shfrytëzimin me mekanizma moderne dhe eficiente të vendburimeve ekzistuese.
6. ISHTI është përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë të të gjitha produkteve të importuara të naftës, shpërndarjen e tyre për të siguruar që publiku të ketë furnizime të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e tyre, që cilësia e tyre të plotësojë standardet ndërkombëtare dhe që të ketë rezerva të mjaftueshme të produktit për të mbështetur vonesat e papritura në zinxhirin e furnizimit.
7. Konsolidimi i kuadrit ligjor për sektorin e gazit në përputhje me paketën e tretë të energjisë do të krijojë një bazë solide për mbështetjen e politikave dhe projekteve për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, si dhe integrimin e tij rajonal në përputhje me praktikat dhe standardet e BE-së.
8. Përafrimi i legjislacionit për ndotjen dhe menaxhimin të rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në përputhje me angazhimet e Shqipërisë si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe direktivës përkatëse të BE-së.
9. Përgatitjet për ardhjen e gazit natyror të importuar përmes rrjetit të TAP-it, duke bërë të mundur integrimin dhe diversifikimin e furnizimit me burimet e energjisë.

Megjithëse shumica e këtyre masave dhe institucioneve aktualisht ekzistojnë, ato kërkojnë modifikime për t'i sjellë ato në aftësinë për të zbatuar me mjete efektive të menaxhimit, përputhshmëri me direktivat dhe rregulloret e BE-së. **Struktura e tyre duhet të modifikohet për t'iu përshtatur nevojave aktuale, misioni i tyre duhet të ripërcaktohet dhe ato duhet të pajisen me personel, të menaxhohen dhe të trajnohen në mënyrë bashkëkohore**. Autoriteti dhe përgjegjësitë duhet të caktohen dhe legjislacioni dytësor të hartohet për të përcaktuar këto mjete të reja.

Struktura e brendshme administrative e MIE-së duhet, për sa u përket hidrokarbureve, të përmbajë drejtori të ndara për secilën prej këtyre përgjegjësive. Veprimet prioritare për qeverinë në sektorin e naftës dhe gazit janë të listuara në tabelën 1.

Tabela 1. Prioritetet dhe veprimet e sektorit të naftës dhe gazit-1

Enti Rregullator i Energjisë	- Zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi për të vendosur gjoba deri në kufijtë e kërkuar nga Paketa e Tretë e Energjisë përkundrejt të gjitha palëve në sektorin e gazit natyror; - Plotësimin e strukturës duke plotësuar njësinë e gazit natyror dhe plotësimin e kompetencave brenda ERE-s për të plotësuar të gjithë kuadrin rregullator në lidhje me gazin natyror.
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	- Përmirësimi i menaxhimit të koncesioneve ekzistuese të Kompanisë Kombëtare të Naftës (ALBPETROL) dhe atyre që u janë dhënë kompanive të huaja për eksplorime dhe prodhime të reja të naftës; - Zhvillimi i rezervave të ardhshme nëpërmjet promovimit të investimeve private në një mënyrë të përgjegjshme mjedisore dhe transparente në aspektin financiar, duke përfshirë vlerësimin e rreptë të ndikimit në mjedis. - Aranzhimet për grumbullimin e të dhënave në lidhje me rezervat e sigurisë të produkteve të naftës në përputhje me direktivat e produkteve të BE-së; - Zhvillimi i planeve për krijimin e tregut shqiptar të gazit dhe integrimit të tij rajonal, si dhe për shitjen, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të gazit natyror nga TAP dhe burime të tjera të gazit para ardhjes së parashikuar të gazit; - Konsolidimi dhe forcimi i mëtejshëm i ALBGAZ s.a., mbi rolin e operatorit të kombinuar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit, si dhe për integrimin rajonal të rrjetit shqiptar të gazit; - Zbatimi i reformave të tregut të nevojshme për t'u pajtuar me acquis e komunitetit të energjisë; - Përmirësimi i strukturës administrative të MIE duke forcuar dhe konsoliduar Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Industrisë dhe Energjisë në sektorin e naftës dhe gazit.

MIE, përmes Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Industrisë dhe Energjisë dhe Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, duhet të zhvillojë dhe konsolidojë rolet dhe funksionet specifike të organizimit të sektorit të naftës dhe gazit në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Është e rëndësishme që kompetenca e ministrisë të jetë e tillë që kompanitë operative të kenë një pikëpamje të qartë për atë që kërkohet prej tyre dhe se do të ketë gjoba për mospërputhje. Veprimet prioritare për MIE-n në lidhje me sektorin e naftës dhe gazit janë të listuara në tabelën 2.

Tabela 2. Prioritetet dhe veprimet e sektorit të naftës dhe gazit - 2

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive për Industrinë dhe Energjinë	- Monitorimi i operacioneve ekzistuese me qëllim rinovimin e tyre ose sjelljen e tyre në një përfundim real, duke përfshirë rregullimin e mjedisit; - Planifikimi për furnizimin dhe kërkesën kombëtare për produktet e naftës: prokurimi, kontrolli i cilësisë, grumbullimi i stokut të rezervës së sigurisë, shpërndarja e produktit dhe taksat përkatëse (që do të kenë ndikim në çmimet); - Planifikimi për eksplorimin dhe zhvillimin modern të rezervave kombëtare të naftës; - Shfrytëzimi i industrisë për të sjellë fonde të investimeve të huaja direkte, për të rritur transferimin e teknologjisë, zhvillimin e infrastrukturës, krijimin e vendeve të punës, trajnimin dhe shfrytëzimin e mallrave dhe shërbimeve vendore.
Drejtoria e Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë	- Parashikimi, formulimi, adoptimi, ekzekutimi, monitorimi i politikave në lidhje me gazin natyror; - Monitorimi i operacioneve ekzistuese me qëllim të rinovimit të tyre ose sjelljes së tyre në një ndërprerje realiste, duke përfshirë rregullimin e mjedisit; - Planifikimi për furnizimin dhe kërkesën kombëtare për gaz: prokurimi, garantimi i sasive të nevojshme dhe përcaktimi i kushteve për transmetimin e këtyre sasive, duke marrë në konsideratë realizueshmërinë për konsumatorët; - Planifikimi për shfrytëzimin e e gazit natyror nga gazsjellësi TAP; - Shfrytëzimi i industrisë për të sjellë fonde të investimeve të huaja direkte, për të rritur transferimin e teknologjisë, zhvillimin e infrastrukturës, krijimin e vendeve të punës, trajnimin dhe shfrytëzimin e mallrave dhe shërbimeve vendore.

Plani strategjik për naftën dhe gazin natyror

Shqipëria do të sigurojë një lidhje kyçe dhe do të ketë rol konkret institucional në plotësimin e nyjave energjetike që lidhin Italinë, Evropën Qendrore dhe shtetet e Ballkanit. Vizioni i qeverisë shqiptare është nxitja e zhvillimit ekonomik, duke shërbyer si korridor i tranzitit të energjisë për energjinë elektrike, gazin natyror dhe naftën në të gjitha format e tij, për të kaluar në pjesën më të madhe të Evropës nga deti dhe nëpërmjet tubacionit tokësor të naftës. Vendndodhja e saj gjeografike e vendos Shqipërinë në pozicionin e ndarjes së

burimeve të sapopërftuara të energjisë me ato të fqinjëve të saj në Evropën Juglindore nëpërmjet zhvillimit të rrjeteve të qarkullimit të energjisë për të forcuar sigurinë rajonale të energjisë së vendeve fqinje, si dhe sigurinë e vet.

Gazsjellësi TAP do të jetë funksional në pak vite, çka e bën thelbësore fuqizimin e potencialit të eksplorimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit në Shqipëri dhe në det të hapur, hartimin e një plani strategjik të integruar për të gjithë nënsektorin ekonomik të naftës dhe gazit.

Në këto kushte natyrshëm në një strategji kombëtare për sektorin e naftës dhe gazit përfshin:

1. Krijimin e një standardi bazë që përcakton në mënyrë të përshtatshme vendin aktual të Shqipërisë në zhvillimin e sektorit të naftës dhe gazit në rajon;
2. Përcaktimin e një sërë objektivash zhvillimi që duhet të arrihen kundrejt vitit 2030;
3. Krijimin e planeve të detajuara për zbatimin e secilit komponent të planit strategjik;
4. Politika dhe institucione të aftë për elementet e administrimit teknik, ligjor, rregullator dhe pajtueshmërisë rregullatore që kërkohet për të administruar dhe menaxhuar në mënyrë efikase zhvillimin ekonomik të burimeve kombëtare të naftës.

Pjesa më e madhe e këtyre elementëve tashmë është realizuar, por është e nevojshme të organizohet dhe të vendoset në formën e një plani. Deri tani ka pasur hapa të qartë në këtë drejtim brenda sektorit të hidrokarbureve në Shqipëri, pasi për sa i përket sektorit të gazit është miratuar masterplani i zhvillimit të gazifikimit në Shqipëri (miratuar me VKM-në nr. 84, datë 14.2.2018), gjë e cila në periudhën në vazhdim duhet harmonizuar dhe integruar edhe me sektorin e naftës.

Institucionet e sektorit të energjisë

Institucionet kryesore të politikave, strategjive, programeve, rregullimit dhe operatorët janë:

1. Aktorët qeveritarë dhe rregullatorë, të cilët përfshijnë qeverinë dhe ministritë, rregullatorin dhe agjencitë të cilave ministritë i delegojnë përgjegjësitë specifike;
2. Kompanitë e sektorit publik, të tilla si: KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., të cilët janë aktualisht lojtarë kryesorë të sektorit të energjisë elektrike;
3. Linja e mbikëqyrjes nga ministria përkatëse për secilën kompani të sektorit publik për të përmbushur kërkesat e acquis.



Figura 12 paraqet një pasqyrë të institucioneve dhe kompanive kryesore të sektorit të energjisë në Shqipëri

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE): MIE është përgjegjëse për sektorin e energjisë dhe për zhvillimin e politikës energjetike, si dhe strategjive afatmesme dhe afatgjata për sektorin e energjisë. Fusha kryesore e fokusit të MIE-së në sektorin e energjisë është zbatimi i reformave për të harmonizuar politikën dhe rregulloret shqiptare me acquis të BE-së për energjinë. Ky proces ka pasur progres të ndjeshëm së fundmi, me miratimin e ligjit për sektorin e energjisë elektrike, ligjit për EE-në, ligjit për performancën e energjisë të ndërtesave dhe ligjit për BRE-në. Ministria, përmes Agjencisë e Eficiencës së Energjisë (Agjencia EE) dhe Fondit për Eficiencë të Energjisë (Fondi EE), është angazhuar në zbatimin e reformave për të përmirësuar eficiencën e energjisë, veçanërisht në zbatimin e ligjit për performancën e energjisë në ndërtesa (PEN).

Enti Rregullator i Energjisë (ERE): Enti Rregullator i Energjisë është një organ i pavarur publik, përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror. ERE është organi kompetent për dhënien e licencave për aktivitetet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, si dhe të licencave për kryerjen e transmetimit, shpërndarjes, furnizimit dhe tregtimit të gazit natyror. ERE është përgjegjës për miratimin e kodeve të rrjetit që rregullojnë lidhjen dhe aksesin në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes për të gjithë prodhuesit e energjisë. ERE, gjithashtu, ka përgjegjësinë për miratimin e tarifave në sektor, duke përfshirë tarifat e shitjes së energjisë elektrike për prodhuesit e BRE-ve, tarifat për akses në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe tarifat për konsumatorët fundorë të furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal. ERE miraton dokumentet standarde siç është PPA-ja standarde që do të përdoret nga prodhuesit me përparësi të BRE-së. ERE është, gjithashtu, përgjegjëse për zhvillimin e shumicës së legjislacionit dytësor në sektor, si dhe miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike.

Agjencia për Eficiencën e Energjisë: Agjencia për Eficiencën e Energjisë ("Agjencia për EE-në") është krijuar në bazë të detyrimit që lind nga ligji për EE-në. Vënia në funksionim të plotë të Agjencisë për EE-në është qartazi një prioritet i qeverisë bazuar në ligjin për EE-në. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë për EE-në janë të detajuara në nenin 25 të ligjit për EE-në dhe janë si më poshtë, ndërkohë që veprimet prioritare që ajo do të kryejë në vijim janë sanksionuar me ligj.

Fondi për Eficiencën e Energjisë: ligji për EE-në parashikon krijimin e një Fondi për Eficiencën e Energjisë, i cili do të menaxhohet nga një Bord i Administratorëve të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme publike. Fondi për Eficiencën e Energjisë do të financohet përmes marrëveshjeve me donatorët dhe do të themelohet dhe operohet si një ent publik i pavarur. Ligji për EE-në përcakton qartë llojet e projekteve që mund të mbështeten financiarisht nga Fondi.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - AKBN: Është nën varësinë e drejtpërdrejtë të MIE-t. Roli i AKBN-së është zhvillimi, mbikëqyrja e përdorimit racional të burimeve natyrore, sipas politikave të qeverisë, dhe monitorimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe rehabilitimit të burimeve natyrore në miniera, hidrokarbure dhe energji. Këto përgjegjësi përfshijnë përveç të tjerave, promovimin e burimeve minerare, të hidrokarbureve, hidrocentraleve dhe burimeve të rinovueshme të energjisë; shqyrtimin analitik dhe teknik të studimeve dhe projekteve në fushën e veprimtarisë së minierave, hidrokarbureve dhe energjisë, të paraqitura nga subjektet qeveritare ose private, vendëse ose të huaja; negocimi i marrëveshjeve të naftës dhe minierave dhe monitorimi i zbatimit të planeve të tyre të zhvillimit; monitorimi i kontratave koncensionare për hidrocentralet; hartimi dhe publikimi i bilancit vjetor të energjisë, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e Eurostat dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë.

Kompanitë publike të energjisë

Kompanitë publike të energjisë, në pronësi të shtetit, që ofrojnë shërbime të përcaktuara në sektorin e energjisë janë përfshirë në një proces të gjerë reformash, siç janë kërkesat e shpërbërjes dhe futja e niveleve në rritje të konkurrencës në këtë sektor. Tabela 1, më poshtë, paraqet disa nga implikimet kryesore të reformës për këto kompani.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare – KESH sh.a. mbetet gjeneruesi dominues i energjisë elektrike në Shqipëri, duke prodhuar më shumë së 75% të energjisë elektrike. Sot KESH-i është shndërruar në një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit dhe ka filluar të funksionojë si një kompani tregtare. Sidoqoftë, veprimtaria e KESH-it rregullohet ende në përputhje me detyrimin e shërbimit publik, sepse pjesa më e madhe e prodhimit i alokohet OSHEE-së për furnizimin e konsumatorëve tariforë.

Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST sh.a.: OST-ja është Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri që menaxhon rrjetin me tension 110 kV e lart. Në kuadër të zbatimit të reformave të sektorit të energjisë, OST-ja ka tri role kryesore: i) mbetet pronari dhe operatori i rrjetit të transmetimit; ii) të krijojë Bursën Shqiptare të Shkëmbimit të Energjisë, që do të jetë platforma primare për tregun konkurrues të energjisë. Ky është një rol i ri në tregun shqiptar për të cilin OST-ja do të ketë nevojë për të ndërtuar kapacitete të reja; dhe iii) do të vazhdojë të mbetet përgjegjës për balancimin e sistemit përmes prokurimit të shërbimeve balancuese dhe ndihmëse.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – OSHEE sh.a. zotëron sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në rrjetin me tension më të ulët se 110 kV. OSHEE-ja është një entitet i vetëm juridik që përfshin si Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes ("OSSH"), ashtu dhe Furnizuesin e Shërbimeve Universale. Në vitin 2009, OSSH-ja u privatizua për të siguruar investime, për të përmirësuar efikasitetin operacional, për të zvogëluar humbjet e energjisë dhe për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave. Megjithatë, që në fillim, nisën të shfaqen kontradikta midis CEZ-it, pronarëve të rinj të OSSH-së dhe qeverisë lidhur me nivelet për borxhet

e këqija, normën e reduktimit të humbjeve dhe nivelet vjetore të tarifave. Licenca e shpërndarjes u hoq nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në vitin 2013, me arsyetimin se kompania e shpërndarjes nuk kishte arritur të plotësonte kushtet e licencës së saj.

Kompania u kthye në pronësi publike në vitin 2014 dhe filloi një program ambicioz të zvogëlimit të humbjeve dhe përmirësimit të arkëtimit, që pati rezultate të dukshme në përmirësimin e pozicionit financiar të kompanisë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OSHEE-ja po punojnë për të ndarë rrjetin e shërbimit të shpërndarjes nga Furnizuesi i Shërbimit Universal të konsumatorëve tariforë. Ndarja e OSHEE-së është një detyrim sipas acquis së Komunitetit të Energjisë dhe ligjit për sektorin e energjisë, i cili do të krijojë më shumë transparencë për të gjithë përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes.

Tabela 1. Prioritetet dhe veprimet e sektorit të energjisë – operatorët publikë

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)	- Forcimi i kapaciteteve të reja (sidomos në lidhje me tregtimin e energjisë), në kushtet kur KESH-i do të duhet të shesë energji dhe të konkurrojë në tregun e ri; - Mosndërhyrja në çmimet e prodhimit dhe përfundimi i kontratës së plotë të furnizimit me OSHEE-në; - Rritja e kapacitetit të saj gjenerues duke u bërë një lojtar kyç në rajon.
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	- Përgatitja e llogarive të ndara për OST-në dhe funksionet e operatorit të tregut të OST-së; - Përgatitja e rregullave për sigurinë e rrjetit, cilësinë e furnizimit dhe procedurat për lidhjet e reja; - Finalizimi i rregullave të tregut, duke përfshirë rregullat për ndarjen e ndërlidhjes ndërkufitare ose kapaciteteve; - Përgatitja e parashikimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të kërkesës për energji elektrike; - Përgatitja e një plani zhvillimor dhjetëvjeçar për Shqipërinë dhe sigurimi i përditësimeve të planit vjetor të investimeve së bashku me aplikimet vjetore të tarifave; - Rekrutimi dhe trajnimi i stafit për të operuar dhe për të vendosur tregun në përputhje me rregullat e reja të tregut; - Krijimi i Bursës Shqiptare të Energjisë.
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)	- Vazhdimi i investimeve për të ulur më tej humbjet e shpërndarjes dhe për të përmirësuar normat e arkëtimit; - Përgatitja e rregullave për sigurinë e rrjetit, cilësinë e furnizimit dhe procedurat për lidhjet e rrjetit; - Përgatitja e një plani 5-vjeçar të zhvillimit për rrjetin e shpërndarjes dhe sigurimi i përditësimeve të planit vjetor të investimeve së bashku me aplikimet tarifore vjetore; - Përcaktimi i roleve të reja, që do të merren përsipër në kuadër të zbatimit të modelit të ri tregut, për shembull në menaxhimin e KpD-ve me gjeneruesit privatë; - Kompletimi i ndarjes ligjore dhe operacionale të funksioneve të shpërndarjes dhe furnizimit brenda vitit 2018; - Ndërtimi i aftësive operacionale për të kryer përgjegjësitë sipas modelit të ri të Tregut, p.sh. blerjen e energjisë në Bursën e Energjisë, duke menaxhuar kontrata me gjenerues të BRE-së dhe përpunimin e konsumatorëve që ndryshojnë furnizuesin e energjisë elektrike.

ALBPETROL

ALBPETROL-i është një ndërmarrje e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit, plotësisht në pronësi të qeverisë, e cila ka të drejtat ekskluzive për zhvillimin e të gjitha vendburimeve ekzistuese të naftës dhe gazit. Pjesa më e madhe e prodhimit të naftës mbi të cilin ALBPETROL-in ka të drejta prodhimi, është kontraktuar në kompanitë e huaja prej të cilave pothuajse 60% eksportohen për rafinim në produkte jashtë vendit, gjë e cila varet nga konjukturat e tregut të rafinimit të naftës bruto në vend, duke pasur ndryshime të vazhdueshme të sasive të naftës bruto të përpunuara në vend. Rezervat e naftës dhe gazit ende të pazbuluara në Shqipëri, si në det të hapur dhe në tokë, besohet të jenë të rëndësishme, por kërkimi i tyre do të kërkojë përdorimin e teknologjive të sofistikuara të cilat është synuar që të sigurohen nga tërheqja e investitorëve të huaj që disponojnë kapacitete të tilla. Po punohet që të zhvillohen programe për t'i paraqitur këto mundësi industrisë ndërkombëtare të naftës në një mënyrë të strukturuar si një mjet për t'i kthyer ato në burime shumë të rëndësishme zhvillimi ekonomik për Shqipërinë.

Rezervat ekzistuese dhe potenciale të hidrokarbureve kanë potencial të konsiderueshëm për Shqipërinë për përfitime të konsiderueshme ekonomike nga shfrytëzimi më i madh dhe intensiv i naftës. Në vendburimet kryesore të naftës në Shqipëri të cilat janë vlerësuar me rezerva gjeologjike në 437 milionë tonë, nga të cilat, deri më tani, janë prodhuar rreth 62,3 milionë tonë naftë, kanë mbetur ende edhe afërsisht rreth 46,9 milionë tonë naftë rezerva të nxjerrshme, sipas vlerësimit të AKBN-së. Duke pasur në konsideratë që rezervat e nxjerrshme të naftës kushtëzohen edhe nga mënyrat e shfrytëzimit dhe teknologjia që aplikohet në vendburime, sasia e llogaritur e rezervave të nxjerrshme mund të ndryshojë me kohën. Të gjitha shifrat e lartpërmendura bazohen në shifrat e deklaruara të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe të

AKBN-së. Kuadri rregullator dhe investues i Shqipërisë për eksplorimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit që nga kalimi i ligjit të naftës në vitin 1993, ka qenë i paefektshëm në nxitjen e zhvillimit të këtyre burimeve të konsiderueshme të hidrokarbureve. Amendimi i ligjit të naftës në shkurt 2017 ka përmirësuar ndjeshëm këtë ligj. Dështimi i dy raundeve të licencimit në vitet 1990, kur çmimet e naftës së papërpunuar ishin shumë më të ulëta se sot, çuan në një qasje ad-hoc të pastrukturuar për negociatat për licencimin. Megjithatë, shteti ka bërë të gjitha përpjekjet për të promovuar hapësirat e saj të brendshme ndërkombëtarisht përmes "politikës së dyerve të hapura" dhe pjesëmarrjes aktive në konferenca ndërkombëtare. Kjo ishte evidente edhe gjatë organizimit për herë të parë në Samitin e Naftës dhe Gazit, mbajtur në Tiranë, në vitin 2015, ku morën pjesë pothuajse të gjitha kompanitë ndërkombëtare të njohura, si: SHELL, Exxon Mobil, BP, SOCAR, ENI etj.

Rafineritë

Tregu i Shqipërisë për produktet e rafinuara është i vogël sipas standardeve evropiane, me një konsum total prej rreth 1 milion ton metrikë (mt) në vit. Në situatën aktuale është domosdoshmëri rritja e kapaciteteve të rafinimit të naftës bruto në vend, nëpërmjet përmirësimit të teknologjive në rafineritë ekzistuese (në Ballsh dhe në Fier) sipas standardeve bashkëkohore, apo zhvillimit të rafinerive të reja sipas standardeve evropiane.

Kërkesa e produkteve të naftës është e përqendruar në transport dhe në një masë më të vogël, nga sektori i bujqësisë, dhe dominohet nga dizeli dhe benzina. Shqipëria mbështetet kryesisht në karburantet e importuara, të cilat janë lehtësisht të disponueshme në tregun rajonal nga vendet e Mesdheut.

Cilësia e produkteve të naftës është përmirësuar vazhdimisht dhe ka arritur nivelin mesatar të BE-së, pasi niveli i abuzimit me cilësinë nuk është më shumë se 5% e sasisë totale, por është dëmtuar nga produktet nën standard. Numri i stacioneve të karburanteve për shitjen me pakicë në krahasim me popullsinë aktualisht është shumë i lartë sipas standardeve evropiane dhe po synohet që të zvogëlohet ndjeshëm në mënyrë që të përmbushë praktikat më të mira evropiane.

ALBGAZ

ALBGAZ sh.a. është një ndërmarrje e zotëruar tërësisht e qeverisë, e krijuar në formën e një operatori të transmetimit dhe shpërndarjes së kombinuar të gazit. (VKM-ja nr. 848, datë 7.12.2016). ALBGAZ sh.a. do të angazhohet në realizimin e projekteve të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, si dhe për ndërlidhjen e Shqipërisë me rrjetet rajonale të gazit.

Kompania ALBGAZ përfshin mundësinë e bashkëpunimit me kompanitë e huaja që aktualisht operojnë në Shqipëri, si TAP AG, por edhe me kompani të tjera që mund të jenë të pranishme në të ardhmen.

Tabela 3. Prioritetet dhe veprimet e sektorit të naftës dhe gazit – 3

ALBPETROL-i dhe AKBN-ja për aktivitetet e kërkimit dhe prodhimit	- Reformimi dhe ristrukturimi i shoqërisë ALBPETROL në mënyrë eficiente. - Ofrimi i stimujve për eksplorimin e shpejtë dhe zhvillimin e prodhimit; - Zhvillimi i një rrjeti të ri me blloqe shumë më të vogla eksplorimi për çdo sipërfaqe të hequr ose të rikthyer; - Vendosja e një praktike për mbajtjen e raundeve të licencimit formal dhe të shpeshtë sa më shpejt të jetë e mundur dhe kjo gjë mund të arrihet tashmë nëpërmjet ligjit të ri të naftës që lejon 2 faza të licencimit; - Ripërcaktimi i kompetencave dhe autoritetit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) si agjenci teknike në drejtim të monitorimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve të kompanive të naftës dhe gazit duke përfshirë edhe ALBPETROL-in; - Diskutimet e brendshme brenda MIE-t duhet të fokusohen në rritjen e ekspertizës profesionale të AKBN-së, si bazë për Departamentin Teknik, me kontribute nga njësia e negocimit të kontratave. - Konsiderimi i thjeshtimit të sistemit fiskal në kërkim dhe zhvillim,
ALBGAZ sh.a. operator i kombinuar për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit	- Konsolidimi i ALBGAZ s.a. me qëllim të rritjes së aftësive dhe kompetencave në aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit dhe zhvillimit të rrjeteve të gazit në Shqipëri dhe ndërlidhja me rajonin dhe më tej; - Përgatitja e një deklarate të ndikimit mjedisor në lidhje me atë se ku do të kalojë korridori i linjës së transmetimit të gazit dhe marrja e miratimit nga Ministria e Mjedisit; - Finalizimi i Planit Kombëtar për Sektorin e Gazit në përputhje masterplanin përkatës të promovimit të gazit natyror dhe fillimi i planifikimit dhe buxhetimit në mënyrë që planet, dhe fondet e nevojshme të mund të zhvillohen para ardhjes së gazit TAP në tri–katër vitet e ardhshme.

Inspektorati shtetëror teknik dhe industrial (ISHTI)

ISHTI është një agjenci që raporton te MIE dhe që është përgjegjëse për aspektet e sigurisë publike të mallrave në treg, duke u përqendruar tek instalimet dhe pajisjet për transportimin, depozitimin dhe

shpërndarjen/tregtimin e naftës dhe gazit, te pajisjet dhe instalimet elektrike, enët nën presion (sidomos depozitat LPG për familjet dhe biznesin e vogël).

ISHTI është, gjithashtu, përgjegjës për aspektet e sigurisë publike të pajisjeve të përdorura në prodhimin e energjisë, transportimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Kontrolli i cilësisë së karburanteve hidrokarbure të importuara përfshihet brenda mandatit të Inspektoratit, gjë për të cilën është kërkuar edhe një personel i kualifikuar, si dhe sigurimi i pajisjeve të përshtatshme për testim për të garantuar standardet e nevojshme të cilësisë së produkteve që qarkullojnë në treg. Meqenëse ISHTI ka përgjegjësi si për sektorin e energjisë elektrike, ashtu dhe për sigurinë në infrastrukturën e gazit, MIE e ka përfshirë në veprimet prioritare të saj forcimin e kapaciteteve të këtij Inspektorati.

Tabela 4. Prioritetet dhe veprimet e sektorit të naftës dhe gazit - vazhdimi

Agjencia Kombëtare e Mjedisit	- Kryerja në vijimësi e monitorimit të aktiviteteve të naftës dhe gazit në kërkim dhe zhvillim dhe përpunim me qëllimin kryesor që të ndjekë në mënyrë strikte Planin e Zbutjes dhe Menaxhimit të Mjedisit për çdo kompani të naftës dhe gazit.
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)	- Zhvillimi dhe zbatimi i demarkacionit të qartë ndërmjet agjencive, se kush është përgjegjës për planifikimin e sektorit të energjisë dhe statistikat të cilat duhet të përputhen me standardet e BE-së; - Zhvillimi i legjislacionit dytësor për mbledhjen e të dhënave të energjisë në përgjithësi dhe produkteve të naftës në veçanti, duke përfshirë pyetësorin SMN (statistikat mujore të naftës).
Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial	- Rritja e kompetencës teknike të stafit të inspektorateve me prioritet në sektorin e gazit; - Sigurimi i aparaturave laboratorike dhe pajisjeve të nevojshme për të ndërmarrë inspektimet e mandatuara.

Legjislacioni dhe përafrimi i direktivave të BE-së

Statusi i përafrimit të sektorit të energjisë në Shqipëri me direktivat e BE-së përmblidhet në tabelën 12.

Tabela 3. Statusi i përafrimit të sektorit të energjisë shqiptare me direktivat e BE-së

ENERGJIA ELEKTRIKE		
Legjislacioni Zbatueshëm	Direktiva e BE-së	Statusi i përafrimit
Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar	Direktiva 2009/72/KE në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike që shfuqizon direktivën 2003/54 / KE	→ Ky ligj është i përafruar plotësisht me direktivën 2009/72/EC të BE-së dhe Rregullat e Paketës së Tretë të Tregut të Brendshëm të Energjisë së B.E-së
GAZI NATYROR		
Ligji nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror."	Direktiva 2009/73/KE në lidhje me rregullat e përbashkëta për një treg të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55 / KE	→Ligji specifikon legjislacionin e rëndësishëm dytësor të nevojshëm për zbatimin e tij, siç është kodi i shpërndarjes së gazit dhe përfshirja e një operatori të sistemit të transmetimit që do të miratohet nga ERE. → Gjithashtu, zbatimi praktik i të drejtave të konsumatorëve ende duhet të zhvillohet nëpërmjet legjislacionit dytësor, që duhet ende të miratohen nga qeveria dhe ERE. → Zbatimi i ligjit të sektorit të gazit natyror do të lehtësojë zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së brendshme të gazit të nevojshme për gazifikimin e ekonomisë së vendit.
BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË		
Ligji nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshm".	Direktiva 2009/28/KE, mbi nxitjen e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e rinovueshme	→Ky ligj përafrohet pjesërisht me direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian. → Ky ligj përcakton disa stimuj për operatorët që prodhojnë energji nga burimet e rinovueshme, si dhe parashikon të drejtën për të aplikuar dhe siguruar nga ERE garancitë e origjinës për çdo 1 mwh të energjisë së rinovueshme të prodhuar. Ligji është relativisht i ri dhe ka legjislacion të rëndësishëm dytësor për zbatimin e tij.

Ligji për biokarburantet në transport	Direktiva 2003/30/KE	Direktiva është shfuqizuar në BE dhe në komunitetin e energjisë, e zëvendësuar me direktivën 2009/28/KE; ligji nr. 7/2017 nuk përfshin nenet përkatëse (17 deri 21) të lidhura me biokarburantet. Ligji ekzistues për biokarburantet duhet rishikuar ose një ligj i ri duhet të miratohet në mënyrë që të jenë në përputhje me dispozitat e direktivës së re të BE 2009/28 / KE për biokarburantet dhe trajtimin e çështjeve të masave për të arritur objektivin e biokarburanteve, skemën e verifikimit të qëndrueshmërisë, etj.
EFICIENCA E ENERGJISË		
Ligji për eficiencën e energjisë	Direktiva 2012/27/ BE për eficiencën e energjisë	Përafrohet pjesërisht me direktivën 2012/27/BE. Gjithashtu, parashikon krijimin e një Agjencie të Eficiencës së Energjisë dhe një fondi për efikasitet energjetik. Agjencia e Eficiencës së Energjisë u formua zyrtarisht nga qeveria në dhjetor 2016, ndërsa procesi i themelimit të fondit është në vazhdim. Shqipëria ka miratuar PKVEE 2 dhe 3 dhe seksionin e legjislacionit dytësor për zbatimin e ligjit për eficiencën e energjisë. Ligji duhet të ndryshohet për të përfshirë të gjitha kërkesat e direktivës 2012/27/BE.
Ligji nr. 116/2016 "Mbi performancën e energjisë së në ndërtesa"	Direktiva 2010/31/ BE mbi performancën e energjisë në ndërtesa	I përafruar pjesërisht me direktivën 2010/31/BE mbi performancën energjetike në ndërtesa, ligji u miratua nga parlamenti në nëntor 2016 dhe hyri në fuqi në fillim të vitit 2017. Masa e kërkuar: → Është i rëndësishëm krijimi i Agjencisë së EE-së të parashikuar nga ligji për eficiencën e energjisë nr. 124/2015, sepse kjo agjenci do të verifikojë dhe mbikëqyrë zbatimin e performancës energjetike në ndërtesa ; → Krijimi i Fondit EE për të mbështetur masat e eficiencës së energjisë.
Ligji nr. 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji"	Direktiva 2010/30/ BE mbi etiketimin e energjisë	Ligji ende nuk është në përputhje me etiketimin e pajisjeve elektro-energjetike krahasuar me aktet e deleguara të BE-së. Më tej, legjislacioni dytësor për etiketimin e pajisjeve elektro-energjetike është ende në proces. Aktualisht, të vetmet akte nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji janë: - VKM nr. 65, datë 21.10.2015 "Për rregullat teknike për etiketimin e konsumit të energjisë nga kondicionerët"; - VKM nr. 928, datë 19.12.2012 "Për miratimin e rregullit teknik "Për etiketimin e makinave larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë".

Harmonizimi i politikës shqiptare për ndryshimet klimatike me direktivat ndërkombëtare dhe të BE-së

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), e miratuar në "Samitin e Tokës në Rio" në vitin 1992, i cili vendosi objektivin për të luftuar ndryshimet klimatike duke stabilizuar përqendrimet e GHG-së në atmosferë dhe duke kufizuar rritjet mesatare të temperaturës globale për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Marrëveshja e Parisit, e miratuar në dhjetor 2015, siguron një kuadër të përbashkët për të gjitha palët që synojnë ruajtjen e rritjes së temperaturës mesatare globale nën 2°C mbi nivelet para-industriale. Për arritjen e një qëllimi të tillë afatgjatë, palët duhet të synojnë arritjen e pikut të nivelit global të emetimeve të GHG-ve "sa më shpejt që të jetë e mundur", duke pranuar se rritja do të zgjasë më shumë për palët e vendeve në zhvillim dhe për të ndërmarrë, më pas, reduktime të shpejta në përputhje me praktikat shkencore më të mira në dispozicion, për të arritur një ekuilibër midis emetimeve prej aktiviteteve njerëzore nga burimet dhe eliminimeve nëpërmjet përthithjes nga shtimi dhe rritja e pyjeve

Bazuar në skenarin bazë të emetimeve të GHG dhe në Komunikimin e Tretë Kombëtar nevojat energjetike në sektorin e transportit do të rriten në të njëjtin ritëm që po rriten që nga viti 2000. Masat e mundshme për rritjen e efikasitetit të energjisë, nën skenarin EE dhe reduktimin e shkarkimeve të GHG, janë si më poshtë:

- Zbatimi i objektivave të EE-së për sektorët e transportit të Shqipërisë, bazuar në PKVEE 2 dhe 3 të miratuar;

- Zbatimi i objektivave të BRE-së për sektorët e transportit (sidomos rritja e kontributit të biokarburanteve që do të konsumohen në këtë sektor sipas objektivave përkatës) të Shqipërisë në bazë të PKVBRE-së;

- Rindërtimi i rrugëve ekzistuese të cilësisë së dobët dhe ndërtimi i rrugëve të reja;
- Mirëmbajtja e rrugëve përmes bashkë-punimit të sektorit publik me atë privat;
- Rritja e pjesës së transportit publik për pasagjerët dhe transportin e mallrave (rrugë, hekurudhë dhe rrugë ujore);
- Rritja e taksave për makinat e kategorisë së dytë për të reduktuar në maksimum hyrjen e tyre në tregun shqiptar;
- Promovimi i një sistemi të integruar të transportit intermodal, i cili përfshin infrastrukturën/transportin përmes tokës dhe detit;
- Ristrukturimi i mëtejshëm i sistemit hekurudhor, krijimi i Autoritetit Hekurudhor Shqiptar, riorganizimi i Hekurudhave Shqiptare, nëpërmjet ndarjes së plotë të aktiviteteve operative nga aktivitetet e menaxhimit dhe mirëmbajtja e infrastrukturës;
- Intensifikimi i punës për krijimin e një sistemi të integruar të transportit, i fokusuar në lidhjen e porteve të Durrësit, Vlorës dhe Shëngjinit me linjë hekurudhore;
- Ndërtimi i një porti intermodal në Shëngjin, i cili do të jetë një nga portet më të mëdha në rajon dhe do të shërbejë si pikë lidhëse midis detit Adriatik dhe vendeve të tjera në Ballkanin qendror dhe lindor;
- Ndërtimi i porteve të reja turistike, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme dhe logjistikën moderne për këtë qëllim;
- Hapja e tregut dhe ulja e kostos së tarifave të udhëtimit për udhëtarët, me qëllim të rritjes së lëvizjes së udhëtarëve dhe mallrave;
- Promovimi i investimeve të bazuara në partneritetin publik-privat për qëllime të turizmit vendës;
- Ndërtimi i një aeroporti të ri në jug të vendit (Vlorë);
- Rritja e bashkëpunimit rajonal në fushën e transportit ajror;
- Të mundësohet një performancë më e mirë e funksioneve të sigurisë ajrore, si dhe forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike në këtë sektor.

Marrëveshja e Parisit synon, gjithashtu, të forcojë aftësinë për t'iu përshtatur ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm, dhe me shkarkime të ulëta të dyoksidit të karbonit nëpërmjet financimit të teknologjive të EE-së dhe BRE-së. Mbështetja për vendet në zhvillim duhet të ofrohet nga vendet e zhvilluara, në lidhje me zbutjen dhe përshtatjen, duke vazhduar synimin e përbashkët për të mobilizuar 100 miliardë dollarë në vit deri në vitin 2025, kur do të vendoset një objektiv i ri i përbashkët.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e uljes së shkarkimeve, Marrëveshja krijon një sistem "analitik të komponentëve individualë", ku Palët do të duhet të përgatisin dhe komunikojnë Kontribute Kombëtare të Pikësynuara (KKP) çdo pesë vjet, me qëllim përmirësimin progresiv të përpjekjeve të tyre.

Përveç KKP-së, palët duhet të formulojnë strategjitë afatgjata të zhvillimit me nivele të ulëta të shkarkimit të gazeve serrë deri në mesin e shekullit, dhe t'i paraqesin deri në vitin 2020 strategjitë përkatëse, të cilat tregojnë mënyrën sesi përpjekjet e tyre do të kontribuojnë në qëllimin e shkarkimeve zero deri në gjysmën e dytë të këtij shekulli.

Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Parisit, më 22 prill 2016 dhe marrëveshja do të hyjë në fuqi pasi 55 vende që përbëjnë të paktën 55% të emetimeve globale, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit.

BE-ja miratoi "Udhërrëfyesin[10] për ekonominë me shkarkime të ulëta të GHG", më 2011-n, duke përcaktuar një rrugë me kosto efektive për të bërë ekonominë evropiane më të favorshme ndaj klimës dhe që konsumon më pak energji. Udhërrëfyesi sugjeron që deri në vitin 2050, BE duhet të zvogëlojë shkarkimet e saj në 80% nën nivelet e vitit 1990. Pikat kryesore për të arritur këtë janë ulja e shkarkimeve me 40% deri më 2030-n dhe me 60% deri në vitin 2040. Të gjithë sektorët duhet të kontribuojnë në kalimin në ekonomi me shkarkime të ulëta të GHG, sipas potencialit të tyre teknologjik dhe ekonomik. Udhërrëfyesi i BE për ekonominë me shkarkime të ulëta të GHG kërkon veprim në të gjithë sektorët ekonomikë kryesorë, përgjegjës për nivelin e shkarkimeve të Evropës - prodhimi i energjisë elektrike dhe termike, industria, transporti, sektori rezidencial, shërbimet dhe bujqësia – dhe më specifikisht duhet të bëhen investime të rëndësishme, në:

- Teknologji të reja me shkarkime të ulëta të GHG-së;
- Burimet e rinovueshme të energjisë;

[10] COM(2011) 112 final/2. E disponueshme ne: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:5db26ecc-ba4e-4de2-ae08-dba649109d18.0002.03/DOC_2&format=PDF

- Eficiencën e energjisë; dhe
- Përmirësime të ndjeshme në infrastrukturën e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Shqipëria ka filluar procesin e ndryshimit të statusit nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar, në kontekstin e UNFCCC-së. Ky proces është pjesë integrale e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të gazeve serë (GHG), formulimin dhe zbatimin e politikave për reduktimin e GHG-së dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, transpozimin dhe zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian për ndryshimet klimatike. Në përputhje me objektivat e BE-së 20–20–20, Shqipëria ka vendosur objektiva sasiorë në lidhje me eficiencën e energjisë (sipas targetit përkatës me 6,8% në vitin 2020) dhe burimet e rinovueshme të energjisë (sipas targetit përkatës me 38% në vitin 2020) brenda kuadrit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Aktualisht, këto objektiva janë përcaktuar tashmë në Planin e dytë dhe të tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë

Në vitin 2014, në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 25.4.2014, u krijua një grup pune ndërministror për koordinimin e detyrave të ministrive sipas detyrimeve të vendit ndaj UNFCCC-it. Grupi, i kryesuar nga zëvendësministri i Mjedisit, përfshin përfaqësuesit e 12 ministrive. Grupi ka mandatin, ndër të tjera, për të hartuar politika dhe strategji, për të siguruar koordinim ndërinstitucional për zbatimin e aktiviteteve të ndryshimeve klimatike. Në dokumentin e parë të Kontributit Kombëtar të Pikësynuar, Shqipëria është angazhuar që të reduktojë shkarkimet e CO_2 me 11,5% në vitin 2030, në krahasim me skenarin bazë.

Analiza të mëtejshme të reduktimit të GHG-së, si dhe objektivat dhe veprimet që do të ndërmerren do të përcaktohen në Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës që do të përgatitet, në bashkëpunim me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë.

Siç tregon analiza që mbështet këtë strategji, potencialet e reduktimit të GHG-së në sistemin energjetik shqiptar janë më të mëdha sesa angazhimi fillestar i KKP. Si rrjedhojë, strategjia dhe objektivat e politikave që parashikon, janë në përputhje me synimet gjithnjë në rritje të UNFCCC-it dhe BE-së. Duke pasur parasysh statusin aktual të Shqipërisë si vend kandidat për t'u anëtarësuar në BE, ka gjasa që gjatë periudhës që mbulon kjo strategji, Shqipëria do të aderojë në BE. Për këtë arsye, është me rëndësi të veçantë që të garantohet se objektivat e politikave të identifikuara në këtë strategji të energjisë do të mbështesin nivelet e ambicies të shprehura në objektivat e BE-së në këtë sektor.

3.12.6 GJETJET KRYESORE PËR POLITI-KAT E ENERGJISË DHE REKOMAN-DIMET KRYESORE

Me qëllim hartimin e politikave të qëndrueshme të energjisë sipas nevojave të vendit, angazhimeve ndërkombëtare dhe prioriteteve të Strategjisë, qeveria po punon, për:

- Vazhdimin e zbatimit të një kuadri të konsoliduar të politikave për eficiencën e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë;
- Përmirësimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e programeve strategjike për kërkesat financiare dhe efektet buxhetore të sektorit të energjisë;
- Vijueshmërinë e stabilitetit dhe besueshmërisë së sistemit shqiptar të energjisë elektrike;
- Garantimin e reduktimit të humbjeve dhe mbledhjes së plotë të faturave nga ana e OSHEE-së;
- Njohjen e ritmit aktual të ngadaltë të reformës dhe përshpejtimin e zbatimit të legjislacionit evropian të energjisë, duke pasur parasysh se zbatimi më i shpejtë do të lehtësojë investimet mjaft të nevojshme dhe do të ndikojë në tregun vendës drejt objektivave të qëndrueshëm të energjisë;
- Sigurimin e zbatimit efektiv të politikës energjetike dhe legjislacionit përkatës.

INTEGRIMI ENERGJETIK NË RAJON DHE NË BE

Integrimi në tregjet rajonale dhe të BE-së të energjisë do të jetë një hap vendimtar për Shqipërinë që të plotësojë kërkesën e saj në rritje për energji. Në vitin 2014, konsumi total i energjisë në Shqipëri ishte 2,070 ktoe[11]. Konsumi i energjisë elektrike ishte 7,722 GWh ose 34% e përdorimit të burimeve primare të energjisë. Me një normë vjetore të parashikuar të rritjes së PBB-së prej 4% për dekadën e ardhshme, konsumi i energjisë pritet, gjithashtu, të rritet. Në mënyrë që Shqipëria të mbështesë rritjen e saj, vendi do të duhet të gjejë burime shtesë të energjisë dhe të investojë në infrastrukturën e tij të transmetimit/transportit dhe ofrimit të energjisë. Burimet e reja energjetike dhe investimet në infrastrukturë do të ndihmojnë sektorin energjetik të Shqipërisë që të vazhdojë transformimin e tij drejt

[11] Balanca Energjetike e Shqipërisë 2009–2014, AKBN; INSTAT.

një tregu më konkurrues, duke u përshtatur me iniciativën dhe objektivat e paketës së tretë të energjisë.

Shqipëria është një nga palët/vendet e para kontraktuese që ka arritur me sukses transpozimin e paketës së tretë të energjisë në vitin 2015. Si pjesë e kësaj pakete, masat për hapjen e tregut dhe integrimin e tregut ndërkufitar janë hapa vendimtarë drejt një tregu rajonal mbarë evropian të energjisë.

Sektori elektroenergjetik: integrimi i tregut Objektiv strategjik

Shqipëria ka miratuar një politikë të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) për të siguruar një planifikim të koordinuar dhe koherent të politikave qeveritare. Një nga karakteristikat kryesore të SPI-së është Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (NSDI-II) që përshkruan objektivat e vendit për zhvillimin social, demokratik dhe ekonomik në periudhën 2015–2020. Disa nga objektivat strategjikë në SKZHI-II për sektorin e energjisë në tërësi dhe energjisë elektrike në veçanti përfshijnë:

- Rritjen e furnizimit me energji hidrike në 7.300 GWh/vit deri në vitin 2020 (nga 4.425 GWh në vitin 2012);
- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes në 14% deri në vitin 2030;
- Reduktimin e varësisë energjetike në importe në 65% në vitin 2020 (nga 69.75% në vitin 2015);
- Fillimin e operimit në gjysmën e dytë të vitit 2018 të linjës së interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës (e përfunduar në vitin 2016) me ndihmën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Komisionit Evropian;
- Forcimin e ndërlidhjes së rrjeteve të interkonjeksionit të energjisë elektrike me Kosovën dhe Maqedoninë për të përmirësuar lidhjen e sistemit shqiptar të energjisë me rajonin;
- Harmonizimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të sektorit të energjisë elektrike me legjislacionin e BE-së dhe përmbushja e detyrimeve të paketës së tretë të energjisë;
- Funksionimi i tregut rajonal.

Për të përmbushur detyrimet e saj me Paketën e Tretë të Energjisë dhe për të nxitur dhe mbështetur më tej zhvillimin e saj ekonomik, Shqipëria po ndërmerr hapa për të mbetur tërheqëse financiarisht dhe ekonomikisht në sektorin e energjisë. Ndërsa është një ndër të parat Palë Kontraktuese që ka filluar transpozimin e Paketës së Tretë të Energjisë në sektorin e energjisë elektrike, ky sektor në Shqipëri karakterizohet nga një strukturë tregu në të cilën shumica e blerjes së energjisë dominohet nga transaksione dypalëshe për konsumatorët e mëdhenj, ndërsa shumica e klientëve të tjerë dhe tregu i shitjeve me pakicë mbeten nën një regjim rregullator. Në veçanti, është duke u zhvilluar ndarja e financiare dhe aspekti pozitiv në ndarjen e pronësisë për OST-në është miratuar me ligj në vitin 2016.

OST-ja, operatori i certifikuar i sistemit të transmetimit, thelbësor për zhvillimin e një tregu të fuqishëm, është i ngarkuar me sigurimin e zhvillimit të cilësisë së rrjetit të transmetimit, duke garantuar qasje transparente dhe jodiskriminuese për pjesëmarrësit e tregut. Gjithashtu, ai duhet të koordinojë planifikimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit me shoqëritë homologe në rajon. Si pjesë e përpjekjeve të saj për të forcuar rrjetin e transmetimit, Shqipëria ka nisur disa projekte përmirësimi brenda vendit, si p.sh.:

- Zgjerimi i nënstacionit Koman me 400x220 kV me Autotransformator 345 MVA dhe lidhja e tij në rrjet;
- Ndërtimi i nënstacionit 400/110 kV Tirana 3, me fuqi të instaluar 2x150 MVA;
- Forcimi i rrjetit të unazës së Tiranës 110 kV;
- Ndërtimi i linjës së dyfishtë 220 kV nënstacioni Tirana 2 - nënstacioni Rashbull;
- Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV nënstacioni Fier - nënstacioni Elbasan2 – nënstacioni Manastir/Bitola, rehabilitimi i Nënstacionit Elbasanit 2 dhe rritja e kapacitetit të nënstacionit të Fierit me autotransformator 400/220 kV me fuqi të instaluar 400 MVA;
- Ndërtimi i linjës 220 kV Burrel - Peshkopi dhe rritja e kapacitetit të nënstacionit 220/110 kV Peshkopi me fuqi të instaluar 120 MVA;
- Instalimi i një sistemi kompensues të fuqisë reaktive në rrjetin 400 kV, me fuqi të instaluar 120 MVAR në Nënstacionin e Zemblakut 400/110 kV;
- Blerja dhe zbatimi i një platforme të re elektronike për Menaxhimin e Energjisë Elektrike;
- Përgatitja e një Plani Zhvillimi Afatgjatë për rrjetin e transmetimit që do të përgatitet nga OST-ja deri në fund të vitit 2018.

Krijimi i një tregu konkurrues të energjisë elektrike të ditës në avancë

Integrimi i tregut shqiptar të energjisë elektrike në tregun evropian të energjisë kërkon që fillimisht brenda vendit të krijohet një treg konkurrues i shitjes me pakicë. Ligji i ri i sektorit të energjisë elektrike (LSE) garanton një hapje graduale të tregut të shitjes me pakicë dhe krijimin e shpejtë të një tregu

konkurrues të shitjes me shumicë. Bazuar në PSL, një model i ri shqiptar i tregut u miratua nga Këshilli i Ministrave. Zhvillimi i Modelit shqiptar të Tregut (AMM) është hapi përfundimtar drejt zhvillimit të Tregut shqiptar të Energjisë Elektrike në një treg energjie plotësisht konkurrues, në përputhje me detyrimet e Komunitetit të Energjisë. Në lidhje të ngushtë me dy zhvillimet e mëparshme, ka nisur procesi drejt krijimit të një Burse Shqiptare të Energjisë që, gjithashtu, kërkon zhvillimin e mëtejshëm të tregut të energjisë në përputhje të plotë me kërkesat e Komunitetit të Energjisë. Përveç lejimit për një integrim të mëtejshëm rajonal midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje, modeli aktual i tregut shqiptar duhet të inkurajojë sa më poshtë:

- Përfitime më të larta të konsumatorëve në lidhje me sigurimin e furnizimit me energji elektrike dhe të shërbimit më cilësor;
- Përdorimin më efikas të tregtisë ndërkufitare midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje;
- Harmonizimin e legjislacionit të energjisë dhe praktikës së tregut me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
- Finalizimin e ndarjes së plotë të strukturës vertikalisht të integruar të sektorit të energjisë drejt një strukture me kompani të veçanta të furnizimit, gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes, të ndara nga pikëpamja ligjore, funksionale dhe financiare, të cilat lejojnë konkurrencën në tregjet e shitjeve me shumicë dhe pakicë;
- Zhvillimin e tregut të energjisë sipas rregullave të qarta të tregut dhe kodeve të rrjetit si kërkesa minimale teknike për një funksionim efikas të sistemit elektroenergjetik;
- Zbatimin e qasjes së palëve të treta për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e një tregu transparent dhe jodiskriminues;

- Liberalizimin e tregut të energjisë, krijimin e strukturës që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve dhe hap sektorin për konkurrencë për të gjithë pjesëmarrësit, duke përfshirë edhe investitorët e huaj;
- Monitorimin e tregut të energjisë nga ERE;
- Nevojën për të hartuar dhe zbatuar rregulla që sigurojnë rregulla loje transparente për kryerjen e transaksioneve në treg, si dhe regjimin e integritetit të tregut, për të mos lejuar manipulimin e tregut, abuzimin e tregut dhe nga ana tjetër të lejojë transaksionet elektroenergjetike në përputhje me praktikën më të mirë evropiane; dhe
- Integrimin e tregut shqiptar të energjisë me tregun rajonal në Evropën Juglindore dhe më vonë me tregun evropian të energjisë, që do të jetë një parim bazë përgjatë gjithë periudhës së kësaj strategjie.

Modeli shqiptar i Tregut karakterizohet nga një treg i shitjeve me shumicë i bazuar në transaksione dypalëshe, ndërsa të gjitha kontratat fizike do të tregtohen në një treg të organizuar të ditës në avancë dhe tregjet brenda ditës të organizuara nëpërmjet bursës së energjisë. ERE, Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në koordinim me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe në konsultim me pjesëmarrësit e tregut, garantojnë se do të merren masa të përshtatshme dhe të justifikuara për të siguruar që performanca e tregut të përmbushë kriteret e transparencës dhe hapjen, si edhe sigurinë e furnizimit. Të gjitha format e rregullimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të çmimeve dhe subvencioneve do të eliminohen, me përjashtim të asaj që mbulohet në çdo detyrim të shërbimit publik në përputhje me detyrimet e sektorit të energjisë elektrike dhe të Komunitetit të Energjisë.

Zbatimi i Modelit shqiptar të Tregut do të mundësohet nga rregullat e detajuara të operimit të tregut. Gjithashtu, zbatimi i tij do t'i mundësojë Shqipërisë që të përmbushë angazhimet e ndërmarra ose që mund të ndërmarrë në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal. Tregu konkurrues do të lehtësojë gjithashtu një integrim të tregut të ardhshëm shqiptar me tregje të tjera nga vendet fqinje. Në lidhje me prodhuesit e energjisë elektrike nga BRE-ja, Modeli i Tregut pritet të mbështesë skemat në përputhje me legjislacionin evropian të Komunitetit të Energjisë në formën e kontratave për diferenca (KpD) që do të zëvendësojnë marrëveshjet aktuale të blerjes së energjisë (MBE).

Përfitimet nga tregu rajonal i energjisë

Analiza e një tregu të integruar të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës tregon se është e mundur që të sigurohen përfitimet e mëposhtme:

- Përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji elektrike, pasi Shqipëria ka pothuajse 100% kapacitete hidrike (të ndjeshme ndaj kushteve të ndryshueshme hidrologjike) dhe Kosova ka pothuajse 100% kapacitete termike (pjesërisht të vjetra dhe jofleksibël në ndjekjen e kërkesës). Integrimi i dy sistemeve, duke kombinuar kapacitetin gjenerues është rreth 50% hidrik dhe 50% termik, të cilat priten të përmirësojnë sigurinë e furnizimit përmes përdorimit më efikas të kapaciteteve të linjave ekzistuese të

interkonjeksionit dhe sinjaleve tarifore. Të dyja sistemet e energjisë elektrike do të funksionojnë si një zonë e vetme ofertuese dhe do të krijojnë një treg efikas bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar midis Shqipërisë dhe Kosovës;

- Përdorimi efikas i kapaciteteve të linjave ekzistuese të interkonjeksionit dhe rritja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, që pritet të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies në të dyja vendet;
- Përmirësimi i kontrollit të sistemit të energjisë elektrike dhe shfrytëzimi i sinergjive të dy sistemeve, të siguruara nga kombinimi i kapaciteteve termike (për të mbuluar ngarkesën bazë) dhe hidrike (për të mbuluar ngarkesën mesatare dhe pikun);
- Përmirësimi i klimës së investimeve duke bërë të mundur tërheqjen e investitorëve potencialë.

Përfitimet financiare që lidhen me integrimin e tregjeve të energjisë në Shqipëri dhe Kosovë u përcaktuan në bazë të kursimeve që do të rrjedhin nga reduktimi i importeve të energjisë elektrike dhe shpenzimet shtesë të ndryshueshme të kostove për operim dhe mirëmbajtje për termocentralet e Kosovës dhe hidrocentralet mbi kaskadën e lumit Drin. Kursimet nga zvogëlimi i importeve në masë të madhe tejkalojnë shpenzimet operative në rritje për termocentralet dhe hidrocentralet, dhe përfitimi financiar neto për të dyja sistemet mesatarisht është 75 milionë euro në vit në periudhën 2018–2030, me një përfitim kumulativ prej mbi 1 miliard euro deri në vitin 2030.

Në një mjedis të tillë ku shfrytëzimi dhe tregtimi i burimeve të sistemit ndodhin në bazë të parimeve të nxitura nga tregu, në planin afatgjatë Shqipëria mund të tërheqë investime të mëtejshme të shtimit të kapaciteteve gjeneruese me burime të rinovueshme të energjisë. Kjo do të arrihet duke pasur parasysh potencialin e hidrocentraleve, duke bërë të mundur të arrijë një diversitet më racional të burimeve të furnizimit nëpërmjet importeve të energjisë nga gjenerimi termik nga vendet e tjera dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit. Nga pikëpamja e infrastrukturës së transmetimit, përpjekje të tilla kërkojnë zhvillimin e linjave të interkonjeksionit të transmetimit midis vendeve përkatëse. Për këtë qëllim, projektet e përmendura më poshtë mund të konsiderohen si pjesë e procesit për të integruar më tej Shqipërinë dhe Palët e tjera Kontraktuese brenda një sistemi më të gjerë rajonal të tregut të energjisë elektrike:

- Fillimi i funksionimit tregtar të linjës së interkonjeksionit 400kV ndërmjet Nënstacionit Tirana 2 (Shqipëri) dhe Kosova B (Kosova), që duhet të rrisë potencialin e shkëmbimit të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës deri në 600 mw. Ndërtimi i kësaj linje ka përfunduar në muajin qershor të vitit 2016. Megjithatë, për ta bërë këtë linjë funksionale, nevojitet njohja e Kosovës si një zonë e veçantë e kontrollit nga NTSO-e .
- Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV midis Elbasanit dhe Manastirit/Bitolës (Maqedoni), e cila duhet të rrisë potencialin e shkëmbimit të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Maqedonisë deri në 600 mw. Ky projekt duhet të përfundojë së ndërtuari brenda vitit 2019.

Statusi i integrimit të tregut rajonal të energjisë

Që Shqipëria të përfitojë plotësisht nga liberalizimi i tregut të energjisë elektrike, siç është parashikuar në paketën e tretë të energjisë, nevojiten ende hapa shtesë drejt zbatimit të saj. Disa nga arritjet pozitive deri tani përfshijnë:

- Prill 2015 - miratimi i ligjit të ri të energjisë elektrike në transpozimin e paketës së tretë të energjisë. Ajo transpozon direktivën 2009/72/KE dhe Rregulloren (KE) 714/2009.
- Prill 2015 e në vazhdim - pjesëmarrja në Zyrën e Koordinuar të Ankandit të Evropës Juglindore në Malin e Zi (CAO).
- Tetor 2015 - memorandumi i Mirëkuptimit për iniciativën rajonale për koordinimin e kapaciteteve ndërmjet OST-ve të Shqipërisë, Kosovës, Greqisë, Maqedonisë, Turqisë dhe Bullgarisë.
- Nëntor 2015 e në vazhdim - pjesëmarrja në Zyrën e Koordinuar të Ankandit të Evropës Juglindore në Greqi.
- Janar 2016 - miratimi i ligjit që lejon ndarjen e pronësisë së OST-së.
- Prill 2016 - nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit të BB6 për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike dhe krijimi i një kuadri për bashkëpunim të ardhshëm.
- Korrik 2016 - miratimi i një ligji të caktuar, përfshirë: Modelin e tregut shqiptar, që do të përbëhet nga një treg i energjisë të ditës në avancë, tregu brenda ditës, funksionet e shlyerjes dhe një treg balancues, që do të konsiderojë bashkimin e tregut shqiptar me tregjet fqinje;
- Ndërprerja e rregullimit të çmimeve.
- Plani i Veprimit për krijimin e Bursës së energjisë elektrike (APEX).

Legjislacioni dytësor mbetet për t'u zbatuar plotësisht[12], në mënyrë më specifike në lidhje me:

- Balancimin: mekanizmi aktual i balancimit në kohë reale nuk bazohet në treg. Përgjegjësia e mëtejshme e balancimit nuk është në përputhje me legjislacionin e BE-së;
- Hapjen e tregut: qasja e plotë konkurruese në treg si në tregjet me pakicë nuk pritet para vitit 2018 dhe do të kryhet në faza sipas nivelit të tensionit;
- Rregullimin e çmimeve: ndërprerja e plotë e rregullimit nuk pritet para vitit 2019;
- Detyrimet e Shërbimit Publik: metodologjitë e pajtueshme për operacionet nuk janë miratuar dhe për pasojë akoma nuk ka filluar të zbatohen nga ERE;
- Pranueshmëria: tarifat e rrjetit të shpërndarjes nuk janë të bazuara në kosto në krahasim me nivelin e tensionit dhe kushtet për transferimin e furnizuesve ende duhet të zbatohen praktikisht;
- Mbrojtja e Konsumatorëve familjarë vulnerabël: rregullat mbi kushtet për mbështetjen dhe subvencionim e furnizimit për këtë kategori të konsumatorëve akoma nuk janë përgatitur deri më tani dhe priten të realizohen gjatë fundit të vitit 2018.

Masat prioritare

Megjithëse miratimi i ligjit të ri të sektorit të energjisë dhe Modelit shqiptar të Tregut është hapi i duhur drejt zbatimit të legjislacionit të BE-së, një numër aktivitetesh të tjera janë të nevojshme për të qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor evropian, gjë që do të mundësonte integrimin e mëtejshëm të tregut shqiptar të energjisë në tregun evropian. Këto hapa përfshijnë:

- Derregullimin e çmimeve dhe kontratave me shumicë (KESH-OSHEE);
- Hartimin dhe miratimin e rregullave të tregut, duke përfshirë kriteret e pjesëmarrjes në treg, kontratat standarde, rregullat e shlyerjes, etj., për funksionimin e tregut të ditës në avancë;
- Rishikimin e kodeve të rrjetit që pasqyrojnë zhvillimet e tregut;
- Miratimin e rregullave për sigurinë e furnizimit;
- Zhvillimin dhe miratimin e mekanizmit transparent balancues, me qëllimin përfundimtar të krijimit të një tregu balancues konkurrues;
- Shkëputjen e plotë të funksionit të shpërndarjes nga funksioni i furnizimit me pakicë që aktualisht kryhet nga OSHEE-ja. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, në nenin 72 të tij përcakton që ndarja ligjore dhe funksionale e shpërndarjes nga aktiviteti i furnizimit duhet të ishte finalizuar deri më 31 dhjetor 2017 dhe është një nga detyrat imediate që do të realizohet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2018;
- Modeli i ndarjes së OSSH-së u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE sh.a. me vendimin nr. 65, datë 19.12.2016, "Për miratimin e modelit të korporatës" dhe miratuar gjithashtu edhe nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë që është aprovuar edhe nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Ndarja funksionale e aktivitetit të shpërndarjes nga furnizimi është në proces dhe do të finalizohet deri në fund të vitit 2018;
- Krijimin dhe trajnimin e strukturës përgjegjëse për operimin e tregut të ditës së ardhshme;
- Rishikimin e metodologjive të tarifave të transmetimit dhe shpërndarjes, me qëllim krijimin e kushteve jodiskriminuese të aksesit për të gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe krijimin e mundësive që të dy operatorët e sistemit të mbulojnë kostot e tyre të arsyeshme të shërbimit;
- Eliminimin gradual të rregullimit të çmimit të gjenerimit publik;
- Hartimin dhe miratimin e rregullave për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke përfshirë rregulla specifike për konsumatorët në nevojë;
- Forcimin e kapaciteteve të pavarësisë dhe monitorimit të tregut të ERE-s;
- Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe në legjislacionin dytësor për të mundësuar integrimin e tregut në Shqipëri me tregje të tjera nga vendet fqinje, duke filluar me Kosovën.

Sektori i gazit natyror: integrimi i tregut

Rajoni i Ballkanit Perëndimor mund të përshkruhet si një treg i fragmentuar i gazit i përbërë nga tregjet individuale, secili me mjedisin e vet rregullator dhe me pak transaksione konkurruese ndërkufitare. Këto tregje, të krijuara fillimisht me synimin e përmbushjes së nevojave të brendshme, janë në formën e tyre aktuale, pengesë për të arritur një mjedis tregu rajonal pa reforma të rëndësishme dhe investime shtesë në infrastrukturë. Më konkretisht, Shqipëria ka një sistem të vogël të izoluar të shpërndarjes së gazit, i cili nuk është i lidhur me sistemet ndërkombëtare të transmetimit të gazit.

Madhësia aktuale e tregut të gazit në Shqipëri mbetet një nga më të voglat në rajonin e Ballkanit

[12] Raporti Vjetor i Komunitetit të Energjisë (për vitin 2016).

Perëndimor 15 milionë m^3N (prodhimi dhe konsumi në vitin 2015). I gjithë prodhimi vendës, i cili ka rënë ndjeshëm që nga vitet '90, përdoret për të plotësuar konsumin e brendshëm dhe pjesa e konsumit të energjisë të përmbushur nga përdorimi i gazit natyror aktualisht është shumë e vogël. Megjithatë, gjatë dy dekadave të ardhshme llogaritet se konsumi i përgjithshëm i gazit potencial në vend mund të arrijë në 1,15 miliardë m^3N deri në vitin 2040 (siç tregohet në tabelën 13) dhe rezervat e brendshme aktuale do të vazhdohet të eksplorohen më me prioritet për të përmbushur nevojat e ardhme.

Tabela 13. Konsumi[13] total potencial natyror i gazit në Shqipëri (milionë m^3)

Milionë m^3	2020	2021	2025	2030	2035	2040
Kërkesa teorike e gazit natyror pa marrë parasysh skenarin e ndryshimeve klimatike:	11,82		1,791	2,193	2,454	2,851
Kërkesa teorike e gazit natyror duke marrë parasysh skenarin e ndryshimeve klimatike:	11,82		1,339	1,555	1,799	2,078
Kërkesa bazuar në skenarin e zhvillimit të masterplanit të gazit natyror:		244		833		1,371
Kërkesa e gazit natyror bazuar në skenarin "Promovimi i gazit" - llogaritur bazuar në analizën LEAP:	11,82	173	421.81	1150,90		

Zhvillimi i tregut të gazit në Shqipëri është një domosdoshmëri dhe do t'i mundësojë vendit:
- Hartimin e një politike për rritjen në mënyrë të konsiderueshme të sigurisë së furnizimit;
- Rritjen e numrit të pjesëmarrësve në tregun lokal;
- Tërheqjen e investimeve në sektorin e gazit natyror;
- Përmirësimin e efikasitetit të tregut të shitjeve me pakicë;
- Përmirësimin e operacioneve financiare të sistemit energjetik;
- Pjesëmarrjen në tregun rajonal të gazit natyror;
- Përmirësimin e zhvillimit ekonomik me qendrën potenciale tregtare rajonale.

Integrimi i suksesshëm i tregut të gazit për Shqipërinë do të kërkojë zhvillimin e një rrjeti kombëtar të gazit që do të jetë mjaft i fuqishëm për të përmbushur nevojat e parashikuara të konsumit dhe arritur standardet evropiane dhe përfshirjen e Shqipërisë si pjesë e një rrjeti nënrajonal të gazit që mundëson zhvillimin e infrastrukturës, duke synuar një kërkesë më të madhe nënrajonale. Ndërsa integrimi i tregut të gazit do të sigurojë shpërndarjen e gazit në tregun vendor dhe do të forcojë ekonominë kombëtare. Kjo e fundit do të garantojë diversitetin në opsionet e furnizimit, të cilat nëse ofrohen në kontekstin e paketës së tretë të energjisë, do t'i sigurojnë Shqipërisë një burim energjetik, siç është gazi natyror, të besueshëm dhe konkurrues për ekonominë e saj.

Evoluimi i integrimit të tregut të gazit natyror në Shqipëri

Me synimin e krijimit të një sektori të qëndrueshëm të gazit natyror dhe arritjen e objektivave të lartpërmendur, qeveria shqiptare ka punuar për hartimin e një masterplani[14] të gazit natyror të Shqipërisë. Ky studim arriti në përfundimin se Shqipëria mund të luajë rol të rëndësishëm në zhvillimin e një tregu rajonal të gazit, ndërsa rivendos dhe përmirëson sistemin e saj kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

Demografia e të gjithë rajoneve të Shqipërisë paraqet një sfidë për zhvillimin e një rrjeti shpërndarës me densitet të lartë të gazit. Bazuar në kriteret përkatëse si dendësia dhe shpërndarja e popullsisë, ekzistenca e konsumatorëve që bazohen në informacionin fillestar (p.sh. sektori i energjisë, përdoruesit industrialë), niveli i urbanizimit dhe lloji i ndërtesave, *masterplani i gazit arriti në konkluzionin se nuk është e mundur që Shqipëria të zhvillojë një rrjet kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit, të aftë për të mbuluar të gjitha 61 bashkitë e saj, ndërsa mund të arrijë grupimin e zonave për të garantuar një ekonomi të konsiderueshme të shkallës*. Në të kundërt, zgjidhja me arritjet e shumicës së ekonomive të shkallës për Shqipërinë është një sistem i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit që do t'i mundësonte vendit të përmbushte 77% të kërkesës potenciale kombëtare në vitin 2020, duke u rritur në 82% të kërkesës potenciale të konsumit të gazit deri në vitin 2040. Sistemi i transmetimit i propozuar i gazit dhe rrjetit shpërndarës mbulon

[13] Asistenca Teknike e Shërbimit të Projektit Infrastrukturor të Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor 4 (IPF 4) WB11-ALB-ENE-01, Masterplani i Gazit për Shqipërinë dhe Plani i Identifikimit të Projekteve, draft përfundimtar, qershor 2016.

[14] WBIF WB11-ALB-ENE-01 – Plani Master i Gazit për Shqipërinë dhe Plani i Identifikimit të Projekteve - Vlerësimi i Kërkesës së Gazit dhe Furnizimit Final.

përkatësisht 12% të sipërfaqes totale të vendit dhe 65% të popullsisë.

Statusi i rrjetit kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror

Për të pasur akses në infrastrukturën rajonale dhe evropiane të gazit, Shqipëria duhet të përgatisë si aktet ligjore, ashtu edhe investimet në infrastrukturë, të nevojshme për të arritur atë akses. Në shtator të vitit 2015 Shqipëria miratoi ligjin e ri për sektorin e gazit natyror, i cili transpozon dispozita nga paketa e tretë e energjisë. Në dhjetor 2016, qeveria shqiptare vendosi të ndajë aktivitetet e gazit nga shoqëria ekzistuese publike e naftës dhe gazit ALBPETROL, duke krijuar një shoqëri të re publike, ALBGAZ, me qëllim që të luajë rolin e operatorit të kombinuar të transmetimit dhe shpërndarjes. Sipas direktivës 2009/73/KE dhe ligjit shqiptar për sektorin e gazit, çdo OST e gazit do të jetë e ndarë nga aktivitetet e tjera duke përfshirë ndarjen edhe në aspektin e pronësisë. Kjo do të thotë se shoqëria e sapokrijuar kërkohet të jetë plotësisht e ndarë nga kompania ekzistuese ALBPETROL në përputhje me kërkesat e ligjit të ri të sektorit të gazit.

Është e qartë se çdo investim në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit kushtëzohet nga kërkesat për gaz natyror, në çdo sektor ekonomik të vendit. Sfidat në sektorin e gazit përfshijnë:

- Investime të mëdha të nevojshme për zhvillimin e një sistemi të brendshëm të gazit;
- Mungesa e një ambienti të përshtatshëm tregu për tërheqjen e investitorëve privatë në sektorin e gazit;
- Konkurrenca e gazit natyror nga burimet e tjera energjetike në përgjithësi dhe në veçanti nga nënproduktet e naftës;
- Hapja e plotë e tregut përmes krijimit të tregjeve funksionale;
- Madhësia e tregut dhe qëndrueshmëria.

Korridoret e tregut rajonal të gazit natyror

Megjithëse përballet me prodhimin e ulët kombëtar dhe me pak rezerva të eksploruara ekonomikisht për të përmbushur nevojat e mundshme të gazit, Shqipëria mund të përfitojë nga vendndodhja e saj gjeografike brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe të bëhet aktor kyç në zhvillimin dhe shpërndarjen e një rrjeti rajonal për transmetimin e gazit[15]. Zhvillimi i një infrastrukture rrjeti kombëtar dhe rajonal i ofron Shqipërisë më shumë opsione drejt ndërtimit të portofolit të saj të furnizimit me gaz natyror, duke zgjeruar rolin e saj si qendër tregtare në rajon.

Përfitimet për Shqipërinë janë të arritshme nëpërmjet disa opsioneve të integrimit të tregut që synojnë krijimin e tregjeve rajonale të shitjeve me shumicë të gazit natyror në Evropën Juglindore dhe Evropën Qendrore Lindore (SEE/CEE) dhe integrimin e tyre të mëtejshëm në tregun e brendshëm të gazit natyror të Bashkimit Evropian. Bazuar në kriteret e fizibilitetit, duke përfshirë burimet e gazit, interkonjeksionin, shpërndarjen e gazit, kohëzgjatjen dhe konsumin, Shqipëria u konstatua si një nyje kritike në krijimin e dy korridoreve të mundshme të integrimit të tregut në rajonin e Evropës Juglindore, të intensifikuara nga zhvillimi i projekteve strategjike të terminaleve të GNL-së: këto projekte strategjike përfshijnë Korridorin e Integrimit në Adriatik dhe Korridorin për Integrim Jugor nëpërmjet Ukrainës.

Korridori i integrimit në Adriatik përbëhet nga një opsion i integrimit të tregut që përfshin Shqipërinë, Malin e Zi me Kroacinë, Italinë, Greqinë dhe Bullgarinë. Përderisa ofron mundësi të mëdha për qasje në burime të ndryshme furnizimi për Palët Kontraktuese përgjatë deteve Jon dhe Adriatik, ky opsion i integrimit të tregut do të sjellë përfitimet e tij të plota vetëm kur të përfundojnë të gjitha infrastrukturat e nevojshme dhe të planifikuara (p.sh. projektet PIKE). Nga një perspektivë e Shqipërisë, vlen të përmendet se ky opsion i integrimit të tregut do të zgjidhë mosbalancimin e furnizimit me gaz natyror në vend, duke lejuar vendin të bëhet një qendër tregtare natyrore për rajonin.

Nga pikëpamja e zbatimit, një pjesë e Gazsjellësit të Trans Adriatikut (TAP) është në ndërtim e sipër. Rruga e TAP-it në Shqipëri është rreth 271 kilometra, nga të cilat 211 kilometra janë në tokë/në breg dhe 60 kilometra janë në det të hapur. Disa avantazhe të TAP-it për rajonin përfshijnë:

- I pavarur, jodiskriminues dhe i hapur për palët e treta dhe investimet private;
- Thellimi i diversifikimit dhe sigurisë së furnizimit me gaz në Evropë;
- Potencialin për zgjerimin e projekteve të reja dhe shtesë;
- Konceptin e integruar të fleksibilitetit nëpërmjet ndërtimit të magazinimit të gazit në Shqipëri.

Në mënyrë të ngjashme, projekti i tubacionit Adriatik Jon (IAP) synon të ndërlidhë sistemin ekzistues dhe të planifikuar të transmetimit të gazit të Kroacisë me TAP-in. Projekti do ta bëjë Shqipërinë portën për hyrjen në Ballkanin Perëndimor të gazit nga deti Kaspik. Disa avantazhe të IAP-it për rajonin

[15] Studimi i Integrimit të Tregut të Gazit Ndërkufitar të Komunitetit të Energjisë - mars 2016.

përfshijnë:

- Diversifikimin e furnizimit me gaz në Evropën Juglindore;
- Sigurimin e aksesit në kapacitetet e depozitave të ardhshme të gazit kroat dhe shqiptar;
- Zhvillimin ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- Rolin kryesor të tregtisë të gazit natyror për Shqipërinë.

Korridori Jugor i Integrimit nëpërmjet Ukrainës përbëhet nga një opsion i integrimit të tregut që përfshin Shqipërinë, Maqedoninë, Ukrainën, Moldavinë, Greqinë, Bullgarinë dhe Rumaninë). Në mënyrë të ngjashme me opsionin e mëparshëm, ky opsion i integrimit të tregut do të sjellë përfitimet e tij të plota vetëm kur të përfundojnë të gjitha infrastrukturat e nevojshme dhe të planifikuara. Ky opsion i integrimit në treg do të zgjidhte edhe mosbalancimin e kapaciteteve natyrore në vend, duke i lejuar vendit të bëhet një qendër tregtare natyrore për rajonin. Siç u përmend më lart, opsionet e integrimit të tregut të përshkruara më sipër janë pjesë e një kuadri të zhvillimit të infrastrukturës së gazit që do të përfitonte nga projektet shtesë të furnizimit me gaz në formën e terminaleve të GNL të shqyrtuara dhe në ndërtim e sipër. Këto projekte të terminaleve të GNL janë konstatuar me përfitim për Shqipërinë dhe Palët e tjera Kontraktuese në Ballkanin Perëndimor në fusha kyçe, si diversifikimi dhe siguria e furnizimit me gaz, integrimi më i madh i gazit në rajonin e Evropës Juglindore dhe ndikimi i tij i madh që do të ketë në zhvillimin ekonomik.

- GNL Krk në Kroaci: qeveria e Kroacisë, në qershor 2016, miratoi vendimin për përshpejtimin e aktiviteteve për ndërtimin e terminalit të GNL në ishullin Krk. GNL Croatia LLC është caktuar si zhvilluesi i projektit.
- Zgjerimi i GNL Revithoussa në Greqi: Njoftimi për një tender ndërkombëtar për projektimin dhe ndërtimin e një serbatori të ri GNL në Revithoussa tashmë është publikuar.
- Eagle GNL në Shqipëri.

Statusi i integrimit të tregut rajonal të gazit

Në bazë të ligjit të sektorit të gazit natyror në transpozim me paketën e tretë të energjisë, janë realizuar ose janë planifikuar për t'u kryer:

- Dhjetor 2016: shoqëria e re publike, ALBGAZ, është themeluar me funksionet dhe përgjegjësitë e një operatori të kombinuar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- Mars 2017: TAP AG është certifikuar si operator i pavarur i transmetimit (OPT) për gazin natyror.
- Nëntor 2017 - certifikimi i ALBGAZ nga ERE sipas kërkesave të ligjit për sektorin e gazit natyror.

Sistemet tarifore ende nuk janë zhvilluar dhe një numër kërkesash të tjera të ligjit për sektorin e gazit natyror ende mbeten për t'u zbatuar nëpërmjet legjislacionit dytësor, duke përfshirë:

- Miratimin nga Këshilli i Ministrave të modelit të tregut të gazit;
- Miratimin e Rregullave të Tregut të Gazit nga ERE;
- Qasjen e palës së tretë: shoqëria ALBGAZ nuk ka zhvilluar ende Kodin e Rrjetit të Transmetimit, i cili është subjekt miratimi nga ERE;
- Balancimin: shoqëria ALBGAZ ende nuk ka zbatuar rregullat e miratuara në Ligjin e ri për sektorin e gazit natyror;
- Pranueshmëria: programet e përzgjedhjes së klientëve të furnizuesve nuk janë zhvilluar ende;
- Rregullimin e çmimeve: në mënyrë të ngjashme me ligjin e ri të energjisë elektrike, ku konsumatorëve të vegjël u lejohet të marrin furnizime me tarifa të rregulluara (me gaz natyror) nga furnizuesi sipas detyrimit të shërbimit publik;
- Hapja e tregut: ndërmarrjet e vogla dhe konsumatorët shtëpiakë lejohen të zgjedhin furnizuesin e tyre;
- Mbrojtja e konsumatorëve familjarë vulnerabël: kriteret që përcaktojnë këtë kategori të klientëve ende duhet të përcaktohen dhe zhvillohen.

Biokarburantet: integrimi i tregut

Forma të ndryshme të burimeve të biomasës janë të disponueshme në Shqipëri për të mbuluar shërbimet e energjisë në lidhje me ngrohjen, prodhimin e energjisë elektrike dhe transportin. Figura 15 tregon se drutë e zjarrit, mbetjet bujqësore, peletat e biomasës dhe biogazi mund të kontribuojnë në një pjesë shumë të rëndësishme të kërkesës për energji për të siguruar energjinë termike në kuadër të plotësimit të targetave nga BRE-ja.



Viti/kToe	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Dru zjarri	195	217	233	249	265	280	296	295	295	294	295	295	295	298	300	303	306
Diellore	12	17	20	24	28	33	38	40	43	46	49	53	56	60	64	69	74
Biodizel	29	66	75	83	92	100	108	117	125	133	142	150	159	167	175	184	192
Biomasa/ peleta	-	2	5	8	11	15	19	22	26	30	34	38	42	46	50	54	59
Mbetjet bujqësore	-	3	6	9	12	15	17	20	22	23	25	26	27	28	28	29	29

Mbetjet bujqësore	-	3	6	9	12	15	17	20	22	23	25	26	27	28	28	29	29

Figura 12. Energjia e siguruar nga burimet e rinovueshme të energjisë që mbulojnë kërkesën për energji termike (ktoe).

Burimet e Rinovueshme të Energjisë, në sektorin e transportit që janë kryesisht biodizel, synojnë një kontribut prej 10% të kërkesës. Në skenarin e BRE-së, pjesa e biokarburanteve që do të kontribuojë në mbulimin e nevojave energjetike të sektorit të transportit rezulton se mund të arrijë deri në 15,5% në vitin 2030, duke tejkaluar objektivin prej 10% (që kërkohet sipas targetave më 2020-n).

Mbështetja e biokarburanteve për transportin

Shqipëria ka miratuar në shkurt të vitit 2008 dhe ka ndryshuar në qershor të vitit 2016 një ligj të veçantë (ligji nr. 9876, datë 14.2.2008) për biokarburantet dhe lëndët djegëse të tjera të rinovueshme të përdorura për transport. Qëllimi i këtij ligji të ri është nxitja e prodhimit dhe përdorimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, të përdorura për zëvendësimin e nënprodukteve të naftës në sektorin e transportit, me qëllim uljen e shkarkimeve të GHG-së, nxitjen e kultivimit të kulturave bujqësore për prodhimin e biokarburanteve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Sipas ligjit për burimet e rinovueshme të energjisë, zbatimi i PKVBRE-së do të monitorohet nga agjencia përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, e cila pritet të ketë autoritet dhe kompetenca në monitorimin e pajtueshmërisë me objektivat e përcaktuar për të gjitha burimet e rinovueshme, përfshirë biokarburantet. Në të njëjtën kohë, ligji i ri për biokarburantet do t'i japë Agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, përgjegjësinë për monitorimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së prodhuesve të biokarburanteve me kriteret e qëndrueshmërisë të përcaktuara në ligj.

Nga ana tjetër, ndryshimi i ligjit për biokarburantet, i miratuar në tetor 2014, i përjashtoi të gjitha biokarburantet dhe BRE-të e tjera të përdorura në sektorin e transportit nga akciza me qëllim që këto karburante të jenë konkurruese në treg. Megjithatë, mbetet ende për t'u realizuar transpozimi i seksionit të biokarburanteve në direktivën e BRE 2009/28 nëpërmjet një ligji të ri mbi biokarburantet në Shqipëri.

Kërkesa për biokarburantet në Shqipëri bazohet në objektivin e biokarburanteve, të përcaktuar në

PKVBRE, i cili është rreth 95.53 ktoe për vitin 2020 (108.000 tonë në vit). Aktualisht ekziston një impiant biodizeli në Shqipëri i vendosur në Porto-Romano, që ka një kapacitet prodhimi prej 100.000 tonësh në vit biodizel dhe 20.000 tonë në vit glicerinë. Impianti është i lidhur me një tubacion me infrastrukturën e portit në Porto-Romano dhe është i lidhur me rrugë tokësore përmes autostradës kryesore të vendit. Kjo rafineri biodizeli ka kapacitetin për të furnizuar tregun e biokarburanteve në Shqipëri dhe ky impiant mund të mbulojë furnizimet e nevojshme për të përmbushur objektivat e transportit të BRE-së deri në vitin 2025. Përveç kësaj, impianti do të ketë një prodhim fillestar më të madh se objektivi vendës.

BURIMET FINANCIARE

Strategjia Kombëtare e Energjisë është një strategji shumëdimensionale me një horizont planifikimi afatgjatë (2018–2030), që përfshin një numër të konsiderueshëm sektorësh dhe nënsektorësh, politikash dhe rezultatesh. Ky kapitull synon të identifikojë burimet financiare që do të kërkohen për zbatimin e politikave, objektivave dhe arritjen e rezultateve që identifikohen në këtë Strategji. Duke pasur parasysh nivelin e pasigurisë për faktorë të ndryshëm në hartimin e kësaj Strategjie të energjisë, nevojat për financimin e investimeve për secilin skenar janë zhvilluar në terma të përgjithshëm, bazuar në rezultatet e skenarëve të ndërtuar, duke përdorur modelin LEAP dhe parametrat specifikë të kostos sektoriale. Ky kapitull përshkruan se si janë vlerësuar këto kërkesa financiare dhe paraqet një ndarje të detajuar sipas sektorëve.

Strategjia Kombëtare e Energjisë është hartuar me parimin që të ketë një ndikim minimal në shpenzimet publike, duke parashikuar se investimet e kërkuara kanë më shumë gjasa të vijnë nga burime private, bankat e zhvillimit, asistencë teknike e huaj dhe, së fundmi, nga buxheti i shtetit. Synohet që instrumentet financiare të propozuara të mos kenë ose të kenë ndikim minimal në kushtet e tregut konkurrues, në kontekstin e qasjes së lirë në treg dhe zhvillimit të çmimeve të qëndrueshme të tregut, pa ndërsubvencionim dhe në pajtim me rregullat e BE për ndihmën shtetërore, nëse zbatohet.

Ky kapitull përcakton sasinë e investimeve kapitale të mundshme përgjatë harkut kohor të Strategjisë dhe do të shërbejë si një dokument referimi që udhëzon planet e ardhshme të investimeve dhe shpenzimeve buxhetore.

Metodologjia e identifikimit të burimeve financiare sipas treguesve të strategjisë

Ky kapitull analizon investimet e kërkuara për të gjithë sektorët e sistemit energjetik shqiptar si në tabelë:

Viti	2018	2020	2025	2030
KFBE - skenari bazë (ktoe)	2,524	2,744	3,221	3,869
KFBE - skenari i kombinuar (ktoe)	**2,066**	**2,251**	**2,369**	**3,018**
Naftë dhe gas fosile – bazë	1,606	1,714	2,122	2,555
[16]Naftë dhe gas natyror– i kombinuar	**1,343**	**1,396**	**1,374**	**1,660**
Energji elektrike (GWh) – bazë	7,900	8,860	9,450	11,300
(ktoe)	918	1,030	1,099	1,314
Energji elektrike (GWh) – i kombinuar	**7,358**	**7,854**	**8,178**	**8,616**
(ktoe)	**632**	**675**	**703**	**741**
BRE ktoe (%) – i kombinuar	**723** (35%)	**855** (38%)	**995** (42%)	**1358** (45%)
Eficienca e energjisë (%) – i kombinuar	*4.1%*	*6.7%*	*12.3%*	*15.5%*
GDP (bn EUR)	11.10	11.78	13.65	15.83

Sektorët bazë të burimeve janë marrë në konsideratë

1. Sektori i energjisë elektrike (prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja),

2. Nafta bruto dhe nënproduktet e naftës (eksplorimi, prodhimi, rafinimi dhe shpërndarja), furnizimi me gaz natyror (transmetimi dhe shpërndarja),

3. Investimet në eficiencën e energjisë për të gjithë sektorët dhe investimet për të gjitha burimet e rinovueshme të energjisë.

Metodologjia e mësipërme është vendosur duke u mbështetur në **skenarin e kombinuar në të cilin,** krahasuar me skenarin bazë në (ktoe), **janë dhënë nevojat për burime fundore për t'u konsumuar**. Analiza e nevojave energjetike sipas dy ndarjeve: i) të rinovueshme; dhe ii) fosile (nafta dhe gazi) jepen në tabelën e mësipërme.

Sektori elektroenergjetik – kapacitete për t'u investuar

Për të përmbushur kërkesën në rritje për energji elektrike dhe për të zvogëluar nivelin e importit, janë përgatitur skenarë të ndryshëm përmes modelit LEAP, që kanë shërbyer për të identifikuar një plan të ri

[16] Zbërthimi i KFBE-së është bërë me bazuar mbi skenarin e kombinuar me konsum minimal.

për zgjerimin e centraleve për secilin skenar, bazuar në një kosto minimale të gjenerimit të njësisë së energjisë elektrike.

Përmbushja e kërkesës për energji elektrike do të parashikohet bazuar në skenarin e kombinuar në të cilin parashikohet kostoja e investimeve të prodhimit përcaktohet nga kostot e investimit për secilin central elektrik në planin e zgjerimit dhe bazohen në të dhënat aktuale shqiptare sipas shumë studimeve të fizibilitetit për HEC-et e vogla, HEC-et e mesme dhe të mëdha, impiantet e prodhimit të energjisë nga era, ato fotovoltaike, duke përdorur vlera mesatare për investimet specifike për teknologjitë përkatëse. **Këto impiante duhet të zgjerohen me prodhim të energjisë elektrike me të paktën për plotësimin e nevojave të Shqipërisë:**

Tabela

Viti	2018	2020	2025	2030	totali
*Energji elektrike (GWh) - **kombinuar***	7,358	7,854	8,178	8,616	
(ktoe)	632	675	703	741	
Zgjerimi me kapacitete BRE (mw)	103	225	154	208	**690**
CCGT (opsion jo BRE në mw)	32	62	40	54	**188**
*Energji elektrike (GWh) – **bazë***	7,900	8,860	9,450	11,300	
(ktoe)	918	1,030	1,099	1,314	
Zgjerimi me kapacitete BRE (mw)	149	343	240	368	**1,100**
CCGT (opsion jo BRE në mw)	38	70	46	70	**224**

Kostoja e investimit për zgjerimin e sistemit të transmetimit të tensionit të lartë, duke përfshirë rrjetet 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, bazohet në informacionin e kostos të përfshirë në parashikimin e kërkesës për energji nga OST-ja, të cilat janë përdorur për të përcaktuar mesataren e kostos së zgjerimit të sistemit si një funksion i rritjes së përgjithshme të konsumit të energjisë elektrike, i cili është specifik për çdo skenar.

Shpenzimet e investimit për sistemin e shpërndarjes përfshijnë: a) përmirësimin e sistemit të shpërndarjes për të përmirësuar besueshmërinë; b) investimet e synuara në rrjetin e tensionit të mesëm (6–20 kV); c) investime në pajisjet për matjen e konsumatorëve; d) sistemin për matjen në rrjetin e tensionit të ulët; dhe e) përmirësimin e menaxhimit të informacionit dhe të sistemit të faturimit dhe arkëtimit. Të dhënat bazë të investimeve janë marrë nga një projekt në zbatim, i OSHEE-së dhe BB/BERZH-it lidhur me përmirësimet në sistemin e shpërndarjes dhe transmetimit.

Tabela 14 paraqet investimet kumulative të sektorit të energjisë për periudhën 2018–2030, të shprehur në milionë euro (MEUR), për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen për skenarët bazë dhe të kombinuar.

Tabela 4. Investime në sektorin energjetik për 2018–2030 (m eur)

Aktivitete të sektorit energjetik	Skenari bazë	Skenari i kombinuar
Prodhim	1,970	1,442
Transmetim	195	157
Shpërndarje	419	338
TOTALI	**2,584**	**1,937**

Nga analiza skenari i eficiencës së energjisë ka investimet më të ulëta të sektorit të energjisë, duke treguar kursimet kumulative të investimeve të barabarta me 951 M euro.

Sektori i gazit natyror

Kostot e investimeve për infrastrukturën e gazit natyror bazohen në të dhënat në masterplanin e gazit natyror për furnizimin e gazit në sektorë të ndryshëm sipas supozimeve të mëposhtme:

• Kostot e interkonjeksionit përfshijnë kostot shtesë që nevojiten për të mundësuar që TAP-i të ofrojë furnizim brenda territorit shqiptar;

• Shpenzimet e investimeve për sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes përfshijnë:

- Lidhjen për furnizimin me gaz të TEC-it të Vlorës;
- Lidhjen e zonave të Fierit dhe Ballshit, si dhe rrjetin e tyre të brendshëm të shpërndarjes;
- Lidhjen e zonave Durrës–Tiranë, si dhe rrjetin e tyre të brendshëm të shpërndarjes;

- Lidhjen e zonave të Korçës, si dhe rrjetin e brendshëm të shpërndarjes.

Tabela 15 paraqet shpenzimet e investimeve të sektorit të gazit natyror për periudhën 2018–2030, të shprehur në milionë euro (MEUR) për interkonjeksionin, transmetimin dhe shpërndarjen në skenarin e promovimit të gazit natyror.

Tabela 15. Shpenzimet për sektorin e gazit natyror 2018–2030

Aktivitetet e sektorit të gazit natyror	M EUR
Interkonjeksioni	230.0
Transmetimi dhe shpërndarja	117.0
Furnizimi **total**	**347.0**

Sektori i naftës

Kjo Strategji e Energjisë mbështet eksplorimin dhe prodhimin e naftës bruto nga vendburimet ekzistuese të naftës dhe ato të reja. Strategjia merr në konsideratë importin e brendshëm aktual dhe identifikon infrastrukturën e brendshme të naftës së papërpunuar dhe naftës nëpërmjet transportit të produkteve, rezerave minimale të domosdoshme të produkteve dhe menaxhimit të standardeve moderne të nevojshme për të arritur një kosto minimale të shërbimit për naftën dhe nënproduktet e naftës dhe për të shmangur anomalitë e përkohshme të tregut. Investimet e kërkuara për eksplorimin dhe prodhimin e naftës bazohen në informatat e AKBN-së për fushat ekzistuese dhe të reja të naftës.

Strategjia mbështet rehabilitimin e rafinerive në Ballsh dhe Fier me normat dhe standardet evropiane, duke përfshirë miratimin e normave mjedisore (nën 1% squfur) për produktet dhe teknologjitë e rafinerisë, rritjen e kapacitetit të përpunimit të rafinerisë në 1,5 Mt/vit, modernizimin e terminalit të Vlorës dhe modernizimin e infrastrukturës së transportit nga Vlora në Ballsh.

Shpenzimet e investimeve për rehabilitimin dhe modernizimin e dy rafinerive varen drejtpërdrejt nga gjendja aktuale e instalimeve, pajisjeve dhe nivelit të ndotjes së mjedisit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, gjithashtu, po shqyrton mundësinë e ndërtimit të rafinerive të reja me kapacitet prej 3,2 milionë tonë. Vlerësimet për koston e investimit të kërkuar për rehabilitimin e rafinerive ekzistuese dhe ndërtimin e rafinerive të reja bazohen në informatat e AKBN-së.

Nënproduktet e naftës, sipas infrastrukturës së tregut të produkteve në Shqipëri, përfshijnë një numër të madh shpërndarësish dhe numri i përgjithshëm i stacioneve me pakicë duhet të reduktohet dhe të optimizohet më mirë sipas normave dhe standardeve evropiane. Investimi i llogaritur për përmirësimin e infrastrukturës për prodhimin dhe përpunimin e nënprodukteve të naftës bazohet, gjithashtu, në të dhënat e AKBN-së. Tabela 16 tregon kostot totale të investimeve të sektorit të naftës për periudhën 2018–2030, të shprehura në milionë euro (MEUR), për kërkimin dhe prodhimin, rehabilitimin, përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e rafinerive të reja, dhe tabela 16 paraqet profilin vjetor të investimit për secilin komponent.

Tabela 5. Investimet në infrastrukturën e naftës dhe nënprodukteve të naftës për 2018–2030

Aktivitete të sektorit të naftës	M EUR
Eksplorimi dhe prodhimi i naftës bruto	1040
Rehabilitimi i rafinerive në Ballsh dhe Fier	59
Përmirësimet e infrastrukturës së nënprodukteve të naftës	24
Ndërtimi i rafinerive të reja	350
Totali për eksplorimin, prodhimin, përpunimin, rafinimin dhe shpërndarjen	**1,4453**

Mbështetja për eficiencën e energjisë

Masat e ndërmarra gjatë zbatimit të PKVEE-së të parë u kryen kryesisht ose me mbështetjen e drejtpërdrejtë të institucioneve financiare ndërkombëtare (IFI)/dhe donatorëve ose u siguruan nëpërmjet kredive të bankave lokale të mbështetura nga një IFI/ose donator. Kjo mbështetje erdhi si nëpërmjet programeve financiare, ashtu edhe asistencës teknike. Mbështetja e tillë ndërkombëtare mund të vazhdojë, por numri në rritje i masave për eficiencën e energjisë, kërkon që të rriten njëkohësisht edhe fondet e brendshme (publike dhe private) për EE-në.

Financimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë parashikohet të vijë nga buxheti i shtetit shqiptar, donatorët, aktivitetet e fondit dhe shërbimet e ofruara. Fondi i Eficiencës së Energjisë synon të sigurojë mbështetje financiare dhe menaxhim projekti për zhvillimin e një tregu të përmirësimit të eficiencës së

energjisë dhe programeve mbështetëse për konsumatorët fundorë për të kryer investime me kosto dhe me rrezik të lartë. Fondi do të përdoret për promovimin e programeve për përmirësimin e eficiencës së energjisë, mbështetjen e kompanive të shërbimit të energjisë, të ekspertëve të pavarur të energjisë, auditorëve të energjisë, shpërndarësve të energjisë, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, kompanive të shitjes me pakicë të energjisë dhe instaluesve të pajisjeve eficiente për konsumin e energjisë.

Fondi i Eficiencës së Energjisë do të ketë në vetvete mjete të kufizuara financiare për arritjen e të gjitha objektivave të vërejtur në kuadër të PKVEE-së. Fondet e propozuara nga buxheti i shtetit duhet të konsiderohen si një mjet për të nxitur burime më të mëdha nga palët e tjera (IFI dhe donatorët, si dhe bankat private).

Për të arritur objektivin e EE-së për një kursim të energjisë prej 6,8% në vitin 2020 dhe 15.5% në vitin 2030, është llogaritur përkatësisht një preventiv prej rreth 100 dhe 228 milionë euro investime, duke konsideruar një kosto mesatare të investimit për energji të kursyer prej 0,05 euro/kwh. Pjesa më e madhe e investimeve të tilla do të jenë financim i drejtpërdrejtë, me mundësinë e ofrimit të garancive të huave, borxhe me interesa të ulëta, financim të diferencës të investimeve ose zvogëlimit të normave të interesit. Detyra kryesore e buxhetit të shtetit është të zhvillojë fushatë ndërgjegjësimi dhe projekte pilot për të promovuar EE-në në të gjithë sektorët ekonomikë.

Tabela 17 paraqet kostot totale të investimeve të sektorit publik për periudhën 2018–2030, të shprehura në milionë euro (MEUR), për fushatat e ndërgjegjësimit për EE-në dhe projektet pilot, dhe tabela 25 paraqet profilin vjetor të investimit për secilin komponent.

Tabela 6. Investimet e sektorit publik për EE 2018–2030 për skenarin e kombinuar me masa të PKVEE

Aktiviteti EE	M EUR
Zbatimi i masave të PKVEE deri 2020 (6.8% kursime)	140
Zbatimi i masave të PKVEE deri 2030 (15.5% kursime)	347
Fushata ndërgjegjësimi 2018–2030	45
TOTALI	**532**

Mbështetja për BRE-në

Mbështetja financiare për prodhuesit e energjisë nga burimet e rinovueshme sigurohet nëpërmjet skemave: i) Tarifat *feed-in* për prodhuesit prioritarë nga BRE-ja; ii) Kontrata për diferencë; dhe iii) Përjashtimi nga taksat.

Me miratimin e ligjit të ri për BRE-në dhe Modelit të ri të Tregut, prodhuesit prioritarë nga BRE-ja, do të vazhdojnë të përfitojnë nga tarifat feed-in (FiT)- tarifat e shitjes së energjisë elektrike nga centralet e BRE-eve), ndërsa me krijimin e Bursës, do të jenë subjekt i primit feed-premium (FiP), siguruar përmes KpD aplikuar për ta në ditën në avancë. Sa më sipër tabela 18 paraqet shpenzimet kumulative të investimeve nga sektori publik për periudhën 2018–2030, të shprehura në milionë euro (MEUR) dhe tabela 26 paraqet profilin vjetor të investimeve për secilin komponent.

Tabela 7. Mbështetja e tarifave FiT dhe FiP për projektet e BRE-së nga buxheti 2018–2030

Aktivitete për BRE-në	M EUR	
	Sk. bazë	Sk. kombinuar
Projektet e ndërgjegjësimit të BRE-së dhe projektet pilote	38	38
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2018–2020 FiT	104	70
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2018–2020 FiP (KpD)	29	22
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2020–2030 FiT	266	210
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2020–2030 FiP (KpD)	390	310
TOTALI	**827**	**650**

INVESTIMET PËR TË GJITHË SEKTORIN E ENERGJISË

Llogaritja kumulative e financimeve

Në këtë seksion është paraqitur në formën e një tabele përmbledhëse, investimi i kërkuar për të gjithë nënsektorin e energjisë dhe totali për të gjithë periudhën 2018–2030, ndërkohë, tabela 19 paraqet ndarjen vjetore të investimeve për secilin nënsektor të energjisë dhe ndarjen sipas investimeve që do të mbulohen nga buxheti i shtetit (duke përfshirë kapitalin vetjak (*equity*) nga kompanitë publike) dhe nga investitorët privatë (të huaj dhe vendës), donatorët dhe bankat shqiptare.

Tabela 8. Kërkesa totale e investimeve kumulative 2018–2030

Aktivitete të Sektorit Energjetik	M EUR	
	Bazë	Kombinuar
SEKTORI ELEKTROENERGJETIK		
Prodhim	1,970	1,442
Transmetim	195	157
Shpërndarje	419	338
TOTALI	**2,584**	**1,937**
MBËSHTETJE E BRE-së		
Projektet e ndërgjegjësimit të BRE-në dhe projektet pilote	38	38
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2018–2020 FiT[17]	104	70
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2018–2020 FiP (KpD)	29	22
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2020–2030 FiT	266	210
Mbështetje financiare për BRE-në deri më 2020–2030 FiP (KpD)	390	310
TOTALI	**827**	**650**
EFICIENCA E ENERGJISË		
Zbatimi i masave të PKVEE-së deri 2020 (6.8% kursime)		140
Zbatimi i masave të PKVEE-së deri 2030 (15.5% kursime)		347
Fushata ndërgjegjësimi 2018–2030		45
TOTALI		**532**
AKTIVITETET E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR		
Interkonjeksioni		230
Transmetimi dhe shpërndarja		117
Furnizimi **total**		**347**
AKTIVITETET E SEKTORIT TË NAFTËS		
Eksplorimi dhe prodhimi i naftës bruto		1020
Rehabilitimi i rafinerive në Ballsh dhe Fier		59
Përmirësimet e infrastrukturës së nënprodukteve të naftës		24
Ndërtimi i rafinerive të reja		350
Totali Eksplorim, prodhim, përpunim, rafinim dhe shpërndarjen		**1,453**
DONATORE		**530**
TOTALI I FINANCIMEVE DERI MË 2030-n	**5,709**	**5,449**

Tabela tregon se investimi total më i lartë është për sektorin e energjisë elektrike për skenarin e kombinuar është 1.937 MEUR kumulative për periudhën 2018 - 2030, nënsektori i dytë më i lartë është për zhvillimin e sektorit të naftës (1,453,0 M EUR) pasuar nga sektori i gazit natyror (347,0 M EURO). Theksojmë se vlerën e investimeve për aktivitetin e kërkimit dhe prodhimit nuk janë parashikuar investimet e mundshme për t'u realizuar nga marrëveshjet e reja hidrokarbure që parashikohen të lidhen gjatë kësaj periudhe.

Vihet re në tabelën e mësipërme se, investimi për BRE-në është 650 MEUR deri në vitin 2030 dhe për të reduktuar konsumi me 15.5% është e nevojshme financimi i fondit të EE-së me 532 MEUR.

Buxheti i shtetit dhe kontributet e investimeve publike në çdo sektor

Përllogaritjet e buxhetit të shtetit dhe kontributit të investimeve publike për secilin sektor të energjisë së nevojshme për arritjen e objektivave strategjikë të identifikuar, janë llogaritur duke u bazuar në supozimet e mëposhtme:

- Investimi i përgjithshëm për prodhimin (përfshirë BRE - HEC-et e të gjitha madhësive - dhe CCGT e gazit natyror) do të bazohet në nismat private.

- KESH-i do të mbështesë jo vetëm projektet e rehabilitimit të aseteve gjeneruese ekzistuese, por edhe ndërtimin e kapaciteteve të reja. KESH do të vazhdojë të mbështesë vetëm rehabilitimin e kaskadës së lumit Drin, bazuar në projektin në vazhdim për të tria HEC-et e kësaj kaskade (Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës) si nga ana e sigurisë së digave, ashtu edhe për sa lidhet me anën elektro-mekanike. Bazuar në studimin e BB-së, KESH sh.a. ka përgatitur një projekt-propozim për HEC-in e Skavicës (studimi i fizibilitetit, modeli i biznesit dhe vlerësimi socio-ekonomik), i cili, pasi u përfshi në Paketën Strategjike Kombëtare 2016–2017 nga

[17] Mbështetja për FiT dhe FiP është llogaritur mbi bazën e sasisë që prodhuesit me përparësi kanë kontrata për çmime promovuese dhe sipas një çmimi tregu të supozuar. Kjo për sa kohë nuk ka një çmim të tregut të ditës në avancë. Sa më sipër kostot janë indikative për qëllime të llogaritjeve të financimeve për Strategjinë.

Këshilli Kombëtar i Investimeve, është paraqitur për shqyrtim dhe mbështetje pranë Fondit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), në raundin e tij XVII të thirrjes për aplikime. Komiteti i WBIF-së shqyrtoi propozimin e projektit të paraqitur nga KESH sh.a. për ndërtimin e HEC-it të Skavicës dhe ka aprovuar grantin e asistencës teknike prej 1,5 milionë euro (Kodi i Projektit: WB17-ALB-ENE-03). Gjithashtu, investimet shtesë të identifikuara për konvertimin e TEC-it të Vlorës në teknologji me gaz natyror janë përfshirë në listën e investimeve për sa lidhet me sektorin e gjenerimit të energjisë elektrike;

- Për investimet e nevojshme për transmetimin, shpërndarjen e energjisë elektrike, për investime në drejtim të përmirësimit të mjedisit në zonën e rafinerive në Ballsh dhe Fier, pritet që kapitali të ketë një strukturë të tillë: 20–30% të totalit të investimeve nga entet përkatëse publike, ndërsa pjesa tjetër do të mbulohet nga IFI dhe ndoshta nga bankat private;

- Investimet e interkonjeksionit, të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror do të bazohen në iniciativa private, me një kontribut të fondeve publike në vlerën 20–30% e totalit të investimeve specifike të kërkuara.

Kontributi i investimeve publike është i barabartë me 252 milionë euro për periudhën 2018–2030, që është vetëm 8,4% e totalit të investimeve të kërkuara. Ky është një përfundim shumë i rëndësishëm, duke qenë se këto kontribute nuk kanë gjasa të ushtrojnë presion mbi buxhetin e shtetit dhe është shumë e rëndësishme që, qeveria shqiptare t'i ndërmarrë këto kontribute në mënyrë që të lehtësojë tërheqjen e investimeve të nevojshme të sektorit privat dhe donatorëve.

Analiza e shifrave të mësipërme tregon qartë se zhvillimi i sektorit energjetik shqiptar sipas skenarit të kombinuar të energjisë tregon që pjesa e buxhetit të shtetit të planifikuar për sektorin e energjisë përfshirë kapitalin e kompanive publike lidhur me kërkesat e investimit kundrejt buxhetit të përgjithshëm vjetor të shtetit është 0,35–0,5 %. Meqenëse kontributi i kapitalit të kompanive publike të energjisë nuk është pjesë e buxhetit të shtetit, pjesa e buxhetit të shtetit të planifikuar për sektorin e energjisë kundrejt buxhetit të përgjithshëm vjetor të shtetit është akoma edhe më e vogël, në nivelet 0,1–0,11%.

Konkluzioni përfundimtar: zbatimi i skenarit të kombinuar për sektorin energjetik shqiptar do të mbështesë zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë, dhe sipas SKZHI-t, do të reduktojë ndjeshëm deficitin shtetëror dhe në të njëjtën kohë është projektuar të mos jetë barrë e buxhetit të shtetit.

Një sërë masash janë paraqitur në kapitujt e tërë të këtij dokumenti lidhur me përmirësimet financiare të OSHEE-së, KESH-it, OST-së, Albetrol së bashku me mbështetjen minimale të buxhetit të shtetit, kontributit të vetë kompanive dhe do të minimizojnë rrezikun e impaktit në buxhetin e shtetit. Kjo do të bëjë të mundur që pjesa kryesore e investimeve do të sigurohet nga investimet private dhe donator të ndryshëm. Situata e fortë financiare për OSHEE-në, KESH-in, OST-në, Albetrolin do të jetë sinjali më i mirë për të garantuar fondet nga donatorët, investitorët e huaj dhe vendës, si dhe të sistemit bankar shqiptar.

PËRGJEGJËSIA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

HYRJE

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë është një ndërmarrje shumë e rëndësishme për Shqipërinë, që kërkon vullnet politik, koordinimin e të gjithë aktorëve të lidhur me energjinë brenda vendit dhe bashkëpunimin me partnerët për zhvillim. Për më tepër, zbatimi i suksesshëm varet nga angazhimi i investitorëve privatë, donatorëve, kompanive publike të energjisë dhe burimeve të buxhetit të shtetit, si dhe nga menaxhimi efektiv i këtyre burimeve brenda institucioneve shtetërore për të arritur rezultatet, produktet dhe impaktet e pritura. Zbatimi i suksesshëm i Strategjisë Kombëtare të Energjisë varet nga qeverisja e mirë, përgjegjësitë e përcaktuara qartë, transparenca dhe pjesëmarrja e vazhdueshme e një game të gjerë institucionesh brenda qeverisë dhe jashtë saj.

Analizat e raportimit, monitorimit dhe vlerësimit janë thelbësore për një zbatim efektiv dhe në kohë të Strategjisë Kombëtare të Energjisë dhe ky kapitull identifikon një sërë matricash të përcaktuara qartë për monitorimin e objektivave kryesorë të Strategjisë së Energjisë. Këto matrica monitorimi bazohen në objektivat strategjikë të diskutuar në seksionin 2.2 dhe matricat strategjike të diskutuara në seksionin 2.3 për të siguruar një bazë të qartë për monitorimin e progresit të Shqipërisë kundrejt zbatimit të kësaj Strategjie të Energjisë.

TREGUESIT E MONITORIMIT

Matricat e monitorimit do të maten përmes indikatorëve specifikë, të cilët janë përzgjedhur nga treguesit përkatës të përdorur për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, objektivat e BRE-së, objektivat e EE-së dhe synimet e KKP-së të përcaktuara nga qeveria shqiptare deri në vitin 2020. Zbatimi i Strategjisë do të vlerësohet nga monitorimi i një grupi prej trembëdhjetë treguesish, të cilët, në përgjithësi, janë të disponueshëm në baza vjetore. Këto tregues të monitorimit renditen si më poshtë:

- Reduktimi i humbjeve teknike të transmetimit të energjisë elektrike; që llogaritet si raport i humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit përkundrejt energjisë elektrike që futet në rrjetin e transmetimit;

- Reduktimi i humbjeve joteknike të shpërndarjes të energjisë elektrike; që llogaritet si raport i humbjeve joteknike (që nuk faturohen) në rrjetin shpërndarës përkundrejt energjisë elektrike që futet në rrjetin shpërndarës;

- Reduktimi i humbjeve teknike të shpërndarjes të energjisë elektrike; që llogaritet si raport i humbjeve teknike në rrjetin shpërndarës përkundrejt energjisë elektrike që futet në rrjetin shpërndarës;

- Rritja e shkallës së arkëtimit të faturave të energjisë elektrike; që llogaritet si raport i shumës së gjithë energjisë elektrike të faturuar në rrjetin shpërndarës përkundrejt vlerës së energjisë elektrike që futet në rrjetin shpërndarës;

- Niveli i ndërsubvencioneve në furnizimin me energji. Ky është një tregues i rëndësishëm cilësor dhe tregon shkallën e ndërsubvencionimit të çmimeve të energjisë elektrike ndërmjet sektorëve. Kuantifikimi i tij është i vështirë të bëhet në gjendjen aktuale;

- Shkalla e diversifikimit të burimeve energjetike. Ky është një tregues i rëndësishëm cilësor dhe tregon numrin e burimeve energjetike që realizojnë furnizimin total. Kuantifikimi i tij është i vështirë të bëhet në stadin aktual;

- Hapja e tregut të energjisë elektrike (përqindja e energjisë së furnizuar nga tregu konkurrues – si i brendshëm, ashtu dhe nga importet);

- Vetëmjaftueshmëria e burimeve primare të energjisë kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë (%); që llogaritet si raport i shumës të gjitha burimeve primare të energjisë së prodhuar në vend përkundrejt shumës së gjithë burimeve të energjisë të furnizuar në një vit të caktuar;

- Importet e burimeve të energjisë kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë (%); që llogaritet si raport i shumës të gjitha burimeve të energjisë të importuara në vend përkundrejt shumës së gjithë burimeve të energjisë të furnizuara në një vit të caktuar;

- Synimi i eficiencës së energjisë (%); që llogaritet si raport i energjisë së kursyer në një vit të caktuar përkundrejt konsumit final të parashikuar në bazë të planit përkatës të aprovuar të eficiencës së energjisë;

- Synimi i energjive të rinovueshme në TPES (objektivi i BRE-së) (%); që llogaritet si raport i shumës së kontributeve të burimeve të rinovueshme të energjisë në një vit të caktuar përkundrejt konsumit final të parashikuar në bazë të planit përkatës të aprovuar të burimeve të rinovueshme të energjisë;

- Synimi/ i biokarburanteve si pjesë e biokarburanteve kundrejt konsumit total të karburanteve në sektorin e transportit (%) ; që llogaritet si raport i energjisë së furnizuar nga biokarburantet në sektorin e transportit përkundrejt konsumit final të parashikuar në bazë të planit përkatës të aprovuar të burimeve të rinovueshme të energjisë;

- Emetimi i CO_2 si reduktim përqindjeje i emetimeve të GHG-së kundrejt totalit të GHG-së të emetuara sipas skenarit bazë (%); që llogaritet si raport i emetimeve të CO_2 dhe gazeve të tjera me efekt serë në një vit të caktuar përkundrejt emetimeve përkatëse të GHG-së të parashikuara në bazë të dokumentit të KKP-së;

- Penetrimi i gazit natyror (ktoe) kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë; që llogaritet si raport i kontributit të gazit natyror në një vit të caktuar në vend, përkundrejt shumës së gjithë burimeve të energjisë të furnizuara në një vit të caktuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me ERE-n, AKBN-në, Agjencinë për EE-në janë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e një zbatimi efikas të Strategjisë së Energjisë për të gjithë sektorët përkatës. Të gjitha institucionet që janë listuar në tabelat 30.1 dhe 30.2 duhet të raportojnë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë deri më 30 prill të çdo viti rezultatet e vitit të mëparshëm në kuadër të unifikimit të raportimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të përgatisë deri më 30 qershor të çdo viti raportimin 1-vjeçar (dhe pasi të kalojnë 3 vite deri më 2020 – edhe raportin në kufij të shkurtër kohor) në lidhje me plotësimin e të gjithë treguesve të monitorimit. Raporti vjetor i Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë dërgohet për analizë në Këshillin e Ministrave. Në fundin e vitit 2020, MIE-ja duhet të paraqesë raportin në kufij të shkurtër kohor dhe përditësimin e Dokumentit të Strategjisë së Energjisë. Në të njëjtën mënyrë duhet të veprohet edhe në vitet 2025 dhe 2030.

OBJEKTIVAT E MONITORIMIT

Treguesit e monitorimit do të vlerësohen në mënyrë periodike nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me ERE-n, AKBN-në, Agjencinë për EE-në. Raportet vjetore të monitorimit mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për miratim. Informacioni do të mblidhet për treguesit përkatës të monitorimit në përputhje me llojin e ndërhyrjes. Një detyrë funksionale e AKBN-së do të konsistojë në hartimin e kërkesave për të dhëna që do të gjenerohen

nga të gjitha kompanitë energjetike publike dhe private dhe në kryerjen e anketave për përcaktimin e nivelit të konsumit midis sektorëve të ndryshëm të kërkesës për energji. Të dhënat e mbledhura do të konfirmohen dhe transferohen në *EUROSTAT Energy Balance Template,* ku të dhënat do të përpunohen dhe sistemohen në tabela me treguesit e monitorimit. Të gjithë treguesit e monitorimit do të jenë pjesë e raportit vjetor të monitorimit, i cili do të dorëzohet për vendimmarrje në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe pastaj do t'i dërgohen zyrtarisht Këshillit të Ministrave.

Tabela 20 paraqet grupin e treguesve të monitorimit, të cilat përfshijnë vlerat e tyre bazë (për vitin 2015), objektivat afatshkurtër (2020), objektivat afatmesëm (2025) dhe ata afatgjatë (2030). Ndërsa tabela 21 paraqet të gjithë treguesit vjetorë të monitorimit për të bërë të mundur monitorimin vit pas viti të secilit parametër.

Raportet vjetore do të trajtojnë progresin në të gjithë sektorët dhe nënsektorët e energjisë, qoftë në aspektin e arritjeve të rëndësishme ose në aspektin e çështjeve të rëndësishme, siç janë ndërrimet kryesore të politikave, çështje serioze të zbatimit ose faktorë të tjerë. Raportet do të prodhohen në kohën e duhur, në mënyrë që institucionet qeveritare dhe partnerët e zhvillimit të mund të ndërmarrin veprimet e duhura.

Tabela 20. Treguesit kryesorë të energjisë dhe objektivat për strategjinë kombëtare të energjisë

Treguesit	Vlera bazë 2015	Objektivat afatshkurtër 2020	Objektivat afatmesëm 2025	Objektivat afatgjatë 2030	Institucioni përgjegjës
Reduktimi i humbjeve teknike të transmetimit të energjisë elektrike	2,20%	2,00%	1,80%	1,70%	MIE/ERE/OST
Reduktimi i humbjeve të shpërndarjes të energjisë elektrike	31,40%	20,00%	13,00%	10,00%	MIE/ERE/OSHEE
Shkalla e rritjes së arkëtimeve të energjisë elektrike	90%	92%	95%	98%	MIE/ERE/ OSHEE
Hapja e tregut të energjisë elektrike	35%	40%	100%	100%	MIE/ERE
Vetëmjaftueshmëria e burimeve primare të energjisë kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë (%)	47,47%	50,37%	52,31%	52,40%	MIE/AKBN
Importet e burimeve energjetike kundrejt furnizimit total me burime primare (%)	52,53%	49,63%	47,69%	47,60%	MIE/AKBN
Synimi i eficiencës së energjisë (%)	0,2%	6,8%	10%	15,5%	MIE/AEE
Synimi i energjive të rinovueshme në TPES (objektivi i BRE-së) (%)	32,50%	38,00%	40,50%	42,00%	MIE/AKBN
Synimi i biokarburanteve si pjesë e biokarburanteve kundrejt konsumit total të karburantit në sektorin e transportit (%)	3,55%	10%	10%	10%	MIE/AKBN
Emetimi i CO_2 si reduktim i përqindjes së emetimeve të GHG kundrejt totalit të GHG të emetuara sipas skenarit bazë (%)	0%	0%	-5,75%	-11,5%	MTM/MIE/AKBN
Penetrimi i gazit natyror (ktoe) kundrejt furnizimit total me burimet primare të energjisë	0,36%	0,37%	5,10%	8.5%	MTM/AKBN